



REPUBLIKA E SHqipëRISE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONKURUESHMËRISË DHE PARTNERITETIT
DREJTORIA E TREGUT TË BRENDSHËM

STRATEGJIA

NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE DHE MBIKËQYRJEN E TREGUT

2020

PËRGATITUR:

Nën kujdesin e: Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,
Z.AHMETAJ

Me mbështetjen e: Grupit Teknik të Punës

TIRANË, Korrik 2014

Grupi Teknik i Punës:

| Nr. | Emri Mbiemri | Institucioni |
|------------|---------------------|---------------------|
| 1. | ANILA JANI | Kryetar MZHETTS |
| 2. | JULIA CELA | DPZHFNH |
| 3. | ORIANA ARAPI | DPZHFNH |
| 4. | JOSIF GJANI | DPZHFNH |
| 5. | ARDITA FUGA | DPA/MZHETTS |
| 6. | AGRON LACI | DPM/MZHETTS |
| 7. | KOSTANCA DEDJA | DPS/MZHETTS |
| 8. | MAMICA DHAMO | MZHETTS |
| 9. | KRESHNIK HAKRAMA | DPM/MZHETTS |
| 10. | ERLIRA KOLANECI | MZHETTS |
| 11. | IRENA MALOLLI | MSHIAP |
| 12. | ARIAN HOXHA | MEI |
| 13. | AURORA ALIMADHI | MEI |
| 14. | PERIKLI GJIKURIA | ISHTI/MEI |
| 15. | MARSELA MAÇI | MBZHRAU |
| 16. | LULJETA ÇUKO | MBZHRAU |
| 17. | SONILA NAJDENI | MBZHRAU |
| 18. | ANGJELINA VUKSANI | MBZHRAU |
| 19. | ANJEZA CECJA | MBZHRAU |
| 20. | MATILDA XHEPA | MBZHRAU |
| 21. | RUDIN QEHAJAJ | MBZHRAU |
| 22. | ZHAN LEVANI | QKKB |
| 23. | LEDINA PICARI | MSH |
| 24. | SHPRESA BELLO | MSH |
| 25. | LINDA TERNOVA | MSH |
| 26. | BESNIK RAMA | MA |

| | | |
|-----|----------------|-----|
| 27. | BENJAMIN BEJKO | MTI |
| 28. | ELSON THANA | MTI |
| 29. | ZANA JOCA | MTI |
| 30. | RENATA TETA | MTI |
| 31. | VIKTOR NDREKA | MTI |

Tabela e Përmbajtjes

| | |
|---|-------------------------------------|
| AKRONIME | 5 |
| HYRJE..... | 7 |
| 1 KAPITULLI I: KUSHTET AKTUALE..... | Error! Bookmark not defined. |
| 1.1 Fusha e sigurisë së produkteve | 8 |
| 1.1.1 Siguria e produkteve ushqimore, produkteve ujore, shëndeti i bimëve dhe kafshëve | 8 |
| 1.1.2 Siguria e produkteve jo-ushqimore | Error! Bookmark not defined. |
| 1.1.3 Barnat për përdorim njerëzor | 16 |
| 1.2 Infrastruktura e Cilësisë..... | 18 |
| 1.2.1 Standardizimi..... | 19 |
| 1.2.2 Akreditimi | 20 |
| 1.2.3 Metrologjia | 22 |
| 1.3 Çështje të mbrojtjes së konsumatorëve që nuk kanë lidhje me aspektet e sigurisë..... | 27 |
| 1.4 Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere dhe programeve të edukimit për çështjet konsumatore..... | 31 |
| 2 KAPITULLI II: VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET E POLITIKAVE..... | 33 |
| 2.1 Vizioni i strategjisë | 33 |
| 2.2 Qëllimet e politikave..... | 33 |
| 3 KAPITULLI III: OBJEKTIVAT E POLITIKËS DHE PRODUKTET MADHORE..... | 36 |
| 3.1 Objektivat afat shkurtra deri në fund të 2015)..... | 36 |
| 3.2 Objektivat afat gjata (2016-2020)..... | 48 |
| 4 KAPITULLI IV: BURIMET FINANCIARE..... | 59 |
| 5 KAPITULLI V: LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE ... | 63 |
| 5.1 Monitorimi i strategjisë, strukturat përgjegjëse | 63 |
| 5.2 Treguesit e parashikuar në SNMKMT 2014-2020 | 64 |
| ANEKS: PLANI I VEPRIMIT AFAT MESEM DHE AFAT GJATE I STRATEGJISE SE MBROJTJES SE KONSUMATOREVE DHE MBIQYRJES SE TREGUT 2014-2020 | 69 |

AKRONIME

| | |
|------------------|--|
| EJL | Strategjia e Evropës Juglindore |
| DPZHFNH | Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj |
| MZHETTS | Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes |
| MBZHRAU | Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave |
| MIE | Ministria e Integritimit Evropian |
| MTI | Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës |
| MSHIAP | Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike |
| MAS | Ministria e Arsimit dhe Sportit |
| BIPM KCDB | Database e Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave |
| EURAMET | Organizata Evropiane e Instituteve Kombëtare të Metrologjisë |
| WELMEC | Kooperimi Evropian për Metrologjinë Ligjore |
| DML | Drejtorja e Metrologjisë Ligjore |
| DIM | Drejtorja e Inspektimit Metrologjik |
| KE | Komisioni Evropian |
| BE | Bashkimi Evropian |
| AKU | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit |
| IMB | Instituti i Mbrojtjes së Bimëve |
| QKKB | Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave |
| KMK | Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve |
| ZPEA | Zona e Përbashkët e Aviacionit Evropian |
| AAC | Autoriteti i Aviacionit Civil |
| IMB | Instituti i Mbrojtjes së Bimëve |
| DSHP | Drejtorja Rajonale e Shëndetit Publik |
| PMB | Produktet e mbrojtjes së bimëve |
| OIE | Organizata Botërore të Shëndetit të Kafshëve |
| ISUV | Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë |
| ISHTI | Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial |

| | |
|----------------|--|
| DPA | Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit |
| DPM | Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë |
| DPS | Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit |
| CEN | Komiteti Evropian për Standardizimin |
| CENELEC | Komiteti Evropian për Standardizimin në fushën e Elektroteknikës |
| ETSI | Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit |
| ISO | Organizata Ndërkombëtare e Standardeve |
| IEC | Komisioni Ndërkombëtar për standardet e Elektroteknikës |
| EA | Organizata Evropiane për Akreditim |
| ILAC | Organizata Ndërkombëtare e Akreditimit të Laboratorëve Testues |
| IAF | Forumi Ndërkombëtar të Akreditimit |
| QF | Qendra e Farmakovigjilencës |
| MSA | Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit |

HYRJE

Strategjia e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2020, është dokumenti politik i cili vendos në qendër të tij konsumatorët dhe synon fuqizimin e tyre për një rol aktiv në treg, duke ushtruar të drejtat dhe fuqinë e tyre të zgjedhjes së mirë informuar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

Strategjia e Evropës Juglindore (EJL) 2020, që reflekton atë Evropiane 2020, synon rritje dhe zhvillim të zgjuar, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Politika të mirë hartuara dhe të zbatuara për mbrojtjen e konsumatorëve i mundësojnë atyre të bëjnë zgjedhje të mirë-informuara, duke ndikuar pozitivisht në krijimin e një konkurrence të ndershme dhe rritje të qëndrueshme. Strategjia EJL 2020 synon për konsumatorë të fuqizuar që luajnë një rol aktiv në treg, që kërkon forcimin e besimit të konsumatorëve në blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

Në kushtet kur nevojiten burime të reja për rritjen e ekonomisë, politika e mbrojtjes së konsumatorëve është një fushë që mund të ketë një kontribut domethënës në arritjen e objektivave të EJL 2020. Rritja e aftësisë së konsumatorëve për blerje të mire-informuara sjell pa dyshim rritjen e impaktit që ata kanë në forcimin e tregut funksional, nxitjen e inovacionit dhe rritjes ekonomike, duke rritur kërkesën për shumëllojshmëri dhe cilësi mallrash dhe shërbimesh me çmime konkurruese, hapjen e tregut dhe rritjen e punësimit.

Fuqizimi i konsumatorëve nuk është vetëm një e drejtë, por ka të bëjë me krijimin e një mjedisi të përgjithshëm që i mundëson atyre të shfrytëzojnë këto të drejta dhe të përfitojnë prej tyre, që do të thotë krijimin e një sistemi në të cilin ata mund të mbështeten dhe që u garanton sigurinë e mallrave dhe shërbimeve si dhe mbrojtjen efektive të interesave të tyre ekonomike kur këto vihen në rrezik.

Garantimi i qarkullimit të lirë të produkteve të sigurta në treg me të njëjtat kërkesa teknike me ato evropiane është bazë për çdo politikë të konsumatorëve dhe një nga liritë themelore të përcaktuara në Traktatin e Funkcionimit të BE si dhe një nga masat e parashikuara në Strategjinë EJL 2020.

Nga njëra anë, globalizimi i zinxhirit të prodhimit bën më të vështirë identifikimin e produkteve të pasigurta dhe nga ana tjetër, krizat ekonomike mund të çojnë në fokusimin e konsumatorëve dhe bizneseve në çmimet më të ulëta, me riskun që aspektet e sigurisë të humbin rëndësinë dhe në këtë mënyrë rritet hapësira për produkte false dhe të pasigurta.

Pikërisht, në situatën e rënieve ekonomike, të cilat çojnë në rritjen e vulnerabilitetit të konsumatorëve, hartimi dhe zbatimi efektiv i një kuadri të fortë ligjor merr një rëndësi parësore, sepse rrit besimin e konsumatorëve në treg që sjell rritjen e blerjeve që është motori i rigjenerimit të ekonomisë.

Strategjia e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2020, është dokumenti politik i cili vendos në qendër të tij konsumatorët dhe synon fuqizimin e tyre për një rol aktiv në treg, duke ushtruar të drejtat dhe fuqinë e tyre të zgjedhjes së mirë informuar për të blerë mallra dhe shërbime. Kjo Strategji është në vijim të masave të parashikuara në Strategjinë e mëparshme të Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut (2007-2013), duke përcaktuar edhe fushat që do të kërkojnë më shumë vëmendje në vitet e ardhshme deri në 2020.

Kjo Strategji është në përputhje me Programin Evropian të mbrojtjes së konsumatorëve 2014 – 2020 dhe Programin e Qeverisë 2013-2017. Strategjia e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut, është pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Ajo është në linjë me parimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA).

Ky dokument strategjik i është nënshtruar konsultimit në grupet e punës dhe në atë këshillimor përfshirë shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit.

1 KAPITULLI 1: KUSHTET AKTUALE

Gjatë viteve të fundit Shqipëria ka ndërmarrë një sërë iniciativash horizontale dhe sektoriale në fushën e politikës së mbrojtjes së konsumatorëve, në zbatim të Strategjisë ndër-sektoriale “Për Mbrojtjen e konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e tregut për periudhën 2007-2013”, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 797, datë 14.11.2007 si dhe të Strategjisë “Për zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë në Shqipëri”, miratuar me VKM nr.272, datë 5.3.2008, zhvillimi dhe promovimi i të cilës nëpërmjet një qasje të integruar është domosdoshmëri për zhvillimin e teknologjive të reja, rritjen e konkurrencës në treg dhe ofrimin e produkteve më të sigurta për konsumatorët

1.1 Fusha e sigurisë së produkteve

1.1.1 Siguria e produkteve ushqimore, produkteve ujore, shëndeti i bimëve dhe kafshëve

Zhvillimi institucional dhe krijimi i kuadrit rregullator në fushën e sigurisë ushqimore ka qenë dhe vazhdon të jetë një prioritet i rëndësishëm për Qeverinë Shqiptare. Shembujt e viteve të fundit në Evropë si ajo e BSE (sëmundja e lopës së çmendur), gripi i shpendëve dhe dioksina, të cilat përbëjnë rrezik për shëndetin e popullatës por dhe shkaktojnë dëme nga pikpamja ekonomike tregtare, kanë treguar se zinxhiri i prodhimit ushqimor po bëhet gjithnjë e më kompleks. Për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve duhet siguruar funksionimi efektiv i çdo hallke në zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë.

Ky princip është i vlefshëm pavarësisht nga fakti nëse ushqimet prodhohen në Shqipëri apo importohen nga vende të tjera. Një politikë efikase e sigurisë ushqimore duhet të njohë natyrën komplekse të prodhimit të këtyre ushqimeve si dhe vlerësimin e monitorimit të risqeve mbi shëndetin e njerëzve. Për këtë arsye Qeveria shqiptare ka patur dhe ka në vëmendjen e saj forcimin e kontrollit dhe të monitorimit të ushqimeve që prodhohen dhe tregtohen në tregun shqiptar të destinuar për konsum njerëzor si dhe të ushqimeve që përdoren për kafshë.

Gjatë periudhës së viteve 2007 – 2012, në këtë fushë u implementuan reforma të rëndësishme rregullatore dhe institucionale duke ndarë politikë-bërjen nga zbatimi. Në fushën e sigurisë së ushqimore, produkteve ujore, veterinarisë dhe fito sanitare, janë përshtatur në legjislacionin kombëtar më shumë se 200 (dyqind) akte të BE-së dhe janë ndërmarrë një sërë hapash madhorë për zbatimin e tyre.

Me gjithë progresin e deritanishëm, kuadri ligjor në fushën e sigurisë ushqimore, produkteve ujore, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve mbetet pjesërisht i harmonizuar me atë evropian.

Mbetet sfidë për të ardhmen përmirësimi i legjislacionit me synim harmonizimin e plotë të tij me atë evropian në fushat e lartpërmendura.

- ***Siguria ushqimore (fushat e mbuluara nga Ligji Për Ushqimin dhe Autoriteti Kombëtar Ushqimit)***

Ligji “Për Ushqimin” i miratuar në vitin 2008 dhe i harmonizuar me *acquis communautaire* në fushën e sigurisë së ushqimit, ka për qëllim të pakësojë, eliminojë ose parandalojë risqet për shëndetin e konsumatorit përmes analizës së tre komponentëve themelorë: vlerësimin të riskut, menaxhimin të riskut dhe komunikimin të riskut në fushën e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe inuteve bujqësore, etj.

Legjislacioni sekondar i përshtatur me atë evropian përfshin paketën higjienike, kriteret mikrobiologjike, kriteret shëndetësore për produktet me origjinë shtazore të importuara, kontaminantet ushqimore, aditivët ushqimore, materialet në kontakt me ushqimin, etiketimin e produkteve ushqimore, kërkesat shëndetësore për produktet ujore, ushqimet për fëmijë, etj.

Një arritje të rëndësishme në drejtim të garantimit të sigurisë ushqimore në vend përbën ngritja në Shtator të 2010 e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), si institucioni përgjegjës për kontrollin e produkteve të ushqimit, produkteve ujore, produkteve me origjinë shtazore dhe jo shtazore, bimëve produkteve bimore si dhe inuteve bujqësore si dhe për kontrollin e lëndëve të para të përdorura në industrinë e ushqimit si dhe produktin përfundimtar.

AKU ka në strukturën e vet 423 punonjës dhe e shtrin aktivitetin e tij në 12 qarqet e vendit nëpërmjet drejtorive rajonale në varësinë e të cilave janë inspektorët që kryejnë kontrollin zyrtar në fushat përkatëse si dhe laboratorët përgjegjës. Pjesë administrative e Drejtorive rajonale të AKU janë edhe 13 Pikat e Inspektimit Kufitar të cilat janë përgjegjëse për kontrollin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore, bimëve dhe produkteve bimore, inuteve bujqësore, si dhe kafshëve të gjalla. Inspektorët e AKU-së janë të atashuar pranë Drejtorive rajonale dhe kryejnë detyrat funksionale si në terren ashtu edhe në pikat e inspektimit kufitar. Autoriteti menaxhon 12 laboratorët rajonalë të cilët kryejnë analiza të sigurisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore, me origjinë shtazore dhe jo shtazore, diagnostikimin e sëmundjeve të kafshëve dhe analiza për sëmundje dhe dëmtues karantinor të bimëve.

Implementimi i sistemit HACCP, si një parakusht për liçensimin e operatorëve të biznesit ushqimor, ka një trend në rritje. Vetëm gjatë vitit 2013 rreth 114 Operatorë të rinj të Biznesit Ushqimor (OBU) kanë implementuar planin HACCP dhe 105 prej tyre janë në proces implementimi.

Krijimi i sistemit të menaxhimit të të dhënave në secilin hap të zinxhirit të kontrollit, nga niveli qendror në atë lokal, është thelbësor për organizimin e një sistemi eficient të kontrollit të ushqimit. AKU ka ngritur dhe mban të përditësuar data bazën “AKU-net”, i cili tashmë përmban një informacion të hollësishëm edhe për etiketimin e produkteve ushqimore dhe ushqimeve për kafshë. Si rezultat, në sistem janë hedhur etiketat për 363 subjekte prodhuese, me një numër prej 1706 etiketash. Ky informacion do të shërbejë për harmonizimin e inspektimit të tregut në lidhje me etiketimin e produkteve, pasi çdo etiketë është hedhur on-line në sistem dhe është e

aksesueshme. Gjithashtu në AKU-net krahas çertifikatave të tjera për eksportin, janë vendosur edhe çertifikatat e reja për ri-eksportin e mishit.

Është përmirësuar hedhja e të dhënave nga inspektorët, e të gjithë dokumenteve që përmban procedura e inspektimit në AKU Net. Informacioni që nxirret nga sistemi AKU Net mbi masat administrative, liçencat apo asgjësimin e produkteve (kur nevojitet), shërben për të krijuar standardet e nevojshme dhe për të përdorur këto statistika për analiza dhe politika të brendshme për AKU-në.

Megjithatë duhen vazhduar përpjekjet që ky sistem të jetë i plotë, lidhur me rishikimin e klasifikimit të operatorëve të biznesit ushqimor si dhe trajnimin e gjithë inspektoreve përkatës me qëllim rritjen e cilësisë së përdorimit dhe hedhjes së të dhënave në këtë sistem.

Si pasojë e inspektimeve nga AKU aktiviteti ekonomik i pjesës më të madhe të subjekteve kryhet duke qenë të pajisur me leje tregtimi, liçencë, ose janë tashmë në proces liçencimi, gjë që ka çuar në minimizimin e informalitetit të ekonomisë. **Si rezultat, që nga krijimi i AKU ka pasur 1384 kërkesa të reja për licencim.**

Nga ana e AKU, në fushën e aktiviteteve të kontrollit zyrtar, vëmendja kryesore është fokusuar në unifikimin e procedurave të inspektimit dhe respektimin e kërkesave ligjore. AKU gjatë vitit 2013 ka kryer 24,460 inspektime dhe ku janë marrë 1580 masa administrative ose në 6,4% të inspektimeve të kryera, që konsistojnë kryesisht në, mos Implementimin e Sistemit të Vetëkontrollit (HACCP), mos aplikimin e Sistemit të Gjurmueshmërisë, kushte higjieno-sanitare jo të përshtatshme, kryerja e tregimit të mishit dhe therja e kafshëve në ambiente të papërshtatshme, tregtimi i Inputeve Bujqësore në të njëjtin ambient etj.

Ka përmirësim në disiplinimin e procesit të therjes së kafshëve dhe tregimit të mishit. Gjatë vitit 2013 janë kryer 3546 inspektime në pikat e tregimit të mishit dhe njësitë e therjes. Si rezultat i këtyre inspektimeve, është bllokuar aktiviteti i 448 subjekteve, janë marrë 119 masa administrative si dhe janë rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit **108 subjekte të reja.**

Megjithatë, në Pikat e Inspektimit Kufitar mbetet problematike mungesa e infrastrukturës për kryerjen e kontrollit fizik si ambiente frigoriferike dhe ambiente karantinore, gjë që sjell mundësi të kufizuara për të kryer inspektimin në mënyrë sa më korrekte. Gjithashtu për realizimin me rigorozitet të detyrave funksionale të inspektorit të AKU në qarqe, është e nevojshme pajisja e tyre me mjete transporti gjë që do të bënte të mundur minimizimin e kohës së inspektimit. Për zgjidhjen e këtyre problemeve kërkohet mbështetja e nevojshme financiare.

Me gjithë përmirësimet, kapacitetet njerëzore veçanërisht lidhur me vlerësimin e riskut dhe monitorimin e mbetjeve, kritereve mikrobiologjike dhe kontaminanteve nuk janë në nivele të kënaqshme gjë që ka sjellë mungesën e planifikimit cilësor të sistemit sistematik të inspektimeve, përfshirë importin e produkteve, mos-përmirësim të gjurmueshmërisë ushqimore sipas procedurave

- ***Produktet Ujore***

Ka patur zhvillime pozitive që kanë konsoliduar sistemin e sigurisë ushqimore në raport me produktet e peshkimit, sidomos pas vitit 2009, me ngritjen dhe konsolidimin e një strukture të veçantë për produktet ujore në Drejtorinë e Sigurisë Ushqimore. Në Nëntor 2011 u zhvillua

misioni i FVO-së (Zyra e Veterinarisë dhe Ushqimit e BE-së) i cili vlerësoi për herë të parë në raportin final se kuadri ligjor shqiptar në fushën e produkteve të peshkimit & akuakulturës dhe molusqeve bivalve të gjallë është ekuivalent me atë të BE-së. Gjithashtu misioni konsideroi sistemin e ngritur nga Autoriteti Kompetent shqiptar për kontrollin e produkteve të peshkimit në përputhje me atë të BE-së dhe në gjendje të afrojë garancitë e duhura për mbrojtjen e konsumatorit në përputhje me sistemin e sigurisë ushqimore të BE-së.

Në raportin final të misionit të auditimit të FVO-së janë lënë rekomandime në lidhje me sistemin për kontrollin e molusqeve bivalve të gjallë, në mënyrë që edhe ky sistem të arrijë të jetë në gjendje të ofrojë garancitë e duhura për mbrojtjen e konsumatorit (duke garantuar një produkt të sigurt) në mënyrë që të mund të hapet eksporti i molusqeve bivalve të gjallë me vendet anëtare të BE-së.

Gjatë kësaj periudhe ka patur hapa pozitivë në këtë drejtim si akreditimi nga ACCREDIA i testeve që kryhen nga ISUV mbi molusqet bivalve të gjallë, hartimi i planit të monitorimit në përputhje me standardet e BE-së, hartimi i dokumentit të Mbikëqyrjes Sanitare etj.

Mbetet sfidë, kontrolli i ushqimit sipas parimit nga ferma në tavolinë, dhe arritja e:

- i) Garantimit të sigurisë ushqimore për konsumatorin nëpërmjet përmirësimit të sistemit të procesit të vlerësimit të riskut, menaxhimit dhe komunikimit të tij***
- ii) Garantimit të shëndetit të konsumatorëve nga parandalimi dhe eliminimi i risqeve ushqimore nëpërmjet zbatimit të programeve kombëtare të monitorimit të mbetjeve, kritereve mikrobiologjike dhe kontaminanteve në kafshë të gjalla, produkte ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore, si dhe ujërave të molusqeve bivalve.***

• Mbrojtja e bimëve

Në fushën e mbrojtjes së bimëve në vitin 2008 janë miratuar disa amendime të ligjit “Mbi Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve” dhe 9 akte nënligjore, me qëllim përmirësimin e procedurës së regjistrimit të produkteve të mbrojtjes së bimëve (PMB) dhe ruajtjen e territorit të vendit tonë nga mundësitë e infektimit nga parazitët karantinor.

Së fundmi është futur analiza sistematike e produkteve për mbrojtjen e bimëve (p.sh. pesticidet) në laboratorin e referencës në ISUV. Të gjitha fidanët dhe farërat janë subjekt i analizave fito sanitare në laboratorët e mbrojtjes së bimëve, të cilët gjenden në Durrës, ndërsa analizimi i treguesve cilësorë të farave kryhet në laboratorin e ESHFF-së

Departamenti për Mbrojtjen e Bimëve/Instituti i Mbrojtjes së Bimëve është përgjegjës për testimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve si dhe mbetjet e tyre në bimë, produkte bimë, ujë dhe tokë. Gjithashtu ky Institut kryen monitorimin e dëmtuesve të bimëve në kushte karantinore, përcaktimin e metodave të kontrollit, masat parandaluese si dhe siguron informacion për popullsinë në lidhje me rritjen e parazitëve të bimëve dhe rekomandon masa të përshtatshme për kontrollin e tyre.

Detyrat kryesore në fushën fito sanitare janë të lidhura me finalizimin e regjistrimit dhe ngritjen e një regjistri të plotë të të gjitha produkteve dhe tregtarëve të farërave dhe fidanëve.

Një tjetër detyrë e rëndësishme mbetet identifikimi dhe krijimi i zonave të pastra për bimët mëmë.

- ***Shëndeti i kafshëve (fushat e mbuluara nga Ligji Për Shërbimin Veterinar)***

Në vitin 2011 u miratua Ligji “Mbi Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” dhe një sërë aktesh nënligjore në zbatim të tij lidhur me kontrollin e sëmundjeve tek kafshët, kontrollin e sëmundjeve zoonotike, funksionimin e sistemit të identifikimit të kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe kushtet e tregtimit kombëtar dhe ndërkombëtar të të gjitha kafshëve. Ky legjislacion i ri nëfushën e veterinarisë është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve (OIE) dhe legjislacionit përkatës evropian duke dhënë një nivel më të lartë mbrojtje të shëndetit e mirëqenies së kafshëve si dhe mbrojtjen e shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët tek njeriu.

Në fushën e ***shëndetit të kafshëve*** është adoptuar një program për profilaksinë veterinare dhe ka filluar implementimi i vaksinimit të kafshëve kundër antraksit, vaksinimit të bagëtive të imta kundër brucelozës, si dhe vaksinimit kundër murtajës klasike të derrit. Programi kombëtar gjithashtu mbulon kontrollin e tuberkulozit të gjedhit duke përdorur metodën intra-dermale, kontrollin serologjik të brucelozës së gjedhit dhe kontrollit për tërbimin.

Është ngritur një sistem identifikimi për kafshët që mbarështohen në ferma si dhe një rrjet kompjuterik kombëtar për regjistrimin e kafshëve dhe raportimin e sëmundjeve. Kjo përfaqëson një hap të madh përpara në mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjeve të kafshëve.

Progres i kënaqshëm është arritur në krijimin e regjistrit të fermave të kafshëve, identifikimin e gjedhëve dhe ripërtypësve të vegjël, si dhe përditësimin e data bazës për kontrollin e lëvizjes së kafshëve.

Deri tani, afërsisht 95% e numrit total të fermave të gjësë së gjallë janë regjistruar. Procesi i regjistrimit të fermës vazhdon gjatë aktiviteteve veterinare në terren.

Sfidë mbetet ***mbrojtja e shëndetit të kafshëve nëpërmjet gjurmimit dhe vaksinimit të sëmundjeve zoonotike që janë të transmetueshme nga kafsha te njeriu dhe rritja e efektivitetit të shërbimit veterinar në nivel qendror e rajonal dhe riorganizimi i shërbimit veterinar privat.***

- ***Sistemi laboratorik në Shqipëri***

Objektivat në fushën e sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve të cilat bëjnë të mundur mbrojtjen e konsumatorit nuk mund të realizohen nëse në vend nuk garantohet një rrjet i integruar dhe funksional laboratorësh të autorizuar të kontrollit si dhe atyre të referencës.

Aktualisht, siç është përmendur dhe më sipër, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka nën drejtimin e tij 12 laboratorë rajonalë të cilët kryejnë analizat laboratorike të mostrave të marra për kryerjen e kontrollit zyrtar të ushqimit.

Për të rritur cilësinë e punës së tyre, është e nevojshme që në një periudhë afatmesme të mirë përcaktohet dhe publikohet veprimtaria e këtyre laboratorëve për sa i përket analizave që ato janë të autorizuar të kryejnë.

Përveç laboratorëve të autorizuar të kontrollit, një hallkë shumë e rëndësishme e zinxhirit laboratorik janë laboratorët e referencës. Ligji Për Ushqimin përcakton si të tillë laboratorët e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe të Veterinarisë, për çdo analizë të kryer, për kontrollin zyrtar të sigurisë së ushqimeve. Ligji Për Shërbimin Veterinar gjithashtu përcakton ISUV-in si Qendrën Kombëtare të Referencës Laboratorike Veterinare, i cili është përgjegjës, midis të tjerash, për kryerjen e një sërë analizash laboratorike në zbatim të programeve kombëtare të monitorimit së situatës epidemiologjike të sëmundjeve infektive, zoonozave dhe mbetjeve toksike në vend.

Duke patur parasysh se aktualisht Instituti ka të akredituar 7 teste nëpërmjet 2 trupave akredituese “ACCREDIA” (trupa Italiane e akreditimit) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), shtrirja/përfshirja në akreditim i testeve të “reja” të sigurisë ushqimore, si salmonella spp, në vezë dhe mish shpendi, si dhe i testeve në laboratorët e shëndetit të kafshëve, nga organe akredituese nënshkruese të MLA me EA-në ose Organizatën Ndërkombëtare për Akreditimin e Laboratorëve mbetet objektivi kryesor për të ardhmen si në planin afatmesëm ashtu dhe afatgjatë.

Sfidë për të ardhmen është njohja e rezultateve në nivel kombëtar dhe evropian/ndërkombëtar për të paktën 20 lloje testimesh të kryera nga laboratorët e ISUV.

1.1.2 Siguria e produkteve jo-ushqimore

Në vitin 2011, u miratua një kuadër i ri ligjor horizontal për sigurinë e përgjithshme të produkteve jo ushqimore si dhe për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut i cili zëvendëson/shfuqizon ligjin horizontal për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të vitit 2007, me qëllim ndjekjen e përditësimeve të legjislacionit evropian.

Ligji i ri “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve jo ushqimore” përcakton të drejtat dhe detyrimet e prodhuesve e të shpërndarësve, me qëllim që produktet e konsumatorit të vendosura në treg të jenë të sigurta, si dhe kompetencat e rrjetit të strukturave përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut. Nga ana tjetër, ligji horizontal për tregtimin e produkteve dhe mbikëqyrjen e tregut përcakton detyrimet e operatorëve ekonomikë për të vendosur në treg produkte që janë në përputhje me kërkesat ligjore në lidhje me to. Kjo paketë ligjore transpozon direktivën evropiane të sigurisë së përgjithshme dhe parimet e dispozitat përkatëse të paketës/kuadrit të ri ligjor evropian të vitit 2008 në këtë fushë, por jo vetëm. Për herë të parë, në këtë ligj parashikohet kontrolli i produkteve që hyjnë në territorin shqiptar nga Autoritetet doganore, të cilat mund të pezullojnë zhdoganimin e produkteve që paraqesin risk serioz për shëndetin, sigurinë apo interesat të tjerë publike si dhe detyrimi i personave përgjegjës për garantimin e sigurisë së produkteve dhe instalimeve që janë në përdorim.

Vendosja në ligj e akreditimit si parakusht për miratimin e organeve të vlerësimit të konformitetit, ka patur impakt në rritjen e interesit për akreditim, duke e çuar në 12 numrin e këtyre organeve të akredituara në fushën e pajisjeve nën presion stacionare dhe të transportueshme si dhe të mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme.

Transpozimi i legjislacionit evropian të veçantë për produktet nën kapitullin 1 të acquis “Lëvizja e lirë e mallrave”, me qëllim heqjen e barrierave teknike të panevojshme në tregti, promovimin e një ambienti të lirë konkurrues dhe krijimin e të njëjtit nivel mbrojtje të konsumatorëve shqiptarë

me ato evropiane, është dhe mbetet prioritet i gjithë ministrive sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë.

Një progres i dukshëm është bërë në transpozimin e legjislacionit evropian të produkteve për një sërë fushash si në atë të: lodrave, enëve të thjeshta nën presion, pajisjet me voltazh të ulët, përputhshmërisë elektromagnetike, makinerive, teleferikëve, ashensorëve, pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse që përdoren në ambiente (atmosfera) potencialisht shpërthyes, pajisjeve mbrojtëse personale, bojlerëve me ujë të nxehtë që përdoren me gaz, pajisjeve të gazit, pajisjeve në mjedise të hapura në lidhje me emetimin e zhurmave, detergjentëve, pajisjeve radio, qelqit, droselave dhe pajisjeve frigoriferike në lidhje me kërkesat minimale të efikasitetit të energjisë, etj.

I gjithë kuadri ligjor për produktet dhe instalimet e sipërpërmendura, tashmë është shfuqizuar si rrjedhojë e shfuqizimit të ligjit bazë dhe për pasoje edhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, duke krijuar kështu aktualisht një vakum ligjor që duhet plotësuar lidhur me kriteret e sigurisë se këtyre fushave, të cilat duhet të zëvendësohen nga aktet e tjera të përditësuara, apo ndryshimet përkatëse të akteve ekzistuese.

Për këtë qëllim deri në fund të vitit 2015 duhen përfunduar procedurat përkatëse për miratimin e rregullave teknike që mungojnë për produktet/grupe produktesh dhe instalimesh, të lartpërmendura, po ashtu edhe për fusha të tjera, në përputhje me nivelin e sigurisë të aplikuar nga normativat evropiane duke siguruar kështu të njëjtin nivel sigurie.

Ndërkohë që akoma kemi fusha që janë të pambuluara me legjislacionin e duhur, si në fushën e pajisjeve të transportueshme nën presion, produkteve kozmetike, pajisjeve çlodhëse lundruese, mjeteve motorike, materialeve të ndërtimit, etj, të cilat duhet të rregullohen gradualisht.

Në fushën e **mjeteve motorike** janë miratuar disa akte ligjore si aderimi në dy konventat e UNECEs të Rregulloreve Teknike të Mjeteve. Aktualisht, organet shtetërore kanë rol kryesisht në pranimin dhe regjistrimin për herë të parë dhe kontrollin e gjendjes së gatishmërisë teknike në rrugë të këtyre mjeteve.

Në të ardhmen do të synohet zbatimi i direktivave të fushës, që kanë të bëjnë me *dhënien e informacionit të konsumatorit përsa i përket karakteristikave të mjeteve lidhur me konsumin e karburantit dhe emetimit të gazrave si dhe reduktimit të emetimit të CO₂* nga paisjet e reja motorike që përdoren nga qytetarët.

Në fushën e **produkteve të ndërtimit** legjislacioni ekzistues akoma nuk është i harmonizuar me Rregulloren e re evropiane 305/2011/EU. Në kushtet kur Shqipëria është prodhuese dhe eksportuese e disa materialeve të ndërtimit, *mbetet sfida afatmesme harmonizimi i këtij legjislacioni dhe krijimi i infrastrukturës së nevojshme për këtë fushë prioritare për biznesin dhe ekonominë shqiptare.*

Referuar **bombolave të gazit** që përdoren për ngrohje apo gatim, mbetet problematike rregullimi i duhur ligjor e institucional që do garantojë sigurinë e bombolave të gazit, *ngjashmërisht me rregullimet e nevojshme ligjore edhe në fushën e pajisjeve ngritëse e transportuese të natyrës industriale, të përcaktuara në direktivat përkatëse të BE si ajo 2000/9/EC, të cilat janë disa nga sfidat afat-shkurtra në përgjegjësi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë*

Siguria e instalimeve të **ashensorëve** për përdorim civil është fushe komplekse dhe që kërkon ndërhyrje të përshtatshme ligjore dhe institucionale në kuadër të transpozimit të direktivës 2014/33/EU, e cila është sfida afat-shkurtër e MZHETTS në kuadër edhe të krijimit të Inspektoratit për mbrojtjen e konsumatorit.

Referuar disa problematikave te lartpërmendura, si dhe detyrimeve në kuadër të MSA-së vazhdon të mbetet prioritet harmonizimi dhe përditësimi i legjislacionit sektorial të sigurisë se produkteve/instalimeve duke ndjekur zhvillimet në nivel evropian në këtë fushë.

Përveç operatorëve ekonomikë të përgjegjshëm që ndërmarrin kostot e nevojshme për të qënë në përputhje me kërkesat ligjore të sigurisë se produkteve, mund të ketë gjithnjë operatorë që nuk përfillin rregullat e sigurisë teknike, duke synuar një fitim të shpejtë dhe të padrejte. Këto praktika jo vetëm që shtrembërojnë funksionimin e tregut, por gjithashtu çorientojnë apo mashtrojnë konsumatorët duke kërcënuar interesin publik që synon të mbrojë legjislacioni shqiptar.

Përgjigja është Mbikëqyrja e Tregut prej rrjetit të strukturave përgjegjëse/Inspektorateve në varësi të ministrive përkatëse të linjës për fushat e veta të veprimtarisë, duke krijuar një pengesë të fuqishme ndaj tregtarëve që përpiqen t'i shmangen rregullave duke nxitur keshtu përmirësimin e funksionimit të tregut, sjelljes së operatoreve ekonomike dhe rritjes së konkurrencës së lirë e të ndershme.

Në fushën e naftës dhe gazit, nga analizimi i mostrave në laboratorin e akredituar të ISHTI, rezulton se në vitin 2012, 5,9% e tyre kanë patur shmangie nga treguesit cilësorë të standardeve nga 9,6 % në vitin 2010.

Referuar të dhënave nga ISHTI, lidhur me aksidentet e shkaktuara nga goditjet e tensionit të ulët për periudhën 20013-2014, rezulton të kemi numër aksidentesh me humbje të jetës, prej 39 personash. Këto aksidente, të cilat kanë ndodhur në ambientet familjare vijnë si pasojë e sigurisë së pa mjaftueshme të instalimeve elektrike në apartamente dhe ndërtesat e banimit, të mos vendosjes së pajisjeve mbrojtëse në rast defekti elektrik (rënie në masë), si dhe nga kryerja e punimeve dhe instalimeve elektrike nga persona apo subjekte që u nuk njihet kompetenca në këtë fushë.

Një nga masat fillestare detyruese për uljen e numrit të aksidenteve qe lidhen me këtë çështje, është futja e reles diferencialo-termike (salva-vita) në instalimet elektrike të banesave ekzistuese, në ambientet sociale dhe qendra të ndryshme publike do të mënjanojnë mjaft numrin e aksidenteve me vdekje nga goditja e rrymës elektrike të tensionit të ulët, por që gjithsesi kërkon një rregullim të posaçëm ligjor për ekzekutimin e këtij detyrimi si në instalimet e reja, po ashtu edhe në instalimet ekzistuese, ku për këto të fundit nevojitet të llogaritet edhe efekti ekonomik si dhe si do të përballohet ky efekt ekonomik.

Nga ana e ish IQT, me burimet ekzistuese të saj, janë kryer tashme disa aktivitete sporadike/modeste të mbikëqyrjes së tregut në kuadër të legjislacionit të ri horizontal dhe sektorial të lartpërmendur, kryesisht në lidhje me markimin CE, instruksionet e përdorimit në gjuhën shqipe, dhe janë marrë disa masa për ndalimin e tregtimit dhe tërheqjen nga tregu të produkteve kur ato janë njoftuar nga strukturat e Komisionit Evropian si të rrezikshme.

Kjo ka sjellë që produktet jo-ushqimore në tregun shqiptar të mos jenë nën një mbikëqyrje efektive të strukturave shtetërore, të cilat duhet të garantojnë qytetarët se produktet e ofruara në treg janë të sigurta, por jo vetëm. Humbja e besimit qytetar në funksionimin dhe zbatimin e ligjit ka pasoja negative jo vetëm në cilësinë e jetës së konsumatorëve por edhe në krijimin e një klime jo të favorshme për zhvillimin e konkurrencës së ndershme, rritjen e investimeve të huaja dhe zhvillimin e ekonomisë në tërësi.

Nga ana tjetër, krizat aktuale ekonomike sjellin sfida të reja për institucionet shtetërore që mund të përballen me presionin për reduktimin e burimeve dhe duhet të vendosin me kujdes prioritetet dhe të maksimizojnë impaktin e aktiviteteve të tyre zbatuese duke u bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe zbatimin e parimit të proporcionalitetit

Një mbikëqyrje efiçente dhe efektive e sigurisë së produkteve, sipas parimeve dhe kërkesave përkatëse ligjore, kombinimi i përpjekjeve të rrjetit të infrastrukturave përgjegjëse, organizimit të tyre efiçent dhe rritjes së njohurive teknike të specialistëve, është thelbësore për arritjen e të dy prej objektivave për garantimin e mbikëqyrjes së sigurisë në një treg funksional atë: i) të mbrojtjes së konsumatorëve prej produkteve/grup produkteve/pajisjeve/instalimeve jo të sigurta për shëndetin dhe jetën, si dhe ii) garantimin e konkurrencës së lirë e të ndershme midis operatoreve ekonomike.

Sfidë për të ardhmen mbetet fuqizimi i rrjetit të strukturave përgjegjëse ekzistuese dhe ngritja e strukturave përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut nën varësinë e ministrive përkatëse të linjës, për fushat përkatëse të veprimtarisë, të cilat duhet të jene të pajisura me burimet e domosdoshme njerëzore dhe financiare, për të maksimizuar efektin e aktiviteteve zbatuese për të garantuar një nivel të kënaqshëm të sigurisë së produkteve/pajisjeve/instalimeve të vendosura në treg.

1.1.3 Barnat për përdorim njerëzor

Legjislacioni kuadër në fushën e barnave për përdorim njerëzor, nga viti 2007 deri në vitin 2013, ka pësuar ndryshime në funksion të përafrimit të tij me Direktivat e BE-së.

Disa nga reformat ligjore lidhur me sektorin e barnave:

- Miratimi në vitin 2013 i Rregullores “Për Praktikën e Mirë të Fabrikimit të Barnave për përdorim njerëzor në Republikën e Shqipërisë”, (2003/94/EC), me qëllim rregullimin e prodhimit farmaceutik vendas.
- Plotësimi i kuadrit ligjor mbi regjistrimin e barnave, duke parashikuar një procedurë të përshpejtuar të regjistrimit të barnave (brenda 30 ditëve pune), kur këto barna janë regjistruar më parë në EMA, FDA.
- Ndryshimi i autoritetit përgjegjës për liçensimin e subjekteve, nga QKKB dhe Komisioni i Liçencave në MSH, tek Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik (DSHP). Kjo reformë do të shoqërohej edhe me ngritjen e strukturave farmaceutike në DSHP, por nuk rezultoi e suksesshme, sepse vlerësimi i kriterëve kryhej nga një autoritet i vetëm (DSHP), i cili nuk kishte kapacitetet teknike të duhura. Struktura farmaceutike pranë DSHP-ve nuk u ngrit dhe nuk funksionoi në asnjë rast;
- Ndryshimin e regjimit të importit të barnave të regjistruara në RSH dhe lehtësimin e procedurave të zhdoganimit të tyre.
Konkretisht, procedura e importit do të kryhej në pikat doganore të hyrjes në prani të inspektorit farmaceutik, por pa përcaktuar modalitetet se si do të realizohej ky proces. Për t'i dhënë zgjidhje situatës së krijuar për zhdoganimin e barnave dhe problemeve teknike të hasura në pikat doganore, në dhjetor të vitit 2008 me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, u vendos vazhdimi i procedurave të mëparshme, deri në firmosjen e një udhëzimi të përbashkët midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave. Kjo nismë e ndërmarrë në vitin

2008, nuk e ka ndryshuar regjimin e importit të barnave të regjistruara në Shqipëri. Në propozimet e bëra mbi ndryshimet e ligjit të barnave është e domosdoshme që bari të kontrollohet fizikisht në subjektin importues, por jo në pikën doganore duke qenë se do të nevojitet një strukturë e madhe në çdo pikë doganore.

Përdorimi i barit, efektet, paralajmërimet, doziteti, etj e tij, janë informacion tejet i rëndësishëm për konsumatorin dhe sigurinë e shëndetit të tij. Me gjithë kërkesën e detyrueshme në rregulloren përkatëse për fletë udhëzuesin në gjuhën shqipe që shoqëron barin, zbatimi i këtij detyrimi nuk është në nivele të kënaqshme. Duhet të procedohet rreptësisht me moslejimin e tregtimit të barnave të pa pajisur me fletë udhëzuesin të miratuar në gjuhën shqipe.

Sfidë për të ardhmen është që çdo bar të jetë i pajisur me fletë-udhëzues në gjuhën shqipe, gjë që mund të realizohet duke e bërë fletë-udhëzuesin pjese të procedues së importit.

Në vitin 2010, është ndërmarrë iniciativa ligjore për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të Farmakovigjilencës (QF). Megjithëse sektori i farmakovigjilencës në QKKB është ngritur që në vitin 2011, akoma nuk janë miratuar aktet nënligjore për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Farmakovigjilencës (QF), mënyrën e raportimit, mbledhjes dhe vlerësimit të efekteve të padëshiruara dhe/ose të dëmshme të barnave (ADR-ve).

E gjithë kjo problematikë, duhet të pasqyrohet me zgjidhjen e duhur në projekt ligjin e ri për barnat, që pritet të miratohet së shpejti.

Pavarësisht kësaj, sektori i farmakovigjilencës vazhdon monitorimin e barnave në treg. Është miratuar Formulari i Raportimit të Efekteve të Padëshiruara të Barnave në përputhje me Kartën e Verdhe; është bërë anëtarësimi në Programin e OBSH-së për monitorimin ndërkombëtar të barnave; janë vendosur kontaktet me autoritetet e tjera shëndetësore (spitale, qendra shëndetësore, farmaci, etj); janë shpërndarë fletëpalosje me informacionin përkatës për përdoruesit e barnave, me qëllim informimin, ndërjegjësimin dhe nxitjen e raportimeve.

Nxjtja e raportimeve të efekteve të padëshiruara dhe / ose të dëmshme të barnave nga përdoruesit e barnave, profesionistët e shëndetit, mbajtësit e autorizimit për tregtim të barnave, zbulimi, mbledhja, evidentimi dhe vlerësimi i tyre, mbetet një ndër prioritetet dhe objektivat kryesore të QKKB-së për të ardhmen.

Gjatë vitit 2011, është ndryshuar kuadri ligjor për pullën e kontrollit të barnave dhe dhënia me koncesion. Dhënia me koncesion është kontestuar nga të gjitha subjektet farmaceutike, si një veprim që nuk sjell asnjë risi në sistem dhe rezulton që është plotësisht e pastudiuar dhe e perealizueshme. Qëllimi kryesor është ngritja e sistemit të gjurmimit Track & Trace, i cili bën të mundur:

- kontrollin dhe verifikimin e dhënies së barnave nga farmacisti në përputhje me recetën e mjekut. Një nga problematikat kryesore që hasen në inspektimin e subjekteve farmaceutike është dhënia e barnave pa recetën e mjekut, ndikimi në skemën e rimbursimit të barnave, për të kontrolluar efektivisht të gjitha recetat e lëshuara për barnat që rimbursohen. Në këtë mënyrë, i pritret rruga çdo lloj lidhje korruptive midis mjekut dhe farmacistit, për të abuzuar me fondet e shtetit të destinuara për skemën e rimbursimit të barnave. Po punohet që të ndryshohen të gjitha koncesionet lidhur me pullën e barnave.

Gjatë vitit 2011, hyrja në fuqi e ligjit për inspektimin në RSH, solli domosdoshmërinë e harmonizimit të legjislacionit të barnave, në drejtim të standardizimit të procedurave të

inspektimit dhe kontrollit, gjë e cila fillimisht u reflektua në ndryshimet e ligjit për barnat në shkurt të vitit 2013.

Prioritet për QKKB-në, mbetet zbatimi i këtyre akteve, në veçanti i Rregullores së Inspektimit, e cila do të përcaktojë procedurat standarde të veprimtarisë inspektuese.

Nga ana e QKKB-së, kontrolli ka qenë i fokusuar në problematikat e tregtimit me pakicë të barnave pa pullën e kontrollit dhe çmimin e shitjes, tregtimin me pakicë të barnave në mungesë të drejtuesit teknik/nga persona pa arsimin farmaceutik përkatës, mosrespektimit të praktikave të ruajtjes së mire të barnave, mbajtjes së barnave të skaduara në farmaci, tregtimit të barnave pa recetën e mjekut, si dhe ushtrimit të aktivitetit të pa licencuar.

Është shumë e vështirë monitorimi në kohë reale i farmacive dhe subjekteve importuese dhe distributoreve pa qenë pjesë në procesin e licencimit.

Për periudhën 2008 – 2012 kontrolli i tregut farmaceutik është mbajtur në të njëjtat nivele inspektuese, pavarësisht tematikave dhe problematikave të ndryshme të konstatuara nga viti në vit. Shkeljet e konstatuara janë në një nivel mesatar 10,7% të subjekteve të inspektuara.

Për vitin 2011, rezultojnë më shumë subjekte të dënuar administrativisht (rreth 16,7% e subjekteve të inspektuara). Kjo për arsye se është bërë unifikimi i listës së subjekteve të licencuara dhe aktive në të gjithë territorin e vendit, sipas të dhënave të QKKB dhe QKL. Numri i subjekteve aktive, që ushtrojnë aktivitet farmaceutik është rritur me 17% krahasuar me vitin 2010. Rritja e numrit të farmacive jo gjithmonë përkon me cilësinë që duhet t'i ofrohet qytetarit.

Për garantimin e tregut me barna të sigurta, cilësore dhe efikase, në vazhdimësi është përmirësuar dhe është punuar për arritjen e standardeve bashkëkohore në drejtim të kontrollit të cilësisë së barnave. Laboratori i QKKB-së, kryen analizat e barnave të të gjitha formave farmaceutike. Në vitet 2007 – 2012, në sajë të fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit, janë prokuruar rreth 30 aparatura të reja, kërkese e domosdoshme, për arritjen e standardeve bashkëkohore, në përputhje me ato të laboratorëve të kontrollit të cilësisë, të institucioneve analoge evropiane.

Sfidë për të ardhmen mbetet akreditimi i Laboratorit të QKKB-së, me qëllim rritjen e besueshmërisë së kontrollit cilësor të barnave për përdoruesit e tyre, përmirësimi i sigurisë së barnave për përdorim njerëzor dhe sigurisë së pajisjeve mjekësore, duke ulur moskonformitetet e barnave të tregtuara çdo vit me 10% në krahasim me vitin paraardhës.

1.2 Infrastruktura e Cilësisë

Infrastruktura e Cilësisë (standardizim, metrologji, akreditim, testim-certifikim, vlerësim konformiteti) përbën themelin e reformave në tregun brendshëm, të cilat krijojnë premisat për vendime të rëndësishme lidhur me cilësinë e jetës së qytetarëve, në lidhje me mbrojtjen e shëndetit, ambientit, sigurinë e përgjithshme teknike, mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorit dhe të sektorit privat, në lidhje me cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të prodhuara në Shqipëri.

1.2.1 Standardizimi

Adoptimi i standardeve dhe përdorimi i tyre nga operatorët ekonomike është padyshim një nga elementët bazë të funksionimit të një tregu konkures dhe të sigurtë. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) nën Ministrinë përgjegjëse për tregtinë (MZHETTS) me 16 punonjës është organi kombëtar i standardizimit në Shqipëri për hartimin, adoptimin dhe miratimin e standardeve për të gjithë sektoret e ekonomisë.

Kuadri ligjor ekzistues në fushën e standardizimit, rregulloret teknike të brendshme të standardizimit dhe procedurat e instruksionet e punës, përbëjnë bazën ligjore dhe dokumentacionin e nevojshëm për ngritjen dhe funksionimin e DPS-së dhe organizimin e aktivitetit të standardizimit në nivel kombëtar. Amendimi në vitin 2011 i Ligjit Për Standardizimin (i vitit 2008) zgjeroi fushën e DPS lidhur edhe me adoptimin e standardeve të telekomunikacionit.

Gjithsej, janë adoptuar rreth 95% e totalit të standardeve EN të të dy organizmave evropiane të standardizimit, CEN dhe CENELEC, 25 % e standardeve të publikuara nga ETSI, 11% i totalit të standardeve të publikuara nga IEC dhe 14% të totalit të standardeve të publikuara nga ISO me metodën përkthimit të faqes së parë/“cover page”.

Numri i standardeve të përkthyer në shqip deri tani është vetëm rreth 400 standarde, ndërkohë që kërkesat nga blerësit janë shumë më të larta. Standardet më të kërkuara nga industria janë të fushës së ndërtimit (standarde produkti dhe metoda provash), pajisjet, enët nën presion, metodat e provave për detergjentet, etj

Shitjet e standardeve kanë një trend në rritje duke filluar nga 1404 standarde në vitin 2008, 1615 standarde në vitin 2009 e duke vijuar me 2055 (në vitin 2010), 805 në vitin 2011, 1648 për 2012 dhe 1846 standarde për 2013. Ky trend në rritje duhet të vazhdojë si një tregues i rëndësishëm i funksionimit të tregut të sigurtë.

Gjithashtu DPS disponon pajisjet operacionale të telekomunikacionit dhe infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, që e lejon atë t'i përgjigjet efektivisht volumit të madh të dokumentacionit, të komunikojë brenda sistemit të CEN&CENELEC dhe të marrë pjesë në procesin e votimit elektronik (kur kjo të jetë anetare me të drejta të plota në CEN&CENELEC).

E drejta e votës gjatë procesit të draftimit dhe miratimit të standardeve evropiane është e rëndësishme për mbrojtjen e interesave kombëtare, gjë që statusi *affiliate* që DPS ka deri tani nuk e lejon atë të ndikojë në mbrojtje të interesave të ekonomisë dhe industrisë së vendit.

Aktualisht po punohet për plotësimin e kushteve për anëtarim të plotë në CEN&CENELEC. Lidhur me këtë ka progres sa i përket zbatimit të parimeve të standardizimit evropian si transparenca në procesin e vendimmarrjes, konsensusi, pjesëmarrja vullnetare në procesin e hartimit dhe adoptimit të standardeve, zbatimi vullnetar i standardeve, përfaqësimi dhe gjithë përfshirja në procesin e hartimit deri në miratimin e standardeve të cilat janë të shprehura qartë në kuadrin ligjor ekzistues.

Po ashtu, adoptimi i standardeve evropiane (EN) si Standarde Shqiptare (SSH) në masën mbi 90% të totalit të standardeve evropiane të publikuara nga CEN&CENELEC është një tjetër kusht i plotësuar që kërkohet për anëtarësimin me të drejta të plota. Megjithatë në të shumtën e rasteve ky adoptim është bërë me metodën e “cover page” që do të

thotë se vetëm faqja ë parë është në shqip dhe teksti në gjuhën angleze.

Përveç vazhdimit të adoptimit të standardeve evropiane e ndërkombëtare si standarde Shqiptare, DPS do të duhet të punojë në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes aktive në punën kombëtare e evropiane të standardizimit si dhe rritjen e interesit të biznesit dhe konsumatorit për procesin e hartimit dhe miratimit të standardeve jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në atë evropian.

Aktualisht nga ana e DPS është miratuar rregullorja e brendshme që është udhëzuesi për ekspertët shqiptarë që do të marrin pjesë në punën evropiane të standardeve. Në këtë rregullore jepen udhëzimet se si ekspertët shqiptarë do të diskutojnë dhe kontribuojnë teknikisht për standardin evropian të planifikuar për miratim.

Si sfidë për të ardhmen mbetet adoptimi i 100% i totalit të standardeve CEN&CENELEC dhe ETSI, adoptimi i 40% të totalit të standardeve ISO dhe IEC, përkthimi i standardeve më të kërkuara nga blerësit, rritja me 2% çdo vit e shitjes së standardeve dhe harmonizimi i procedurave të standardizimit me ato evropiane me qëllim afatgjatë plotësimin e kushteve teknike për anëtarësim me të drejta të plota të DPS-së, në CEN&CENELEC.

1.2.2 Akreditimi

Kuadri ligjor evropian në fushën e akreditimit dhe ai kombëtar për mbikqyrjen e tregut si dhe përmirësime të tjera sektoriale i kanë kushtuar rëndësi të veçantë akreditimit. Ai është cilësuar si mjeti më efikas për të rritur shkallën e besueshmërisë së testimeve në veçanti dhe vlerësimeve të konformitetit në përgjithësi. Shumë akte ligjore në Shqipëri i referohen akreditimit të organizmave të vlerësimit të konformitetit për të garantuar kompetencën teknike të tyre. Ligji nr. 10489 datë 15.12.2011 e parashikon akreditimin si parakusht për organet të cilët kërkojnë të miratohen/liçensohen për të kryer vlerësimin e konformitetit në fushën e detyrueshme. Gjithashtu ky ligj parashikon që në raste të dyshimeve të riskut serioz të një produkti, struktura e mbikëqyrjes së tregut vendos për testimin e tij vetëm në laboratorë të akredituar.

Në kontekstin e zhvillimit të industrisë dhe tregtisë, në Shqipëri kërkohet gjithmonë e më shumë njohja e raporteve të testimit apo certifikatave të lëshuara nga laboratorët apo organet e vlerësimit të konformitetit shqiptare të akredituara, në vendet e BE-së, që kushtëzohet nga nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale të njohjes reciproke të Drejtorisë së Akreditimit me Organizatën Evropiane për Akreditimin në të gjitha fushat.

Kjo kërkon një funksionim sa më efikas të organizimit kombëtar të akreditimit (DPA), që duhet të plotësojë kërkesat e rregullores Evropiane 765/2008 si dhe kërkesat e standardit S SH ISO/IEC 17011:2005, njohjes nga Organizata Evropiane për Akreditim (EA) e akreditimeve të kryera prej DPA me qëllimin final për të krijuar një ambient konkurrues edhe për OVK shqiptare në tregun evropian dhe për të garantuar një besueshmëri më të lartë të testimeve, certifikimeve, etj dhe siguri të produkteve në tregun shqiptar.

Akreditimi në Shqipëri ofrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) nën Ministrinë përgjegjëse për tregtinë (MZHETTS) me 13 punonjës, e cila funksionon në bazë të ligjit nr. 9824, datë 1.11.2007 “Për akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nën-ligjore në zbatim të tij.

Legjislacioni në fushën e akreditimit parashikon organizmin akreditues shqiptar (DPA) si të vetmin organizëm kombëtar të akreditimit që ofron shërbimin e akreditimi tek organet e

vlerësimin të konformitetit. Megjithatë ka një përplasje ligjore për akreditimin e laboratorëve mjekësorë, ku akte të tjera ligjore kërkojnë akreditimin e këtyre laboratorëve nga Qendra Kombëtare e Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore”. Kjo bie në kundërshtim jo vetëm me Ligjin nr. 9824 por edhe me Rregulloren Evropiane 765/2008. Një përmirësim i kuadrit ligjor në këtë drejtim është një nga objektivat e DPA-së për vitin 2014. Mënyra e funksionimit e DPA-së siguron paanshmërinë, pavarësinë dhe kompetencën profesionale. DPA aktualisht ka ndërtuar dhe ka vënë në funksionim sistemin e tij të menaxhimit të cilësisë në përputhje me kërkesat e standardit S SH ISO/IEC 17011:2005, ”Kërkesa të përgjithshme për organizmat akreditues që akreditojnë organe të vlerësimin të konformitetit”. Ky sistem funksionon që nga vitin 2006 dhe është në përmirësim të vazhdueshëm.

Aktualisht janë akredituar 33 organizma të vlerësimin të konformitetit nga të cilët: 19 laboratorë testues, 12 organizma inspektues dhe 2 organizma certifikues. Gjatë viteve të fundit është konstatuar një rritje e numrit të aplikimeve për akreditim, duke kërkuar edhe fusha apo skema të reja akreditimi. Akreditimi i laboratorëve testues mbetet fusha më e interesuar ku vlen të përmenden laboratorët e ndërtimit, ushqimor dhe laboratorët e testimit të karburanteve. Në vitin 2013, janë rregjistruar aplikime për akreditim nga laboratorë testues të mjedisit (ajrit, zhurmave dhe pluhrave) apo nga ato të verifikimit metrologjik(matësave të energjisë elektrike). Një rritje shumë të madhe vitin e kaluar ka patur në kërkesat e trupave inspektues të pajisjeve nën presion në shërbim. Fusha më e kërkuar është inspektimi i enëve nën presion stacionare dhe inspektimi i pajisjeve që transportojnë mallra të rrezikshme. Rritja e numrit të aplikimeve ka ardhur jo vetëm si rezultat i detyrimeve ligjore por edhe si rezultat i rritjes së ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë lidhur me detyrimin e garantimit të përputhshmerise me nivelin e kërkuar të sigurise.

Për kryerjen sa më me cilësi të procedurave të akreditimit, DPA ka trajnuar në mënyrë të vazhdueshme stafin dhe vlerësuesit e saj. Ngritja e një sistemi rekrutimi për vlerësuesit është një nga aktivitetet parësore të DPA në këto vitet e fundit. DPA aktivizon edhe vlerësues të huaj në procedurat e akreditimit në ato fusha ku nuk ka burime njërëzore të mjaftueshme. Sot, DPA përballon aplikimet për akreditim me kapacitetet njerëzore që ajo ka por në të ardhmen me rritjen e numrit të aplikimeve dhe zgjerimit të fushave të akreditimit, do të dalë si domosdoshmëri rritja e numrit të punonjësve.

Katër komitete teknike janë krijuar që nga viti 2010, që hartojnë jo vetëm kërkesat dhe procedurat e akreditimit por edhe japin rekomandime për akreditim. Anëtarësimi në këto komitete siguron përfshirjen e palëve të interesuara, paanshmërinë dhe kompetencën profesionale. Bordi këshillimor i akreditimit funksionon pranë organizmit akreditues për hartimin e politikave dhe objektivave të DPA. Bordi i akreditimit mblidhet rregullisht katër herë në vit dhe ka në përbërje anëtarë nga të gjitha palët e interesuara. Kjo përbërje siguron gjithashtu edhe ekspertizën e nevojshme.

DPA është anëtare e asociuar në Organizatën Evropiane të Akreditimit (EA), Organizatën Ndërkombëtare të Akreditimit të Laboratorëve Testues (ILAC) dhe Forumin Ndërkombëtar të Akreditimit (IAF). DPA ka aplikuar në vitin 2008 për nënshkrimin e marrëveshjeve të njohjes reciproke në fushën e testimit me EA. Në vitin 2010 është kryer paravlerësimi nga grupi i ekspertëve të EA dhe në Mars 2013 të gjitha mos-konformitetet e gjetura janë zgjidhur plotësisht. Pritet që vlerësimi pozitiv nga EA të jepet në fund të vitit 2015.

Sfida për të ardhmen është nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale të njohjes reciproke me Organizatën Evropiane për Akreditimin në të gjitha fushat dhe anëtarësim me të drejta të plota në EA.

1.2.3 Metrologjia

Asnjë ekonomi tregu nuk mund të funksionojë pa një sistem kombëtar metrologjie, që të jetë në gjendje të realizojë matje të harmonizuara të njohura ndërkombëtarisht, në përputhje me sistemin ndërkombëtar të njësive të matjeve "SI".

Në ekonomitë e zhvilluara dhe në shtete të veçanta, përfshi ato që janë vende në zhvillim ose të gatshëm për të hyrë në tregun ndërkombëtar, matjet përbëjnë rreth 3-6 për qind të GDP. Sistemi i metrologjisë është një prej komponentëve kyç të infrastrukturës së çdo shteti.

Ky sistem mundëson sektorë të veçantë të Shtetit Shqiptar, që të operojnë normalisht dhe të kooperojnë si të barabartë me sistemet e metrologjisë jashtë vendit.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë në zbatim të legjislacionit në fuqi, është institucioni përgjegjës – ombrella - për të gjithë sistemin kombëtar në nivelin më të lartë, por mirëpret çdo institucion që demonstroi kompetencën e nevojshme, burimet në dispozicion, si dhe vullnetin për të operuar në sektorin e metrologjisë. **Sistemi kombëtar i metrologjisë** drejtohet dhe koordinohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) dhe përfshin:

- i) Laboratorët e etalonëve kombëtarë të matjeve që përfaqësojnë nivelin më të lartë të sistemit të metrologjisë në vend, dhe janë dhënë /sigurues të gjurmueshmërisë së matjeve në vend.
- ii) Laboratorët e verifikimit të instrumenteve matës në përdorim (testimit), të cilët kryejnë verifikimin periodik të instrumenteve matës në përdorim;
- iii) Laboratorët e autorizuar nga DPM për të kryer verifikime të instrumenteve matës në përdorim.

Në kuadër të implementimit të Strategjisë së Zhvillimit të Metrologjisë, është përgatitur kuadri ligjor në fushën e metrologjisë, që përbëhet nga Ligji nr.9875, datë 14/02/2008 “Për Metrologjinë”, dhjetë akte nën-ligjore (VKM), tetë urdhra të Ministrit të Ekonomisë dhe një sërë urdhrash të Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së, që mundësojnë implementimin në një shkallë të lartë të Direktivave përkatëse sektoriale të BE-së në lidhje me njësitë ligjore të matjes, instrumentet matës ligjorisht të kontrolluara, produktet e para-paketuara, shishet enë-matëse, etj.

Gjatë periudhës 6 vjecare të zbatimit të ligjit të lartpërmendur është konstatuar nevoja e rishikimit të tij, lidhur me ndryshimet strukturore për riorganizimin e inspektoratit metrologjik, paralelizmat apo mospërputhje me akte të tjera relevante ligjore dhe nënligjore, plotësime dhe qartësime. Gjithashtu nevoja e rishikimit të ligjit dhe akteve nënligjore është mbështetur edhe nga ekspertët e huaj të fushës.

Rishikimi i kuadrit ligjor në fushën e metrologjisë do të jetë dhe një nga objektivat afatmesëm.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), në varësi të Ministrit përgjegjës për Tregtinë është person juridik, publik, me 120 punonjës me qendër në Tiranë dhe e organizuar në 4 Sektorë Shërbimi Rajonale, përkatësisht në Tiranë, Fier, Lezhë dhe Korçë.

Ngritja dhe forcimi i infrastrukturës metrologjike për të përmbushur nevojat e vendit tonë, si dhe integrimi në infrastrukturën metrologjike evropiane dhe ndërkombëtare janë parë me përparësi nga Qeveria Shqiptare dhe donatorët e huaj.

Një ndër arritjet më të mëdha të metrologjisë në Shqipëri është ndërtimi i Qendrës Kombëtare të Metrologjisë, ku laboratorët e të cilës përmbushin kriteret e mbajtjes dhe ruajtjes së etalonëve të matjes, si dhe mundësojnë ofrimin e shërbimeve cilësore të kalibrimit të instrumenteve matëse.

Laboratorët janë pajisur me instrumente matës dhe etalonë matje bashkëkohore, për fushat më me interes për ekonominë e vendit tonë.

Janë zgjeruar dhe përmirësuar kapacitetet teknike me instrumente dhe etalonë matje në fushat e masës dhe madhësive që rrjedhin prej saj (forcë, fortësi, presion, densitet), madhësive elektrike (energji, rrymë, tension), termometri (temperaturë, lagështirë), gjatësi, volum, prurje. Për më tepër, u ngritën dhe u pajisen me instrumentet dhe etalonët e nevojshme laboratorët e rinj, të cilët ofrojnë shërbime në fushën e lagështirës, densitetit, matjeve kimike dhe alkoolit në frymëmarrje.

Laboratorët e masës dhe të forcës kanë qenë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit deri në prill të vitit 2013. Përballë kësaj situatë, DPM ka një plan akreditimi për të gjithë laboratorët e saj, brenda periudhës 2014-2016. Aktualisht, janë në proces aplikimi për ri akreditim në vitin 2014, laboratori i forcës dhe në proces aplikimi për akreditim laboratori i volumeve dhe presionit.

Në kuadër të sigurimit të gjurmueshmërisë dhe politikës për arritjen e nënshkrimit të Marrëveshjes shumëpalëshe me EA, akreditimi i laboratorëve do të realizohet nga trupa akreditues firmëtare të MLA-së me EA në fushën e kalibrimit.

Duhet theksuar që akreditimi i laboratorëve, përfshirë sigurimin e gjurmueshmërisë nëpërmjet procesit të kalibrimit të etalonëve të matjes, pjesëmarrja në ndër-krahasime apo testime të aftësive matëse dhe kalibruese, kalibrimin periodik të etalonëve, është proces që kërkon mbështetje financiare.

Laboratorët e masës, temperaturës, matjeve elektrike, forcës dhe presionit kanë marrë pjesë në disa testime ndër-krahasuese të aftësive matëse, ku janë vlerësuar pozitivisht nga organizatorët e këtyre veprimtarive.

Pjesëmarrja në ndër-krahasime duhet të mbetet një aktivitet i vazhdueshëm për të ruajtur performancën e laboratorëve dhe sistemin e cilësisë.

Në vijim të përmbushjes së kriterëve për njohje ndërkombëtare të kapaciteteve matëse të DPM-së, është arritur deklarimi i aftësive matëse dhe kalibruese në Database e Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave (BIPM KCDB), në fushën e masës.

Njohja e aftësisë matëse dhe kalibruese në nivelin më të lartë (në BIPM KCDB) mbetet një detyrë në të ardhmen për gjithë fushat e tjera të matjes.

Shërbimet e kalibrimit kanë ardhur në rritje, si në sferën e detyruar, kur ato kërkohen nga dispozitat ligjore në fuqi, ashtu dhe në sferën vullnetare si rrjedhim i kërkesave të standardeve të ndryshme mbi çertifikimin e produkteve, sistemeve të menaxhimit apo akreditimin e laboratorëve.

Kështu, në vitin 2012 u ofruan rreth 890 shërbime kalibrimi krahasuar me 300 në vitin 2008.

DPM bashkëpunon me institucione të tjera për të realizuar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e sa më shumë etalonëve të njësisë të matjes dhe transmetueshmërinë në fusha të veçanta matjeje, ku ajo nuk ka kapacitetet e nevojshme teknike.

Prej vitit 2008 DPM ka implementuar Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë në përputhje me SSH EN ISO/IEC 17025:2005, dhe ky sistem është deklaruar dhe miratuar në strukturat përkatëse të EURAMET në mars të vitit 2011.

Në nivel kombëtar, vendi ynë në vitin 2007 iu asociua Konferencës së Përgjithshme të Peshave dhe Masave (GCPM). Në nivel teknik, në vitin 2007 u nënshkrua Marrëveshja e Njohjes së ndërsjellë të Komitetit Ndërkombëtar të Peshave dhe Masave (CIPM MRA). Në vitin 2010 DPM u pranua anëtare me të drejta të plota në Organizatën Evropiane të Instituteve Kombëtare të Metrologjisë (EURAMET).

Në vitin 2009 u asociua në Kooperimin Evropian për Metrologjinë Ligjore (WELMEC). DPM merr pjesë aktivisht në 7 Komitete Teknike të EURAMET, si dhe në WELMEC-EURAMET Focus Group.

Metrologjia Ligjore është një aktivitet i rëndësishëm dhe tradicional i funksionimit të shtetit, që ka qëllim mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve nga matjet e pasakta në transaksionet tregtare dhe zyrtare, në fushat e sigurisë, shëndetit, ambjentit, etj nëpërmjet kontrollit metrologjik ligjor të instrumentave matës.

Një sistem efikas dhe mirëfunksionues i metrologjisë ligjore ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, në efektivitetin e aktivitetit të gjithë sektorit publik dhe në rritjen efektive ekonomike në sektorin privat.

Për metrologjinë ligjore është shumë i rëndësishëm sigurimi i harmonizimit të rregullave kombëtare me ato ndërkombëtare me qëllim mbështetjen e tregtisë ndërkombëtare për instrumentat ligjorisht të kontrolluar dhe parapaketimet. Bazuar në ligjin për metrologjinë, u mundësua ngritja dhe menaxhimi i sistemit kombëtar të metrologjisë ligjore në përputhje me nevojat kombëtare dhe kërkesat Evropiane.

Aktiviteti i DPM në fushën e Metrologjisë Ligjore mbulohet nga Drejtoria e Metrologjisë Ligjore (DML), strukturat rajonale të shërbimeve që varen prej saj, të cilat kryejnë kontrollin ligjor të instrumentave matës, si dhe nga Drejtoria e Inspektimit Metrologjik (DIM) që kryen inspektimin në përdorim të instrumentave matës dhe kontrollin e produkteve të parapaktuara.

Aktiviteti i kontrollit ligjor të instrumentave matës kryhet nga strukturat rajonale të shërbimeve të metrologjisë ligjore. Pas një procesi intensiv 5 vjeçar, u mundësua riorganizimi dhe konsolidimi i strukturave zbatuese të metrologjisë ligjore:

- Janë ngritur 4 sektorë shërbimi rajonale të verifikimit, laboratorët e të cilave janë plotësuar me pajisje kontrolli moderne dhe që mbulojnë me shërbime metrologjike të gjithë territorin e vendit. Shërbimet verifikuese të Metrologjisë Ligjore janë organizuar bazuar në shërbime të specializuara sipas fushave kryesore (masë, volumë, rrjedhje, parapaketime) të cilat kryhen, si në laboratorët e qendrave rajonale të verifikimit, ashtu dhe në vend përdorim të instrumentave matës, me anë të autolaboratorëve, duke rritur në mënyrë të ndjeshme gatishmërinë e ofrimit dhe cilësinë e shërbimeve.
- Janë zhvilluar një sërë aktivitetesh trajnuese brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të financimeve të Qeverisë Shqiptare dhe të projekteve të BE dhe BB. Janë zhvilluar një sërë aktivitetesh promovuese- ndërgjegjësuese për metrologjinë në nivel rajonal dhe kombëtar, adresuar biznesit dhe konsumatorit shqiptar .
- Janë futur në skemën e kontrollit ligjor 6 lloje të reja të instrumenteve matës dhe është rritur numri i subjekteve që kanë verifikuar instrumentet matës. Është rritur numri i subjekteve që

kanë verifikuar instrumentet matës nga 15,200 në vitin 2006 në 18,300 në vitin 2012 ose 20% më shumë, duke sjellë një rritje të të ardhurave me 47% të shërbimeve metrologjike

- Është kalibruar baza kontrolluese e 4 Qendrave Rajonale dhe e Drejtorisë së Inspektimit Metrologjik, që nuk ishte kontrolluar prej vitesh, duke siguruar kështu transmetueshmërinë e matjeve deri tek instrumentet matës në përdorim dhe duke rritur besueshmërinë në shërbimet metrologjike
- Në kuadër të përfshirjes së sektorit privat në shërbimet e metrologjisë ligjore janë autorizuar gjithsej 14 subjekte. Nga këta dy subjekte/laboratorë privatë për verifikim të matësve të energjisë elektrike, dy për verifikimin e matësve të ujit të pijshëm, tre për verifikim të cisternave rrugore; pesë subjekte private për shërbim riparimi dhe testimi të përkohshëm të distributorëve të karburantit dhe dy për peshoret automobilistike. Nga laboratorët e autorizuar nga DPM për kryerjen e shërbimeve metrologjike, vetëm dy laboratorë janë akredituar. Referuar kërkesave ligjore, laboratorët duhet të akreditohen brenda një periudhe 3 vjeçare nga data e marrjes së autorizimit.
Kjo procedure/parashikim ligjor nuk është në linjë me parimet e miratimit të organeve të vlerësimit të konformitetit të parashikuara në ligjin horizontal për tregtimin e produkteve dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore, në lidhje me akreditimin si parakusht për miratimin/autorizimin dhe me autoritetin miratues/autorizues. Për këtë qëllim këto do jenë pjesë e rishikimit në kuadër të hartimit të ligjit të ri për metrologjinë.

Megjithëse është ndërtuar sistemi kombëtar i metrologjisë ligjore, ende nuk është në nivelin e duhur efektiviteti i kërkuar i këtij sistemi.

Është e nevojshme konsolidimi i këtij sistemi në fushat ekzistuese dhe zgjerimi edhe me fusha të reja veçanërisht në atë të shëndetësisë, të cilësisë së produkteve ushqimore, të sigurimit teknik. Nga ana tjetër me gjithë përpjekjet e bëra nuk është arritur niveli i kërkuar i përgatitjes teknike profesionale të stafit të strukturave verifikuese dhe i bashkëpunimit të këtyre strukturave me ato inspektuese.

Vlerësimi i konformitetit të instrumenteve matës është në fazë fillestare dhe aktualisht nuk ka asnjë trupë të autorizuar për këtë qëllim. Është miratuar kuadri ligjor dhe rregullat teknike për instrumentet matës, por në perspektivën e afërt, nuk është planifikuar të investohet më tej në këtë drejtim për arsyen e mungesës së prodhimit vendas të instrumenteve matëse. Problematika ose detyra të veçanta në këtë fushë do të mbulohen nga DPM.

Inspektimi Metrologjik

Një ndër misionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë është mbrojtja e konsumatorëve, nëpërmjet organizimit të kontrollit metrologjik ligjor të instrumenteve matës që përdoren në fushat e transaksioneve zyrtare dhe tregtare, mbrojtjes së shëndetit, mjedisit dhe sigurinë teknike, si dhe kontrolli sasior i para paketimeve.

Inspektimi Metrologjik është kontrolli që kryhet në lidhje me prodhimin, importimin, instalimin, ruajtjen dhe riparimin e instrumenteve matës dhe me konformitetin e produkteve të parapaktuara për zbatimin e ligjshmërisë në fushën e Metrologjisë. Aktiviteti kryesor i Drejtorisë së Inspektimit Metrologjik (DIM) është të kryejë inspektime mbi:

- Instrumentet matës në përdorim dhe në treg
- Përdorimin korrekt të njësive të matjes

- Konformitetin e sasisë së produkteve të para-paketuara.

Me gjithë rritjen e performancës në vite të inspektimit metrologjik, akoma mbetet i madh numri i subjekteve që kryejnë shkelje në fushën e matjeve. Kryerja me kompetencë teknike e inspektimeve metrologjike kërkon nga njëra anë kompletimin me mjete lëvizëse dhe autolabororë, të cilët sot janë në nivel të kufizuar dhe nga ana tjetër staf të trajnuar për të mbuluar gjithë fushat ku përdoren njësitë e matjes dhe aktivitete metrologjike.

Me gjithë intensifikimin e kontrollit në prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen me pakicë të produkteve të para paketuara, mungon interesimi i kompanive prodhuese për miratimin e një sistemi të kontrollit në procesin e prodhimit të produkteve të para paketuara, i cili parashikohet si vullnetar nga legjislati. Ende nuk ka asnjë kompani prodhuese të produkteve të para paketuara që të ketë aplikuar për miratimin e sistemit të kontrollit në procesin e prodhimit.

Në kuadër të ndërgjegjësimit publik, është botuar dhe përditësohet faqja e internetit të DPM-së, janë ndërmarrë një sërë fushatash inspektuese në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Inspektoratin Qendror Teknik, si dhe në bashkëpunim me shoqatat në mbrojtje të konsumatorit, janë përkthyer libra të ndryshëm dhe broshura të karakterit teknik dhe organizativ të metrologjisë si dhe është botuar gazeta periodike “Metrologjia”.

Në nivel kombëtar, do të punohet për përmirësimin dhe mirëfunksionimin e një sistemi kombëtar efektiv të metrologjisë, i cili do të sigurojë një shërbim të qëndrueshëm dhe cilësi të lartë për aktivitete dhe shërbime të ndryshme.

Prioritet do të ketë zbatimin e kompetencave përkatëse teknike për kryerjen e shërbimeve të metrologjisë dhe në adaptimin e këtyre shërbimeve në funksion të nevojave kombëtare.

Për ndërtimin dhe zhvillimin e një sistemi efektiv kombëtar të metrologjisë, janë vlerësuar kërkesat ndërkombëtare, nevojat Shqiptare dhe kapacitetet Shqiptare.

Duke marrë në konsideratë kushtet specifike të Shqipërisë, zhvillimi në të ardhmen i infrastrukturës së metrologjisë do të përqendrohet në:

- Shtirjen e shërbimeve metrologjike në fushat me interes për ekonominë e vendit dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve;
- Njohjen ndërkombëtare të shërbimeve metrologjike;
- Funkcionimin me efektivitet të plotë të laboratorëve të Qendrës Kombëtare të Metrologjisë;
- Zgjerimin e veprimtarisë në fushat ekzistuese të kalibrimit dhe verifikimit të instrumenteve matës dhe shtrirja në fusha të reja, që ndihmojnë biznesin dhe mbrojnë konsumatorin;
- Rekrutimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore për të ngritur një strukturë profesionale në shërbim të nevojave kombëtare;

Sfida për të ardhmen është zgjerimi dhe rritja e cilësisë së shërbimeve metrologjike si dhe arritja e njohjes ndërkombëtare të tyre, nëpërmjet akreditimit të laboratorëve të tyre.

Përmirësimi i paketës ligjore me objektiv plotësimin e nevojave të ekonomisë sonë, duke marrë në konsideratë eksperiencat më të mira të vendeve të BE-së.

1.3 Çështje të mbrojtjes së konsumatorëve që nuk kanë lidhje me aspektet e sigurisë

Hapat e ndërmarra nga Shqipëria në kuadër të reformave social-ekonomike në lidhje me fushën e mbrojtjes së konsumatorëve kanë mundësuar adoptimin e një kuadri ligjor rregullator që siguron një nivel të lartë të mbrojtjes së interesave ekonomike të konsumatorëve.

Ligji i ri horizontal për mbrojtjen e konsumatorëve i vitit 2008 dhe i amenduar në 2011, si dhe gjashtë aktet nënligjore, krijojnë një bazë të fuqishme ligjore për luftimin e praktikave të padrejta tregtare, kushteve të padrejta në kontrata, publicitetin çorientues, mungesën e informacionit paraprak përpara lidhjes së kontratave, veçanërisht në ato të kredisë konsumatore, paketave të udhëtimit kontratat në largësi; shitjet jashtë qendrave të tregtimit; kontratat e shërbimeve financiare në largësi, etj, dhe njëkohësisht duke i dhënë të drejtën konsumatorëve për heqjen dorë nga kontrata brenda 14 ditësh dhe kërkimin e kompensimit apo dëmshpërblimit. Ky kuadër ligjor zbatohet mbi të gjitha llojet e marrëdhënieve ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve e që kanë të bëjnë me mallrat apo shërbimet e konsumatorëve.

Ligji i lartpërmendur jo vetëm që shënon një progres të rëndësishëm në aspektin e transpozimit të direktivave përkatëse evropiane, por ai krijon edhe një kuadër eficient institucional për zbatimin e tij. Ky ligj ka krijuar Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorëve (KMK), që është një organ vendimmarrës kundrejt shkeljeve administrative të dispozitave të këtij kuadri ligjor, duke urdhëruar ndalimin e shkeljes, marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes dhe deri në vendosje të gjobave. Ky komision përbëhet nga 2 përfaqësues të MZHETTS, 2 përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe 1 përfaqësues i shoqërisë civile. Kjo përbërje ka patur qëllim arritjen e një shkalle të nevojshme pavarësie dhe paanshmërie në vendim-marrje.

KMK duke qenë një institucion i ri, që zbaton një kuadër të ri ligjor, ka ndjekur politikën e ndërgjegjësimit të operatoreve ekonomikë, parandalimit, urdhërimit për ndreqjen e shkeljeve apo ndalimin e menjëhershëm të shkeljes dhe vetëm në raste të përsëritura apo ekstreme ka marrë vendime për vendosjen e gjobave, niveli i të cilave në ligj nuk ishte parashikuar i lartë për arsyet e mësipërme.

Në këtë kontekst si dhe për të ndërtuar besueshmërinë seriozitetin dhe profesionalizmin e këtij institucioni, Komisioni ka filluar me iniciativën e tij shqyrtimin e kontratave të telefonisë fikse dhe mobile në lidhje ekzistencën e kushteve të padrejta për të gjithë operatorët kryesore në tregun e telefonisë si dhe disa praktika të padrejta tregtare, etj, duke marrë vendime përkatëse për eliminimin dhe ndreqjen e tyre, të cilat janë zbatuar nga operatorët ekonomikë.

Drejtoria e Tregut të Brendshëm ka shqyrtuar të gjitha draft-kontratat e operatorëve të telefonisë mobile dhe fikse dhe ka dërguar pranë AKEP komentet dhe sugjerimet, shumica e të cilave janë konsideruar nga ky institucion përpara miratimit të tyre.

Kjo qasje ka patur qëllim ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë jo vetëm për këtë legjislacion të ri, por edhe për funksionimin e një institucioni të ri të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve që ka vullnetin për ta zbatuar atë me paanshmëri.

Me qëllim ndjekjen e zhvillimeve ligjore në nivel evropian dhe problemet e hasura gjatë fazës së zbatimit, në vitin 2011, Ligji i mbrojtjes së konsumatorëve u plotësua me disa shtesa dhe ndryshime që konsistojnë kryesisht në: fushën e zbatimit të tij, duke parashikuar zbatimin e

dispozitave më të favorshme për konsumatorin në rastet kur ekziston një legjislacion tjetër i veçantë; në shkrimin dhe madhësinë minimale të shkronjave në kontratat e konsumatorëve; përmirësime në dispozitat për kredinë konsumatore, detyrimin e tregtarëve për dhënien e informacionit me kërkesë të strukturave shtetërore; parashikimin e përgjegjësisë së tregtarit për mospërputhjet e shërbimit të siguruar konsumatorit me kushtet e kontratës, rritjen e nivelit të gjobave dhe vendosjen e statusit të nëpunësit të shërbimit civil si parakusht për anëtarësinë e KMK dhe eksperiencën minimale prej 3 vjetësh në këtë fushë për Kryetarin e këtij komisioni, me qëllim forcimin e paanshmërisë, gjë që është vlerësuar edhe në raportin e progresit të KE për Shqipërinë.

Gjithashtu pranë MZHETTS, që nga prilli i 2011, funksionon sistemi on line i paraqitjes së ankesave të konsumatorëve (www.kmk.al), i ngritur me mbështetjen e Programit të PNUD. Sistemi menaxhohet nga sekretariati teknik i Komisionit i Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe siguron një instrument alternativ, përveç postës zyrtare, për konsumatorët për të paraqitur ankesat e tyre, të cilat më pas kalojnë për shqyrtim në KMK.

Gjatë periudhës së funksionimit të tij Komisioni ka shqyrtuar shkeljet e dispozitave të kuadrit ligjor për mbrojtjen e konsumatorëve, në lidhje me çështje të tilla si: praktikat e padrejta tregtare; publicitetin çorientues, kushte të padrejta në kontratat e konsumatorit; mënyrën e faturimit të telefonisë fikse dhe të dorëzimit të faturave tek konsumatorët; mos përfshirjen e TVSH në çmimet e ofrimit të shërbimeve; kushte të padrejta në kontrata të kredive bankare; ankesave të konsumatorëve kundrejt operatorëve për shërbimet e furnizimit me energji elektrike, ujë dhe telekomunikacionit, mospërputhjen e shërbimit të ofruar me kushtet e kontratave të disa universiteteve private, etj.

Ky Komision ka marrë 30 vendime, kundrejt operatorëve të ndryshëm dhe sipas rastit ka urdhëruar ndalimin e shkeljes, masa për ndreqjen e shkeljeve, paralajmërime për mospërseritjen e shkeljeve të tilla, si dhe ka vendosur gjoba administrative, të cilat janë botuar në faqen zyrtare të MZHETTS-s. Në pjesën më të madhe, këto vendime, kanë gjetur zbatim nga subjektet që kanë kryer shkeljet.

Fushë tjetër e rëndësishme që kërkon kujdes të veçantë për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve, është ajo që ka të bëjë me informacionin për produktet që gjatë përdorimit të tyre kanë një ndikim të rëndësishëm të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në konsumin e energjisë, që do të thotë jo vetëm për produktet që përdorin energji, por edhe produktet që gjatë përdorimit të tyre nuk konsumojnë energji por ndihmojnë në konsumin e energjisë.

Dhënia e një informacioni të qartë, korrekt dhe të krahasueshëm luan një rol të rëndësishëm në funksionimin e tregut, duke i dhënë mundësinë konsumatorit/përdoruesit të fundit të bëjë zgjedhje të mirë-informuara në lidhje me efikasitetin e produktit dhe njëkohësisht nxit prodhuesit dhe importuesit që të vendosin në treg produkte sa më efikente ndaj energjisë, që tejkalojnë “minimumin e detyrueshëm të konsumit të energjisë”, duke ndihmuar në këtë mënyrë në uljen dhe kursimin e energjisë, që është një objektiv madhor në nivel global.

Ligji i ri “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji” i vitit 2012 përcakton detyrimet e operatorëve ekonomikë për sigurimin e këtij informacioni nëpërmjet skedës informative që shoqëron produktin.

Në zbatim të këtij ligji janë miratuar 5 akte nënligjore për informacionin e saktë që duhet të marrin konsumatorët në lidhje me klasën e efikasitetit të energjisë për makinat larëse të rrobave, larëset e enëve, makinat tharëse, frigoriferët dhe televizorët, duke parashikuar edhe periudhë 2

vjeçare për hyrjen në fuqi për t'i dhënë kohë operatorëve ekonomikë të marrin masa për të qenë në përputhje me këtë legjislacion të ri. Megjithatë, mungesa e kontrollit të zbatimit të këtij detyrimi ka lënë hapësirë për abuzivitet dhe mosrespektim të kërkesave ligjore nga ana e tregtarëve në dëm të blerjeve të informuara nga konsumatorët dhe zhvillimit të konkurrencës.

Fusha e kredisë konsumatore rregullohet me Rregulloret e Bankës së Shqipërisë “*Për kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare për individët*”, “*Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare*” dhe “*Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja*” në bazë të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve dhe atij për bankat.

Duke patur parasysh ndjeshmërinë dhe impaktin e kësaj çështje në interesat ekonomike të konsumatorëve, gjatë vitit 2013 u monitoruan ex officio 16 banka të nivelit të dytë në Tiranë lidhur me respektimin e legjislacionit të kredisë konsumatore. Rezultatet e monitorimit u bënë prezent në një takim me drejtuesit e bankave të nivelit të dytë, duke u kujdesur për theksimin e shkeljeve ligjore dhe mos përdorimin e emrave të bankave dhe sejcila nga bankat u bë me dije individualisht për gjithë llojet e shkeljeve. Kjo pati për qëllim sensibilizimin e gjithë aktorëve për gjendjen e përgjithshme të këtij tregu, prekjen e çështjeve që shqetësojnë dhe shtrembërojnë sjelljen e konsumatorëve. Bankave iu la afati kohor prej tre muajsh për marrjen e masave për ndreqjen e shkeljeve, afat pas të cilit nga KMK do të ndërmeret një monitorim i dytë dhe do meren masat administrative ndaj shkeljeve që do konstatohen.

Mbetet si *sfidë afat mesme monitorimi i bankave të nivelit të dytë kundrejt respektimit të kërkesave ligjore që lidhen me kredisë konsumatore*.

Një progres i rëndësishëm është bërë në **fushën e komunikimeve elektronike**, në lidhje me implementimin e portabilitetit të numrave të lëvizshëm brenda një afati të shkurtër kohor dhe ku parashikohet se ndërprerja e shërbimit gjatë procesit të mbartjes nuk do të jetë më e gjatë se një ditë. Kjo ka bërë që konsumatorët të përfitojnë nga mundësitë alternative për marrjen e shërbimit duke ruajtur të njëjtin numër të telefonit celular, si dhe të përfitojnë nga prezantimi i paketave dhe planeve tarifore më të ulura për këto shërbime. Deri në fund të vitit 2013 janë portuar 238 mijë numra të telefonisë së lëvizshme kundrejt 137 mijë numra të portuar deri në fund të vitit 2012. Gjatë vitit 2012 u implementua dhe portimi i telefonisë fikse. Në fund të vitit 2013, ishin 2900 numra të telefonisë fikse të portuar.

Amendimi i Ligjit për Komunikimet Elektronike, miratuar në 2012, ka përshtatur legjislacionin kombëtar me kërkesat e direktivave më të fundit të BE-së për komunikimet elektronike. Këto amendime në një sërë nenesh parashikojnë një mbrojtje më të mirë të konsumatorit për komunikimet elektronike duke vendosur detyrime për rritje të transparencës në informimin e konsumatorit për shërbimet e ofruara, marrjen e pëlqimit të konsumatorit për komunikimet tregtare të pa kërkuara, rregulla më të qarta për mbrojtjen e privacisë në komunikime elektronike, rregulla plotësuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis operatorëve dhe pajtimtarëve etj. Gjithashtu janë bërë një sërë rregullimesh në këtë ligji përsa i përket personave me aftësi të kufizuar me qëllim mbrojtjen e tyre si dhe të përfitimit maksimal nga shërbimet e komunikimeve elektronike. Në veçanti ligji parashikon garantimin e aksesit në komunikimet elektronike për personat me aftësi të kufizuar, mundësinë e tarifave për shërbime të përballeshme, konsultimin e akteve rregullatorë në veçanti me këtë grup shoqëror etj.

Gjithashtu në amendimet e vitit 2012 të Ligjit për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë është parashikuar një dispozitë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës në përputhje me kërkesat e direktivës së shërbimit universal.

Të drejtat e udhëtarëve të transportit ajror janë një tjetër element i rëndësishëm i mbrojtjes së konsumatorëve. Në këtë kuptim, Urdhri i Ministrisë të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (MTI) i vitit 2011, që miraton Rregulloren “Për përgjegjësinë e transportuesit ajror në lidhje me transportin ajror të pasagjerëve dhe bagazheve të tyre”, shënon një hap të rëndësishëm në përafrimin e legjislacionit tonë me atë evropian. Kjo Rregullore përcakton përgjegjësinë e transportuesit ajror shqiptar dhe të ZPEA (Zona e Përbashkët e Aviacionit Evropian) për t’u siguruar dhe për të dëmshpërblyer pasagjerët në rast të dëmtimeve të shkaktuara ndaj tyre dhe bagazheve; kufijtë minimale dhe/ose maksimale të dëmshpërblimit që detyrohet transportuesi ajror në varësi të demit të shkaktuar; detyrimin e transportuesit ajror për kryerjen e pagesave paraprake si dhe për të informuar pasagjerët në çdo rast mbi të drejtën e tyre për dëmshpërblim, rastet specifike në të cilat kërkohet dëmshpërblim dhe kufijtë kohorë për të pretenduar këtë të drejtë.

Në vijim, Udhëzimi i Ministrisë të MTI i vitit 2013 “Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës së gjatë të fluturimeve” përcakton dhe vendos kritere të detajuara për mbrojtjen e konsumatorit në lidhje me refuzimin e hipjes në avion kundër dëshirës së tyre, anulimit apo vonesave të fluturimit për pasagjerët që nisen nga një aeroport i vendosur në territorin shqiptar apo të ZPAE-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, dhe njëkohësisht përmbushen standardet përkatëse të kuadrit ligjor të kësaj fushe, si një nga detyrimet kryesore të implementimit të Marrëveshjes Shumëpalëshe.

Në strukturën e re të AAC-së, është krijuar tashmë sektori që merret me mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve dhe ka filluar vendosja e stendave informuese në ambientet e TIA-s (Aeroportit) për sensibilizimin e pasagjerëve në lidhje me të drejtat e tyre sipas përcaktimeve të Udhëzimit.

Megjithatë sfidë në këtë fushë mbetet zbatimi efektiv i këtij udhëzimi nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC)

Zhvillimi i sistemeve alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (të konsumatorëve)

Në drejtim të zgjidhjes jashtëgjyqësorit të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve, me mbështetjen e Programit CARDS 2006, është kryer një studim fizibiliteti, për ngritjen në Shqipëri të skemës për ndërmjetësimin, i cili parashikonte shfrytëzimin e infrastrukturës së Fondacionit Shqiptar për «Zgjidhjen e konflikteve dhe pajtimin e mosmarrëveshjeve», dhe zgjerimin e aktivitetit të tij edhe për mosmarrëveshjet konsumatorë-biznes. Me mbështetjen e projektit të UNDP, janë zhvilluar disa trajnime në lidhje me legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorëve dhe teknikat e ndërmjetësimit për një numër të konsiderueshëm ndërmjetësuesish për mosmarrëveshjet ndërmjet konsumatorëve dhe tregtarëve.

Dhënia e mbështetjes financiare për shoqatat e konsumatorëve

MZHETTS ka bërë gjithë përpjekjet e saj për sigurimin e një bashkëpunimi të vazhdueshëm dhe efektiv me shoqatat e konsumatorëve, nëpërmjet përfshirjes së tyre në aktivitetet trajnuese, në procesin e konsultimit gjatë hartimit të politikave kombëtare/strategjive, iniciativave ligjore, shkëmbimit të informacioneve, pjesëmarrjes reciproke në aktivitetet përkatëse, etj.

Për shkak të kufizimeve buxhetore, deri tani nuk është bërë e mundur financimi i shoqatave të mbrojtjes së konsumatorëve.

1.4 Zhvillimi i fushatave ndërgjegjëse dhe programeve të edukimit për çështjet konsumatore

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve dhe tregtarëve është pa dyshim një nga elementët që kontribuojnë në sigurimin e një klime më miqësore ndaj konsumatorëve si dhe rritjen e transparencës së praktikave tregtare. Për këtë qëllim, me synim njohjen e kuadrit ligjor të mbrojtjes së konsumatorëve dhe të sigurisë së produkteve, është zhvilluar një fushatë ndërgjegjëse për konsumatorët dhe operatorët ekonomikë, duke ju drejtuar konsumatorëve, nxënësve, operatorëve ekonomikë, mediave etj. Në kuadër të kësaj fushate janë zhvilluar:

- Aktivitete me rastin e 15 Marsit, ditës ndërkombëtare të konsumatorëve, përmendim aktivitetin me të rinj të shkollave të mesme të Tiranës, për sensibilizimin e tyre në lidhje me të drejtat e konsumatorëve, duke i konsideruar ata si përcjellësit më të mire të mesazhit tek moshatarët dhe prindërit e tyre,
- Seminare në disa prej qyteteve kryesore të vendit (Tiranë, Durrës, Korçë, Shkodër, etj), me mbështetjen e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë të këtyre qyteteve, ku dhe janë shpërndarë materiale informuese për biznesin dhe fletëpalosje për konsumatorët.
- Shpërndarja e 370.000 fletëpalosjeve ndërgjegjëse për konsumatorët dhe 80.000 broshurave informuese për operatorët ekonomik, në 20 qytete kryesore të Shqipërisë, nëpërmjet postës shqiptare.
- Shfaqja në media e 5 spoteve publicitare, me mbështetjen e projektit të UNDP, në lidhje me disa nga situatat më problematike si: kushtet e padrejta në kreditë e konsumatorëve, përdorimin e gjuhës shqipe në informacionin për konsumatorët, rëndësia e marrjes së kuponit tatimor, garancia ligjore për një periudhë prej 2 vjetësh, disa praktika për paketat e udhëtimit, sigurinë e ashensorëve, etj. Këto spote publicitare sensibilizuese janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë.
- Zhvillimi i disa takimeve në qytete të Shqipërisë, me përfaqësues të medias së shkruar dhe vizive, me synim rritjen e ndërgjegjësimit të tyre, për kuadrin ligjor dhe institucional të mbrojtjes së konsumatorëve.

Në fushën e sigurisë ushqimore, për ndërgjegjësimin e konsumatorëve, nga Autoriteti Kombëtar të Ushqimit (AKU) me mbështetjen financiare të projektit IPA 2007, është ndërmarrë një fushatë publicitare me shfaqjen e 6 spoteve televizive, që japin të dhëna lidhur me produktet ushqimore për të cilat konsumatori duhet të bëjë kujdes gjatë konsumit të tyre, për mënyrën e kontrollit të etiketave dhe për kushtet e ruajtjes së produkteve ushqimore.

Gjithashtu, në vitin 2012 u realizuar një sondazh me qëllim krijimin e një ideje të qartë për nivelin dhe njohuritë e konsumatorëve dhe për perceptimin që këta të fundit kanë për sigurinë ushqimore. Nga ky sondazh rezultoi se mediat elektronike janë mjetet më të besueshme të informacionit dhe si të tilla duhet të konsiderohen ato me efikasitet në rastet e fushatave me qëllim sensibilizimin e konsumatorëve për çështje të sigurisë ushqimore. Të anketuarit kishin njohuri të përgjithshme për AKU, por jo mbi mënyrën e funksionimit.

Në fushën e barnave janë zhvilluar fushatat sensibilizuese për profesionistët e shëndetit, QKKB ka organizuar 3 konferenca për farmakovigjilencën, në vitet 2010 – 2012. Objektivi kryesor ka qenë roli dhe rëndësia e Sistemit të Farmakovigjilencës në sigurinë e barnave, implementimi i Sistemit të Farmakovigjilencës në Shqipëri, survejimi dhe monitorimi i barnave për garantimin e sigurisë dhe cilësisë së tyre.

Gjithashtu, për ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e përdoruesve të barnave, gjatë viteve 2009 - 2011, janë prodhuar dhe transmetuar spote publicitare sensibilizuese për farmakovigjilencën, me qëllim denoncimin nga ana e përdoruesve të barnave të rasteve kur kanë patur efekte të padëshirueshme të barit, efekte anësore të pa përshkruara në fletë përshkrimin e barit apo kur bari nuk ka dhënë aspak efekt, për përdorimin e barnave me recetën e mjekut, me qëllim raportimin dhe sinjalizimin nëpërmjet numrit të telefonit dhe adresës së e-mail-it, të rasteve kur iu ofrohen barna në farmaci pa recetën e mjekut, në kuadër të forcimit të kontrollit mbi ofrimin e shërbimit farmaceutik .

Këto nisma të QKKB-së, kanë nxitur raportimin e efekteve të padëshiruara dhe/ose të dëmshme të barnave, si kombëtare edhe ndërkombëtare. Të gjitha rastet janë regjistruar, si burim informacioni për monitorimin e vazhdueshëm të sjelljes së këtyre barnave në tregun vendas. Për monitorimin e mëtejshëm të tyre janë vendosur ura bashkëpunimi, për shkëmbimin e informacionit me organizmat përkatës ndërkombëtar

Çështja e edukimit konsumator është e përfshirë në: i) arsimin bazë në programin e lëndës së edukatës shoqërore, ii) në arsimin e mesëm në programet e lëndëve “Qytetaria” dhe në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë është përgatitur si modul me zgjedhje “Edukimi financiar”.

Çështja e edukimit konsumator në shkolla po gjen zbatim në dokumentet kryesore kurrikulare të arsimit bazë dhe atij të mesëm. Në arsimin bazë, çështja e edukimit të konsumatorit është e përfshirë në programin e lëndës së edukatës shoqërore, në linjën e edukimit qytetar dhe edukimit ekonomik që përshkon këtë lëndë, krahas linjave të tjera të njohurive dhe aftësive.

Në arsimin e mesëm, edukimi konsumator gjen zbatim në programet e lëndës “Qytetaria” për klasën X-XI, si dhe në lëndën “Ekonomia” për klasën XII, ku konsumatori trajtohet kryesisht si faktor ekonomik, që ka një rol të rëndësishëm në ekonominë e tregut. Në gjimnaz është futur si modul me zgjedhje “Edukimi financiar”, përgatitur në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë.

Në kuadër të edukimit ekonomiko-financiar Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë disa nisma konkrete për krijimin e një kulture financiare në shoqërinë shqiptare. Nëpërmjet këtyre nismave, ajo ndihmon konsumatorët, prodhuesit dhe investuesit të marrin vendime të informuara financiare dhe njëkohësisht Bankën Qendrore të arrijë më lehtë objektivin e saj për arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Aktivitetet edukuese të Bankës së Shqipërisë aktualisht u drejtohen mësuesve dhe nxënësve të shkollave të mesme e nëntëvjeçare, studentëve e pedagogëve të fakulteteve brenda dhe jashtë vendit, gazetarëve të medias së shkruar e elektronike, punonjësve socialë, etj.

Në këtë kuadër Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë takime në shkollat e mesme, ka përgatitur broshura informuese si dhe ka publikuar në faqen zyrtare të saj një rubrike të veçantë për Komisionet dhe normat e interesit për shërbimet dhe produktet bankare.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë në fushën e kredisë konsumatore ka ndërmarrë një sërë nismash nëpërmjet publikimit të broshurave informuese apo publikimeve në faqen e saj zyrtare:

- **Teksti mësimor “Financat personale në Duart tuaja”, i shoqëruar edhe me librin e ushtrimeve për mësuesin.** Tekstet synojnë t’i njohë nxënësit dhe të aftësojnë mësuesit me botën e financave. Nxiti nxënësit të bëhen financiarisht të përgjegjshëm, konsumatorë të vetëdijshëm për vendimet dhe zgjedhjet që ndërmarrin. Për të arritur këtë objektiv, lënda i pajis nxënësit me njohuri teorike dhe aftësi praktike në fusha të tilla si: administrimi i parasë, produktet dhe shërbimet bankare, sistemi financiar, hartimi i

buxhetit, arritja e objektivave financiarë, përdorimi i matur i kredisë, investimet, kursimet, sigurimet dhe taksat.

- BSH, me miratimin e MASH ka ofruar trajnime për të gjithë mësuesit që japin lëndën “Financat Personale në Duart Tuaja”.
- **Rubrika “Komisionet dhe normat e interesit për shërbimet dhe produktet bankare” në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë**
- Në faqen e internetit të BSH, që nga korrik 2012, gjen të publikuara në mënyrë të përqendruar dhe të thjeshtë për përdorim, normat e interesit dhe komisionet për produktet dhe shërbimet që bankat në vendin tonë ofrojnë për publikun. Kjo gjë, synon përmirësimin e standardeve të transparencës, mbrojtjes së klientëve bankarë dhe ngushtimit të distancës bankë-klient, nëpërmjet lehtësimit të procesit të informimit mbi kosto-përfitimet më të përshtatshme që duhet të paguajnë apo përfitojnë për kreditë, depozitat, llogaritë rrjedhëse, kartat bankare etj. Raportimi është periodik tremujor dhe evidenton të dhënat për bankat individuale.
- **Broshura edukative.** Janë përgatitur dhe shpërndarë broshura edukative me qëllim informimin e grup-moshave të ndryshme mbi çështje të ndryshme financiare dhe bankare. Në fushën e kredisë konsumatore janë publikuar broshura, te tilla si: “*Paraja elektronike: e ardhmja e parasë?*”; “*Borxhi dhe kredia -një çështje interesi*”; “*Guidë rreth llogarisë tuaj të parë*”
- Gjithashtu, specialistë të BSH kanë zhvilluar takime dhe biseda mbi funksionin e Bankës së Shqipërisë, mbi sistemin bankar dhe administrimin e financave personale me nxënësit e rreth 30 shkollave të mesme, ku kanë pjesë në takime rreth 800 gjimnazistë të viteve të treta.

2 KAPITULLI II: VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET E POLITIKAVE

2.1 Vizioni i strategjisë

Konsumatorë të fuqizuar, të sigurtë dhe me besim në një treg të ndershëm, të sigurtë dhe konkurrues, ku ata mund të marrin pjesë aktive duke ushtruar të drejtat dhe fuqinë e tyre të zgjedhjes së mirë-informuar.

2.2 Qëllimet e politikave

Hartimi dhe zbatimi i politikave për krijimin e një mjedisi të përgjithshëm ligjor dhe institucional që i garanton konsumatorëve mbrojtjen e shëndetit, të sigurisë dhe interesave ekonomike, përmirësimin e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin, mbështetjen për një zbatim efektiv të të drejtave të tyre, me qëllim fuqizimin e konsumatorëve dhe rritjen e besimit të tyre për kryerjen e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve në treg, duke e bërë tregun të punojë për ta.

Bazuar në këtë qëllim strategjia do të bazohet në këto politika kryesore:

- 1) **Përmirësimin e sigurisë së konsumatorëve mbështetur në një infrastrukturë efektive të cilësisë sipas praktikave më të mira evropiane. Më specifikisht:**

- i) Përmirësimi i kuadrit ligjor për sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve dhe fuqizimi i sistemit të kontrollit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë

Përvoja aktuale me përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së tregon se është e rëndësishme të krijohet një qasje e koordinuar, strategjike dhe e mbështetur në prioritete, për procesin e përafrimit me BE-në në të gjitha fazat, duke filluar nga hartimi i planeve ligjore të përafrimit, hartimit të akteve të reja nënligjore dhe përgatitja e njëkohshme e institucioneve për të zbatuar legjislacionin e ri në mënyrë efektive.

Nevojitet përmirësimi i procesit të përafrimit të legjislacionit dhe zhvillimi i kapaciteteve institucionale në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural dhe në fushat e politikave të sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare duke futur një qasje më të integruar në punën për dy kapitujt, mbështetur në koordinimin e mirë brenda dhe ndërmjet ministrive, duke përfshirë të gjitha grupet përkatëse të interesit.

- ii) Përmirësimi i kuadrit ligjor për sigurinë e produkteve/grup produkteve/pajisjeve/instalimeve jo ushqimore dhe fuqizimi i sistemit ndër-institucional dhe eficient në mbikëqyrjen e tregut

Legjislacioni lidhur me kërkesat e sigurisë së produkteve/grup produkteve/pajisjeve/instalimeve jo-ushqimore përbën një pjesë të konsiderueshme të acquis dhe me gjithë progresin e mirë për transpozimin e tij duke filluar nga viti 2007, duhen vazhduar përpjekjet për transpozimin e plotë të legjislacionit teknik të produkteve dhe ndjekjen e zhvillimeve në nivel evropian për përditësimin e legjislacionit tonë duke u bazuar edhe në prioritetet apo problematikat e realitetit shqiptar.

Nga ana tjetër, vetëm një mbikëqyrje efektive dhe efiçente e zbatimit të kërkesave të sigurisë mund të garantojë që produktet në treg janë në përputhje me kërkesat teknike të sigurisë në lidhje me to. Ky do jetë një nga prioritetet e ministrive përkatëse të linjës me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së produkteve që ofrohen në treg dhe besimin e konsumatorëve.

Funksionimi efektiv i Infrastrukturës së Cilësisë sipas praktikave më të mira evropiane është një domosdoshmëri dhe mbështetje e rëndësishme për një treg të sigurtë për konsumatorët.

Plotësimi i mëtejshëm i nevojave të fushave të ekonomisë me standarde evropiane e ndërkombëtare do të kontribuojë në aftësitë inovative të vendit, rritjen e konkurrencës së biznesit vendas në tregun shqiptar dhe atë jashtë tij si dhe rritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të ofruara në tregun vendas në mbrojtje të jetës dhe shëndetit të njerëzve.

Politikat e zhvillimit të standardizimit do të fokusohen në përmirësimet e legjislacionit dhe procedurave të Drejtorisë së Standardizimit, zbatimin e parimeve të standardizimit, adoptimin e standardeve evropiane si standarde shqiptare dhe përkthimin e teksteve të atyre standardeve me interes për ekonominë e vendit, rritjen e numrit të shitjes së standardeve, rritjen e ndërgjegjësimit të grupeve të interesit për rolin e standardeve.

Politikat në fushën e akreditimit do mbështesin përmirësimet e legjislacionit përkatës për të reflektuar zhvillimet në nivel evropian, forcimin e kapaciteteve institucionale me qëllim afatmesëm njohjen e raporteve të testimin të laboratorëve testues të akredituar shqiptar në BE dhe në terma afat-gjatë njohjen e raporteve të certifikimit dhe inspektimit.

Në fushën e metrologjisë do të vazhdojnë përpjekjet për përmirësimin e legjislacionit në fushën e metrologjisë duke e harmonizuar atë me dokumentet dhe praktikën e mira evropiane,

për zgjerimin e shërbimeve metrologjike të kërkuara nga industria dhe biznesi dhe arritjen e njohjes ndërkombëtare të dokumenteve të lëshuara nga DPM, për rritjen e efikasitetit në kontrollin e produkteve të para paketuara. Vëmendje të veçantë do ti kushtohet zbatimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë si dhe rritjes së efektivitetit të metrologjisë ligjore nëpërmjet përmirësimeve ligjore, përmirësimit të sistemit të menaxhimit të aktiviteteve të sektorëve të shërbimit në Tiranë, Korçë, Lezhë dhe Fier si dhe përfshirjes së sektorit privat në kryerjen e shërbimeve metrologjike në fusha të caktuara.

iii) Përmirësimi i kuadrit ligjor për sigurinë e barnave dhe ofrimin e shërbimit farmaceutik bashkëkohor për përdoruesit e barnave.

Politikat kryesore të ndërmarra në sistemin farmaceutik vitet e fundit, kanë konsistuar në përafrimin e legjislacionit farmaceutik me direktivat e Bashkimit Evropian, procedurat e regjistrimit të barnave, reformën për licencimin e aktivitetit farmaceutik, procedurat e negociimit të çmimit të barnave dhe përcaktimit të “Çmimit të referencës për Shqipërinë”, si dhe në krijimin e sistemit të farmakovigjilencës. Në vendin tonë krahas këtyre politikave dhe reformave të ndërmarra një kontribut të rëndësishëm kanë edhe faktorët ndërkombëtarë, të cilët ndikojnë drejtpërdrejtë në përsosjen e sistemit, nëpërmjet mbështetjes financiare dhe trajnimit të burimeve njerëzore. Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet politikave të saj dhe strukturës përgjegjëse Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave, synon të garantojë barna të sigurt dhe cilësore për popullatën. Në sajë të këtyre politikave dhe reformës shëndetësore në tërësi, synohet një treg farmaceutik i hapur dhe afektiv, shumëllojshmëri barnash dhe akses i plotë ndaj tyre, furnizim i tregut me alternativa konkurruese, çmime disa herë më të ulëta, pa cënuar sigurinë dhe cilësinë, të cilat janë gjithmonë të kontrolluara dhe garantuara nga mekanizmat rregullatore të sistemit shëndetësor. Parimet e përgjithshme që ndiqen në këtë aspekt janë: transparenca, e drejta për informim, mos diskriminimi dhe trajtimi i barabartë i subjekteve farmaceutike, nxitja e konkurrencës së ndershme.

2) Përmirësimi i transparencës së tregut dhe praktikave tregtare për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve, duke përmirësuar dhe aksesin për dëmshpërblim dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Më specifikisht:

i) Përmirësimi dhe plotësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor që rregullon marrëdhëniet ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe konsumatorëve për mbrojtjen e interesave ekonomike të tyre dhe fuqizimi i efektivitetit të strukturave shtetërore të kontrollit.

Megjithëse kuadri ligjor i mbrojtjes së konsumatorit është i përafruar në një shkallë të lartë me atë evropian dhe ofron një bazë të qëndrueshme dhe të plotë për të mbrojtur konsumatorin shqiptar, procesi i përditësimit të tij është gjithmonë një domosdoshmëri që duhet të reflektojë zhvillimet në legjislacionin evropian, zhvillimet sociale dhe ekonomike përdorimin e praktikave tregtare të shitjes gjithnjë e më komplekse, etj.

Transpozimi i legjislacionit evropian është një mjet i fuqishëm për konsumatorët shqiptarë dhe i siguron atyre të njëjtin nivel mbrojtje me ata evropianë.

ii) Plotësimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësorit

Ky propozim i ri legjislativ synon t’i sigurojë konsumatorëve një zgjidhje alternative përveç rrugës gjyqësore që mund të marrë kosto dhe tepër kohë. Mosmarrëveshjet ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve në shumë raste janë edhe për vlera të vogla dhe në të tilla

raste ato neglizhohen nga konsumatorët duke patur parasysh që ndjekja në gjykata apo institucione të tjera mund të harxhojë kohë. Funkionimi i sistemit të ndërmjetësimit do të ndihmojë në zgjidhjen e këtyre rasteve dhe do të ndikojë në zbatimin më të mirë të ligjit duke plotësuar sistemin institucional të nevojshëm në mbrojtje të konsumatorëve.

Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve (ADR) ka për qëllim të sigurojë që skemat ADR të jenë në dispozicion në të gjithë sektorët, për të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet konsumatorëve dhe tregtarëve. Këto skema ADR duhet të respektojnë disa parime të tilla si: të cilësisë, të transparencës, paanësisë dhe efektivitetit në linje me parashikimet në legjislacionin europian. Konsumatorët duhet të informohen për ekzistencën e një skeme të ADR gjatë transaksioneve të blerjes.

3) Përmirësimi i edukimit të konsumatorëve për pjesëmarrje aktive në treg dhe përmirësimi i informimit dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve dhe operatorëve ekonomikë për të drejtat e konsumatorëve

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve është një proces dhe kërkon një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Përveç ditëve të informimit, standave informuese, botimeve apo fletëpalosjeve do t'i vihet përparësi edukimit të konsumatorëve që mund të fillojë që në moshat e vogla, edhe me elementë dhe gjuhë të thjeshtë. Gjithashtu, kjo do të ndiqet edhe me vazhdimin e fuqizimit të institucioneve zbatuese, të cilat janë përcjellësi më i mirë i mesazheve pozitive të konsumatorët për zbatueshmërinë e ligjit.

3 KAPITULLI III: OBJEKTIVAT E POLITIKËS DHE PRODUKTET MADHORE

3.1 Objektivat afat shkurtër deri në fund të 2015

1. Plotësimi i legjislacionit në të gjithë zinxhirin ushqimor në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve, si dhe harmonizimi i tij me kuadrin rregullator europian. Kjo sjell rritjen e standardeve të sigurisë ushqimore gjatë proceseve të prodhimit, përpunimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së ushqimeve duke rritur garantimin e mbrojtjes së shëndetit dhe interesave konsumatorit.

Do të përbëjnë produkte, hartimi i 20 akteve nënligjore të harmonizuara me kuadrin rregullator evropian.

2. Garantimi i sigurisë së ushqimit, produkteve ujore, vecanerisht molusqeve bivalve, sipas parimit nga ferma në tavolinë.

Realizimi i procesit të mësipërm do të kryhet sipas fazave dhe produkteve të mëposhtme:

- i) Vlerësimi dhe kategorizimi i stabilimenteve ushqimore në bazë të vlerësimit të riskut.
- ii) Kryerja e kontrollit zyrtar të ushqimeve në bazë të planit vjetor dhe shumëvjetor të kontrollit dhe mostrimit të hartuar në bazë të riskut dhe që përfshin çdo vit 50% të operatorëve të biznesit ushqimor me risk të lartë dhe të mesëm.
- iii) Rritja e nivelit të zbatimit të sistemit të gjurmueshmërisë duke rritur me 5% çdo vit numrin e operatorëve të biznesit ushqimor që aplikojnë atë.

iv) Vendim i Komisionit Evropian për listimin e Shqipërisë lidhur me të drejten e eksportimit në BE të molusqeve bivalve (për një zonë).

Kjo nënkupton që në planin afat mesëm duhen plotësuar gjithë kushtet që garantojnë sigurinë e molusqeve bivalve me nivelin evropian që përfshin zbatimin në terren të planit të monitorimit të zonës së prodhimit të molusqeve bivalve të gjallë, funksionimi në mënyrë korrekte i Qendrës së Depurimit të midhjeve në Sarandë, klasikimi i zonës së prodhimit të molusqeve bivalve të gjallë sipas kritereve të BE-së si dhe rishikimin e vazhdueshëm të mbikëqyrjes sanitare, funksionimi korrekt i sistemit të hapjes dhe mbylljes së zonës së prodhimit të molusqeve bivalve.

3. Garantimi i shëndetit të konsumatorëve nga parandalimi dhe eliminimi i risqeve ushqimore nëpërmjet:

Realizimit 100% i programeve kombëtare të monitorimit të mbetjeve, kritereve mikrobiologjike dhe kontaminanteve në kafshë të gjalla, produkte ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore, si dhe ujërave të molusqeve bivalve.

4. Fuqizimi i kapaciteteve administrativo-profesionale të AKU dhe infrastrukturës operative të saj, në veçanti të laboratorëve rajonalë dhe pikave të inspektimit kufitar.

Kjo do të arrihet duke realizuar:

- i) Trajnimin vjetor të 10% të stafit.
- ii) Unifikimin e metodave dhe metodologjive të analizimit të produkteve ushqimore; si dhe
- iii) Pjesëmarrjen në teste ndërkrahimore.

5. Fuqizimi i kapaciteteve institucionale në shërbimin veterinar.

Do të përbëjë produkt,

- i) Riorganizimi i shërbimit veterinar në nivel qendror, rajonal dhe vendor, si dhe
- ii) rritja e kapaciteteve të punonjësve përmes trajnimit vjetor të vazhdueshëm

.

6. Mbrojtja e shëndetit të kafshëve nga sëmundjet zoonotike që janë të transmetueshme nga kafsha te njeriu

Do të përbëjnë produkte,

- i) imunizimi 100% i bagëtive të imta në të gjithë vendin nga sëmundja e brucelozës si dhe gjurmimi i sëmundjes së brucelozës në gjedhë në 10% të krerëve çdo vit,
- ii) mbajtja nën kontroll të plotë të sëmundjes plasjes duke vaksinuar në të gjithë vatrat e këtij infeksioni dhe e TBC duke gjurmuar dhe eliminuar kafshët e infektuara në vatra.

7. Përcaktimi i veprimtarisë së laboratorëve të autorizuar të kontrollit zyrtar për analizat që ato janë përgjegjës të kryejnë si dhe publikimin e tyre.

Për këtë qëllim parashikohet realizimi i produkteve:

- i) Vlerësimi paraprak i Laboratorëve Rajonalë. Përgatitja e testeve të aftësisë për Laboratorët Rajonalë dhe në bazë të rezultateve të tyre do të realizohet autorizimi i pjesshëm për kryerjen e analizave për Shëndetin e Kafshëve.

- ii) Rritja e kapaciteteve teknike të Laboratorëve Rajonalë për realizimin e Analizave Ushqimore (mikrobiologjike dhe kimike). Këtu përfshihen ngritja dhe implementimi i standardit 17025, implementimi i Procedurave Operative Standarde që përdoren në ISUV si dhe trajnimi i stafit për metodat që përdoren në Laboratorët e Referencës.
- iii) Realizimi i kalibrimeve vjetore të Laboratorëve Rajonalë (përfshihen peshore dhe gurë peshe, termometra dytësorë, aparatura të ndryshme, etj)

Do të ndihmohen me përparësi laboratorët e autorizuar të cilët kanë si synim të tyre implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas standardit 17025..

- iv) Ngritja e sistemit të informacionit laboratorik (LIMS) si një nga prioritetet e punës së ISUV.

8. Krijimi i zonave të lira nga parazitët karantinor në pataten e hershme dhe nga zjarri bakterial në pemët frutore farore.

Do të përbëjë produkt, reduktimi në masën 10% çdo vit të parazitëve karantinor në pataten e hershme dhe reduktimi në masën 10% çdo vit i zjarrit bakterial.

9. Plotësimi i kuadrit ligjor teknik, përmirësimi i atij ekzistues si dhe përditësimi i legjislacionit sektorial të produkteve, në fushën e pajisjeve të transportueshme nën presion, fibrave tekstile, sigurisë së instalimeve në banesa, ashensorë, fishekzjarrë, pajisjeve mjekësore, të telekomunikacionit, etj.

Legjislacioni i produkteve i harmonizuar me atë evropian, që vendos kërkesa teknike të sigurisë që duhet të plotësohen përpara vendosjes së tyre në treg, është pa dyshim hapi i parë i domosdoshëm për heqjen e barrierave të panevojshme në tregti, por edhe garancia ligjore për nivelin e sigurisë së produkteve në tregun shqiptar të njëjtë me atë të qytetarëve evropianë.

- i) Në Shqipëri ka një numër të konsiderueshëm të pajisjeve nën presion dhe pajisjeve të transportueshme nën presion që janë në përdorim nga operatorë të ndryshëm ekonomikë, por edhe nga konsumatorët, siç është rasti i bombolave të gazit që përdoren për gatim apo ngrohje. Vakumi i krijuar ligjor lidhur me kërkesat e detyrueshme të sigurisë që duhet të plotësojnë bombolat përpara vendosjes në treg dhe gjate shfrytëzimit të tyre, ka sjellë që mund të jenë në qarkullim edhe bombola që nuk përmbushin kërkesat e sigurisë dhe që normalisht duhet të jenë jashtë përdorimit. Duke patur parasysh këtë shkallë të lartë të rrezikshmërisë së tyre, kjo do të jetë një fushë me prioritet të veçantë e ministrisë së energjisë dhe industrisë si domosdoshmëri edhe e transpozimit të direktivës së re evropiane për pajisjet nën presion të transportueshme. Këtu vëmendje e veçantë do t'i kushtohet jo vetëm kërkesave për vendosjen e tyre për herë të parë në treg, por edhe rregullimit të këtyre produkteve kur ato janë në përdorim ose shfrytëzim, duke përcaktuar periodicitetin e detyruar të inspektimit të tyre, mirëmbajtjen, përgjegjësitë e operatorëve përkatës ekonomikë, etj.
- ii) Fusha e tekstilit në Shqipëri ka nevojë për ndërhyrje fillimisht në aspektin ligjor, që do fillojë me transpozimin e Rregullores evropiane 1007/2001 që ka për qëllim ofrimin e informacionit të saktë për konsumatorët në lidhje me etiketimin dhe markimin e përbërjes së fibrës së tekstilit e cila mbetet gjithashtu një nga detyrat e MZHETTS.

- iii) Rregullimi ligjor në lidhje me përfshirjen e reles diferenciale termike (salva- vita) për mbrojtjen nga goditjet e rrymës elektrike të tensionit të ulët. Kjo do ketë një ndikim në uljen e rasteve të goditjes së rrymës nga tensioni i ulët e cila mbetet gjithashtu një nga detyrat e ministrisë së energjisë dhe industrisë.
- iv) Siguria e ashensorëve civile që janë vënë në përdorim është një problematikë e mbartur në vite dhe e parregulluar nga pikëpamja ligjore në aspektin e periodicitetit të detyruar të inspektimeve. Situata komplekse e krijuar në vite kërkon kujdes të veçantë jo vetëm në përgatitjen e legjislacionit për këtë qëllim, por duhet bërë kujdes që implementimi të shkojë paralelisht me funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës në varësi të MZHETTS.
- v) Miratimi dhe hyrja në fuqi e gjithë legjislacionit sekondar për një sërë grup produktesh si pajisjet nën presion, enët e thjeshta nën presion, pajisjet me gaz, ashensorët industriale përfshirë transportuesit kabllorë, sipas planit të veprimit pjesa e përdorimit jo familjare e pajisjeve elektrike që përdorin voltazh të ulët, pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente potencialisht shpërthyes, pjesa e përdorimit jo familjare të makinerive, pjesa e përdorimit jo familjare të boilerëve të rinj të ujit që përdorin lëndë djegëse të lëngët ose të gaztë, si dhe pjesa e atyre fushave të aplikimit industrial jo-ushqimore për përdorim prej sektorit jo-familjar, paraqet një emergjencë në kushtet e një boshllëku ligjor të krijuar me shfuqizimin e tyre, si pasojë e shfuqizimit të ligjit në bazë të cilit ishin nxjerrë, e cila mbetet gjithashtu një nga detyrat e ministrisë së energjisë dhe industrisë.
- vi) Fishekzjarrët janë pa dyshim produkte që mbartin rrezikshmëri për përdoruesin dhe për ata rrotull tyre dhe për këtë qëllim ato kanë rregullim të veçantë lidhur me vendosjen e tyre në treg dhe përdorim. Për këtë qëllim, është prioritet afat shkurtër transpozimi i direktivës përkatëse evropiane për fishekzjarrët e cila mbetet gjithashtu një nga detyrat e ministrisë së mbrojtjes.
- vii) Shqipëria dhe biznesi shqiptar ka një histori dhe përvojë relativisht të gjatë në prodhimin dhe eksportimin e disa grupe produktesh si çimento, tulla, etj në fushën e materialeve të ndërtimit. Kjo nënkupton përdorimin e kërkesave dhe standardeve teknike të larta evropiane nga ana e prodhuesve kur ata kërkojnë të eksportojnë dhe konkurrojnë në tregun rajonal dhe atë evropian. Kjo do të thotë që legjislacioni shqiptar duhet t'i paraprijë këtyre zhvillimeve të teknologjisë dhe jo të krijojë hapësira për konkurrencë të pandershme. Për këtë qëllim, transpozimi i Rregullores së re evropiane për materialet e ndërtimit duhet përfunduar deri në vitin 2016 e cila mbetet gjithashtu një nga detyrat e ministrisë së transportit.
- viii) Përgatitja dhe miratimi i ligjit për pajisjet mjekësore është një tjetër produkt në kuadër të përmirësimit afat mesëm të legjislacionit i cili do ketë për qëllim transpozimin e 3 direktivave përkatëse evropiane si dhe sigurimin e kuadrit të duhur institucional për implementimin e tij, e cila mbetet gjithashtu një nga detyrat e ministrisë së shëndetësisë.
- ix) Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese/informuese për organizatat e konsumatorëve dhe ato të biznesit

Ky është një element tepër i rëndësishëm në kuadër të krijimit të kushteve për respektimin e të drejtave të konsumatorëve por edhe për një klimë në favor të konkurrencës së ndershme ku operatorët ekonomikë janë të ndërgjegjshëm për detyrimet e tyre dhe rregullat e një loje të ndershme, gjë që çon në ofrimin e mallrave me cilësi më të lartë dhe çmime konkurruese në favor të konsumatorëve. Vetëm një ndërgjegjësimit dy palësh, shoqëruar dhe me mbikëqyrjen e tregut nga autoritetet shtetërore mund të sigurojë zbatimin korrekt të legjislacionit dhe funksionimin e ekonomisë së tregut të lirë konkurrues.

Do të përbëjnë produkte miratimi i rreth 20 akteve nënligjore për rregullimin e produkteve në fushat e lartpërmendura, sipas fushës së përgjegjësisë së çdo ministrie, të cilat pa dyshim që do t'i nënshtrohen një procesi konsultimi jo vetëm me ministrinë dhe institucionet përkatëse shtetërore por edhe me komunitetin e biznesit, organizatat e konsumatorëve. Kujdes të veçantë do t'i kushtohet edhe fushatave ndërgjegjësuere me qëllim zbatimin e duhur të këtij legjislacioni.

10. Krijimi i një baze fillestare të dhënash për nivelin e sigurisë së produkteve të konsumatorëve që janë në treg

Mbikëqyrje e tregut bazuar në vlerësimin e riskut nuk mund të kuptohet pa të dhëna të nevojshme për produktet/instalimet, vendin e tyre të origjinës, importuesit, nivelin e përgjithshëm të sigurisë të atyre të vendosura në treg, etj. Kjo është edhe më e vështirë në kushtet e mungesës së kryerjes së aktiviteteve mbikëqyrëse ose të kryerjes tepër të kufizuara dhe kjo bazë të dhënash duhet krijuar për herë të parë.

Produkti madhor:

- i) Plotësimi i rrjetit të strukturave shtetërore përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut dhe ngritja e Inspektoratit Shtetëror përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut mbetet një sfidë për vitin 2015 e në vijim që fillimisht duhet të fillojnë me mbikëqyrjen e tregut për fushën përkatëse të veprimtarisë. Ky kontroll gjatë vitit të parë do të ketë synim për të krijuar një pamje të përgjithshme për gjendjen e tregut, shkallën e mos-konformiteteve dhe e riskut serioz, etj. Krijimi i një baze të tillë të dhënash do shërbejë si një pikënisje e rëndësishme për planifikimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes në të ardhmen duke zbatuar parimin e vlerësimit të riskut. Gjithashtu, ndërtimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të inspektorëve është një parakusht për arritjen e këtij objektivi ambicioz por të domosdoshëm për sigurinë e gjithë qytetarëve shqiptarë.
- ii) Krijimi i sistemit elektronik të të dhënave mbi nivelin e sigurisë së produkteve/grup produkteve/pajisjeve dhe instalimeve që janë në treg/në shërbim krahasuar kjo me nivelin e sigurisë të përcaktuar në aktet ligjore teknike në fuqi, është parakusht për krijimin e bazave të të dhënave për të kuptuar nivelin e riskut serioz që paraqesin si dhe për planifikimin e aktiviteteve mbikëqyrëse, duke mundur të kështu hartimin e politikave dhe marrjen e masave përkatëse të minimizimit të riskut dhe qarkullimit të lire të atyre që janë të sigurta në treg. Kjo përfshin dizejnimin e kërkesave të këtij sistemi elektronik, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit si dhe trajnimin e personave përgjegjës për përdorimin dhe mirëmbajtjen e sistemit.

iii) Përgatitja dhe miratimi i VKM për ngritjen e Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut për Mbrojtjen e Konsumatorit pranë MZHETTS së bashku me miratimin e organigramës.

11. Ulja në nivelin nën 3% e mos-konformiteteve të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre ndaj kërkesave ligjore lidhur me treguesit cilësorë.

Ofrimi i këtyre produkteve me cilësinë e pritshme sipas kërkesave të detyrueshme ligjore ka një impakt të drejtpërdrejtë në interesat ekonomike të konsumatorëve, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e një mjedisi konkurrues të ndershëm për të gjithë operatorët ekonomikë që operojnë në këto fusha. Megjithëse nga kontrollet e ushtruara rezultojnë tendence në rënie të shkallës së mospërputhshmërisë së tregimit me pakicë të naftës, gazit, etj. ndaj treguesve cilësorë të detyrueshëm, perceptimi i konsumatorëve të intervistuar është se, krahasuar me vendet e rajonit, shqiptarët paguajnë më shumë kundrejt një cilësie më të ulët.

Për këtë qëllim dhe për të arritur objektivin e parashikuar, do të përbëjnë produkte:

- i) Rritja me 10% e kontrolleve të ushtruara në subjektet e tregimit me shumicë dhe pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre
- ii) Mirëmbajtja e akreditimit të laboratorit të naftës pranë ISHTI
- iii) Fuqizimi i kapaciteteve teknike të inspektorëve

12. Përmirësimi i sigurisë së barnave për përdorim njerëzor dhe sigurisë së pajisjeve mjekësore.

Barnat për përdorim njerëzor luajnë një rol kryesor në kurimin apo parandalimin e sëmundjeve të ndryshme, por ato mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut kur ato nuk përdoren sipas parashikimit, për shkak të mungesës së informacionit në fletë udhëzuesin që shoqëron barin, mund të mos përmbushin kërkesat e sigurisë, etj. Gjithashtu edhe garantimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore, të cilat akoma nuk janë rregulluar duhet të kenë gjithë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për krijimin e kuadrit të duhur institucional. Kjo kërkon jo vetëm krijimin e një kuadri të përshtatshëm ligjor por edhe zbatimin efektiv të tij, që kërkon sistemin e duhur institucional.

Për këtë qëllim, për arritjen e këtij objektivi do të përbëjnë produkte:

- i) Krijimi i Agjencisë Kombëtare së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Kjo agjenci do të jetë një riorganizim dhe zgjerim i kompetencave të Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave, duke patur edhe përgjegjësi të reja në fushën e pajisjeve mjekësore.
- ii) Hartimi dhe miratimi i Ligjit të ri për barnat. Ky ligj do të adresojë gjithë problematikën e përmendur në analizën e situatës në Kapitullin 1, përfshirë edhe atë lidhur me kontrollin e barnave në dogana, krijuar nga rregullimet ligjore të fundit.
- iii) Hartimi dhe miratimi i Rregullores së inspektimit, që do të ketë për qëllim standardizimin e procedurave të veprimtarive inspektuese të gjithë inspektorëve.
- iv) Hartimi i aktit nënligjor për rritjen e kontrollit dhe monitorimit të rrjetit farmaceutik lidhur me kushtet e ruajtjes, transportit dhe shpërndarjes së mirë të barnave

- v) hartimi dhe miratimi i Rregullores “Mbi mënyrën e raportimit, mbledhjes dhe vlerësimit të efekteve të padëshiruara dhe/ose të dëmshme të barnave”;
- vi) Krijimi i një harte të plotë të rrjetit të farmacive, importuesve dhe distributorëve. Kjo ka për qëllim nxitjen e efektivitetit të mbikëqyrjes së tregut në fushën e barnave dhe reduktimin e informalitetit.
- vii) Finalizimi i procesit të shqyrtimit dhe miratimit të fletë udhëzuesve të barnave në gjuhën shqipe të cilat janë të regjistruara dhe qarkullojnë në RSH.
- viii) Informatizimi i rrjetit farmaceutik dhe krijimi i një baze të dhënash kombëtare (ngritja e infrastrukturës dhe lidhja në rrjet e institucioneve shëndetësore dhe subjekteve private);
- ix) Fillimi i procesit të akreditimit të Laboratorit shtetëror të kontrollit të barnave dhe rritja e kapaciteteve analizuese të laboratorit dhe standardeve të kontrollit të cilësisë së barnave. Kjo ka rëndësi parësore në garantimin e barnave të sigurta, njohjen dhe besueshmërinë e rezultateve të testimit si nga ana e konsumatorëve ashtu edhe operatorëve ekonomikë.
- x) Organizimi i fushatave sensibilizuese për profesionistët e shëndetit dhe përdoruesit e barnave mbetet një element i rëndësishëm për arritjen e gjithë këtij objektivit madhor.

13. Adoptimi i standardeve evropiane e ndërkombëtare si standarde shqiptare.

Plotësimi i këtij objektivit është shumë i rëndësishëm për reduktimin e pengesave teknike të panevojshme në tregti, konkurrencën e ndershme, rritjen e sigurisë dhe cilësisë së produkteve vendase dhe për sigurinë e konsumatorit.

Do të përbejnë produkte adoptimi si standarde shqiptare i:

- i. 3400 standarde evropiane të publikuara nga CEN, CENELEC dhe ETSI;
- ii. 900 standarde ndërkombëtare të publikuara nga IEC dhe ISO.

14. Shitja e standardeve do të rritet çdo vit me 2% kundrejt vitit paraardhës.

Shitja e standardeve, veçanërisht ato të harmonizuara, është treguesi kryesor i arritjes së qëllimit për një ekonomi tregu funksionale dhe konkurruese. Megjithëse akoma kemi një ekonomi të orientuar më shumë ndaj importeve se sa prodhimit, gjë që pasqyrohet edhe në nivelin e shitjeve, përkthimi i standardeve në fushat prioritare të ekonomisë, është një faktor që nxit shitjen e standardeve dhe ndikon drejtpërdrejt në zbatimin korrekt të standardit nga ana e operatorëve ekonomikë shqiptarë. Pa dyshim që ndërgjegjësimi i konsumatorëve dhe operatorëve ekonomikë për përfitimet e përdorimit të standardeve, mbetet një detyrë në vazhdimësi.

Për këtë qëllim, do të përbejnë produkte:

- i) 4160 standarde të shitura
- ii) 40 standarde të përkthyer (të fushës së ndërtimit)
- iii) Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere

15. Njohja e raporteve të testimit të laboratorëve testues të akredituar shqiptar në BE.

Arritja e këtij objektivit është tepër i rëndësishëm për rritjen dhe zhvillimin e tregtisë, konkurrencës së ndershme dhe forcimin e mbrojtjes së konsumatorëve, nëpërmjet një mbikëqyrje efektive të bazuar në teste të sakta dhe të pranuar nga palët.

Legjislacioni aktual në fushën e akreditimit ku bazohet edhe funksionimi i DPA, ka nevojë për përmirësime për të qenë plotësisht i harmonizuar me Rregulloren Evropiane nr. 765/2008 “Kërkesa për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut”. Miratimi i ligjit të ri “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” do të zgjidhë përfundimisht edhe çështjen e akreditimit të laboratorëve mjekësorë.

Në fund të vitit 2015, sfida e DPA për nënshkrimin e MLA me EA do të realizohet duke përfshirë vetëm fushën e laboratorëve testues dhe ndërkohë DPA do të përgatisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për harmonizimin e procedurave të akreditimit dhe praktikat evropiane në fushën e certifikimit dhe inspektimit.

Ndërgjegjësimi në lidhje me vlerën e akreditimit do të çojë në rritjen e numrit të aplikimeve dhe si rrjedhim edhe të organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituara. Ky ndërgjegjësim do të jetë i fokusuar në disa grupe përfituesish duke filluar që nga qeveria dhe institucionet vendim-marrëse deri tek konsumatori i thjeshtë.

Do përbëjnë produkte:

- i) Marrëveshja e nënshkruar në fushën e laboratorëve testues (EA-MLA)
- ii) Harmonizimi i legjislacionit shqiptar dhe i procedurave të akreditimit me ato evropiane
- iii) Rritja e numrit të organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituara

- 16.** Përmirësimi i legjislacionit në fushën e metrologjisë në përputhje me direktivat evropiane. Ligji ekzistues për metrologjinë ka sjellë gjatë zbatimit të tij disa problematika si në aspektin teknik ashtu edhe lidhur me zhvillimet e reja ligjore në fushën e metrologjisë në Shqipëri.

Përbëjnë produkte:

- i) Rishikimi i Ligjit ekzistues “Për metrologjinë” duke marrë në konsideratë problematikën e vërejtur gjatë periudhës në zbatim të ligjit ekzistues dhe duke u mbështetur në dokumentet e OIML-së.
- ii) Hartimi dhe miratimi i VKM-së “Për etalonët kombëtare”, mbështetur në vërejtjet e ekspertëve të huaj dhe rekomandimet e EURAMET

- 17.** Njohja ndërkombëtare e shërbimeve të DPM-së në fushën e forcës dhe presionit dhe vazhdimin e përgatitjes për zgjerimin në pesë fushat e tjera.

Produktet:

- i) Akreditim i 7 laboratorëve (masë, forcë, presion, volum, elektrik, temperature, gjatësi), zgjerim i objektit të akreditimit në fushën e masës, forcës.
- ii) Njohja e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe në dy laboratorë të tjerë nga EURAMET (forcë dhe presion) .
- iii) Deklarimi në database të BIPM-se të 2 fushave (Forcë dhe presion).
- iv) Zgjerimi i bazës etalonuese në 5 fusha matje të laboratorëve elektrik (automatizimi i matjeve të tensionit të vazhduar), volumeve-rrjedhjeve (instrument matës për kalibrim rezervuarësh) dhe ngritja e laboratorëve: të kohë-frekuencës, të kontrollit të zurmave dhe të kontrollit të instrumenteve matës në fushën e shëndetësisë.

Rruajtja e njësisë së tensionit elektrik dhe transmetueshmëria e tij do të shërbejë në industrinë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Instrumentet matës për kalibrimin e rezervuarëve do të shërbejnë për fushën e hidrokarbureve dhe prodhimit të produkteve të lëngëta ushqimore. Laboratori i kohe-frekuencës do të shërbejë për vendosjen e kohës së saktë në telekomunikacion, televizione, transport dhe të nënshkrimeve elektronike (përdorimi i vulave kohore). Kontrolli i instrumenteve matës në fushën e shëndetësisë do të garantojë saktësinë e matjes së instrumenteve të fushës së shëndetësisë dhe analizave të ndryshme shëndetësore të cilat konsiderohen me prioritet për jetën dhe shëndetin e njeriut.

v) Realizimi i 3280 kalibrimeve (viti 2014-2015) në fushën e masës, forcës, volum, rrjedhjeve, gjatësi, presion, temperaturë, matje elektrike, lagështisë.

18. Realizimi i gjurmueshmërisë së matjeve në nivelin më të lartë ndërkombëtar.

Produktet:

- i) Etalone të rikalibruara në një institucion homolog të EURAMET të 7 Laboratorëve në fushën e elektrikut, temperaturë-lagështisë, forcës, presionit, volum-rrjedhjes, masës dhe matjeve dimensionale, që përbëjnë 42 instrumente matës, si edhe 3 sete masash kampion, si rezistenca elektrike, gramarë dhe blloqe fundor.

19. Forcimi i mbrojtjes së konsumatorit.

- a) Përmirësimit të menaxhimit të sistemit të metrologjisë ligjore dhe rritjes së numrit të verifikimeve dhe inspektimeve të instrumenteve matës ligjore me 2 %
- b) Ngritjes së sistemit të miratimit dhe monitorimit të sistemeve të kontrollit sasior të prodhuesit të produkteve të para-paketuara me shenjë konformiteti dhe forcimit të kontrollit të para paketimeve në treg, me qëllim uljen me 3% të jokonformiteteve që mbërrijnë tek konsumatori;
- c) Rritjes së shkallës së sigurisë së jetës së qytetarëve nëpërmjet futjes në skemën e kontrollit metrologjik ligjor të pajisjeve matëse të reja (matësve të shpejtësisë së automjeteve dhe matësve të nivelit të alkoolit në frymëmarrje).
- d) Transmetimit të njohurive bashkëkohore në fushën e metrologjisë tek biznesi dhe konsumatori nëpërmjet sigurimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në Metrologjinë Ligjore dhe Shkencore.
- e) Rekrutimit të stafit sipas akteve ligjore në fuqi dhe trajnim i vazhdueshëm i tyre, për t'u njohur dhe vënë në zbatim teknikat e reja të matjes dhe të kontrollit të instrumenteve matës

Produktet:

- i) Kryerja e 84,000 verifikimeve të instrumenteve matës në përdorim për vitin 2014-2015.
- ii) Kryerja e 11 mije inspektimeve për subjektet që përdorin instrumente matës dhe prodhues, shpërndarës dhe shitje me pakicë e produkteve të para paketuara.

- iii) Zgjerimi i kapaciteteve teknike me autolaboratorë për verifikimin e instrumenteve matës të hidrokarbureve, gazin e lëngshëm dhe produktet e para pakeluar Blerje e 3 autolaboratorëve dhe instrumente matës. Kjo diktohet nga shtrirja në të gjithë territorin e vendit e verifikimit të detyrueshëm ligjor të distributorëve të karburanteve, gazit të lëngshëm dhe produkteve të para paketuara, në mbrojtje të interesave të konsumatorit
- iv) Realizimi i fushatave ndërgjegjëse për biznesin (njësia matëse: numër takimesh; sasia 4).

Aktivitetet:

- i) Përgatitja, miratimi dhe implementimi i rregullave teknike të instrumentave matës, si dhe i procedurave teknike të kontrollit
- ii) Përgatitja e rregullave dhe procedurave të miratimit të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve me shenjë konformiteti. Implementimi i këtyre rregullave, planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse për fushën
- iii) Planifikimi, organizimi dhe kryerja e aktiviteteve të verifikimit metrologjik të instrumentave matës në laborator dhe në vendpërdorim.
- iv) Planifikimi, përgatitja e materialeve dhe organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse për metrologjinë ligjore në 4 sektorët rajonale të verifikimit
- v) Organizimi i trajnimeve dhe seminareve të ndryshme për stafin e sektorëve rajonale të shërbimit.

20. Plotësimi i legjislacionit në mbrojtje të interesave të konsumatorëve dhe zgjidhjeve të ankesave jashtë gjyqësorit

Produktet:

- i) Amendimi i VKM 1444 “Për funksionimin e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve”.
Ky akt nënligjor, i cili është aktualisht në fuqi, përcakton rregullat për funksionimin dhe procedurat e vlerësimit të shkeljeve nga Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve. Amendimi i këtij vendimi do të synojë të fuqizojë instrumentet dhe mekanizmat ligjor për të mbrojtur konsumatorin, të lehtësojë dhe të forcojë bashkëpunimin midis organeve shtetërore në funksion të mbrojtjes të interesave dhe të drejtave të konsumatorëve, me qëllim trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave me efikasitet dhe efektivitet.
- ii) Hartimi i VKM “Për kontratat e produkteve të udhëtimeve afatgjata”;
Legjislacioni i mbrojtjes së konsumatorëve shtrihet në disa fusha duke përfshirë edhe një sektor shumë të rëndësishëm për ekonominë shqiptare siç është turizmi. Turizmi është një sektor dinamik, i cili ndryshon vazhdimisht, duke ofruar një sërë produktesh të reja, ndër të cilat dhe produktet e udhëtimeve afatgjata. Konkretisht, VKM do të rregullojë një sërë aspektesh siç janë marketingu, shitja apo rishitja e këtij produkti, duke rritur kështu nivelin e mbrojtjes së konsumatorëve.
- iii) Hartimi i VKM “Për plotësimin e kritereve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësorit”.
Ligji 10444/2011 referon Këshillin e Ministrave që të përcaktojë kriteret për funksionimin e një strukture të krijuar posaçërisht për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësorit. Alternativat e zgjidhjeve jashtëgjyqësore janë: ndërmjetësimi dhe

arbitrazhi. Këto mekanizma jashtëgjyqësore, me anë të një palë të tretë, ndihmojnë konsumatorët të zgjidhin çështjet, kur mes konsumatorit dhe tregtarit nuk është arritur një marrëveshje. Ky akt, nëpërmjet transpozimit të Direktivës së re Evropiane 2013/11/EU, i ofron konsumatorit bazën e duhur ligjore për të arritur në një marrëveshje/zgjidhje më fleksibile, të shpejtë dhe me më pak shpenzime.

iv) Hartimi i akteve nënligjore mbi informacionin për efikasitetin e energjisë në produktet elektroshtëpiake.

Plotësimi i mëtejshëm i legjislacionit që ka lidhje me informacionin mbi efikasitetin e energjisë në produkte me ndikim në konsumin e energjisë.

21. Fuqizim i efektivitetit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve (KMK), nëpërmjet analizimit 100% të ankesave në fushën e energjisë, ujit, telefonisë fikse dhe celulare, si dhe në fushën e shërbimit të internetit që kanë impakt në interesat kolektive të konsumatorëve.

Do të përbëjnë produkte madhore:

- i) Trajtimi dhe shqyrtimi 100% i ankesave të konsumatorëve që prekin interesa kolektive
- ii) Shfuqizimi i kushteve të padrejta në këto kontratat tip

Ankesat e konsumatorëve janë një tregues i rëndësishëm se si tregu punon për konsumatorët, por edhe shprehje e nivelit të ndërgjegjësimit dhe edukimit të tyre. Duhet thënë që numri i ankesave është akoma i kufizuar dhe Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve do të vazhdojë shqyrtimin me iniciativën e tij të shkeljeve të mundshme sipas prioriteteve, përveç ankesave të paraqitura që pritet të jenë në rritje.

E ndare në kategori dhe vite:

2014: kontratat standarde të operatorëve në fushën e energjisë, të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;

2015: kontratat standarde të katër operatoreve kryesore në fushën e telefonisë fikse dhe celulare si dhe në fushën e shërbimit të internetit.

Komisioni do të bëjë vlerësimin e kushteve të kontratave, me synim evidentimin e kushteve të padrejta në to, e me pas shfuqizimin e këtyre kushteve. Ky proces do të kërkojë bashkëpunimin me institucionet rregullatorë përgjegjëse për fushat respektive: Enti Rregullator i Energjisë, Enti Rregullator i Ujit, AKEP.

22. Organizimi i sondazheve tek operatorët në fushën e kredisë konsumatorë, paketave të udhëtimit për vlerësimin e praktikave tregtare në fillim dhe pas masave nga KMK.

Do të përbëjë produkt madhor:

Ulja minimalisht me 20% e praktikave të padrejta tregtare me mospërputhje ligjore, në fushat e sipërpërmendura.

Megjithëse ankesat në fushën e kredisë konsumatore dhe paketave të udhëtimit janë të kufizuara, ekzistenca e kushteve të padrejta në to dhe mungesa e informacionit të plotë, të qartë dhe të sakte parakontraktor, përfshirë publicitetin, pritet të jetë më e gjerë. Për këtë qëllim do të kihet parasysh një qasje që fillon me vlerësimin e situatës në këto fusha, gjetjen e praktikave tregtare të pandershme apo shkeljeve të legjislacionit, dhe me pas evidentimi në tavolina/workshope me pjesëmarrje të gjithë palëve të interesuara i parregullsisve dhe së fundmi nxjerrja e

rekomandimeve përkatëse sipas një afati kohor. Pas kësaj do të monitorohet impakti në treg i rekomandimeve, shkalla e mos-përputhshmërisë së praktikave me dispozitat përkatëse ligjore, etj

Nëpërmjet kësaj qasje synohet përmirësimi i gjendjes duke parashikuar uljen minimalisht me 20% të praktikave me mospërputhje ligjore. Pa dyshim që kjo do të nxisë dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera shtetërore me përgjegjësi në fushat respektive si: Banka e Shqipërisë dhe ministrinë përgjegjëse për turizmin.

23. Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të konsumatorëve dhe operatorëve në lidhje me: me kuadrin e ri rregullator të sigurisë së produkteve, përfshirë fushën e të drejtave të udhëtarëve dhe fushën e produkteve kozmetike, si dhe të mbrojtjes së konsumatorëve.

Ky objektivi i shërben konsumatorëve, për t'ju mundësuar marrjen e një informacioni të qartë, të besueshëm dhe transparent nëpërmjet mjeteve të informimit si media (TV), fletëpalosje, website, organizimi i aktiviteteve të ndryshme informuese, përfshirë këtu ndërgjegjësimin e konsumatorit për paraqitjen e ankesave pranë KMK.

Do të përbëjnë produkte madhore:

- i) Organizimi i 6 tryezave informuese;
- ii) Përgatitja e materialeve informuese.

Në kushtet kur burimet e informacionit janë shtuar dhe sasia e informacionit me të cilat përballet konsumatori është shumëfishuar, përfshirë këtu edhe shtrirjen e internetit, informimi që u ofrohet konsumatorëve duhet të jete i qartë, i sigurtë, i vërtetë dhe krahasues duke u bere kështu pike kyce për të ardhmen e informimit të konsumatorëve. Përmirësimi i informacionit duhet të shoqërohet me rritjen e ndërgjegjësimit të të dy palëve, si konsumatorëve ashtu dhe tregtareve ndaj të drejtave dhe detyrimeve, si dhe me rritjen e besimit reciprok.

Organizimi i tryezave informuese për konsumatorët si dhe për operatorët do të kontribuojë për rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimin e njohurive të konsumatorëve, si dhe detyrimeve të operatorëve. Këto tryeza do të shërbejnë edhe përmbushjes së objektivave të tjera të parashikuara në strategji, të lidhura me hartimin e kuadrit të ri ligjor, organizimit të sondazheve, fuqizimit të strukturave shtetërore, etj. Këto aktivitete do të shoqërohen me përgatitjen e materialeve informuese, broshura, fletëpalosje, si dhe përmirësimin e informacionit në faqet zyrtare të internetit të ministrive apo institucioneve të tjera të lidhura me mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut.

Në kuadër të edukimit të publikut në fushën e kredisë konsumatore, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave, do të publikojë broshurën më të re, "**Klienti Bankar**". Kjo broshurë do t'i vijë në ndihmë qytetarëve në marrëdhëniet e tyre të përditshme me institucionet financiare në përgjithësi dhe me bankat në veçanti. Gjithashtu, kjo broshurë në formën e një nënrubrike e cila do të jetë pjesë e rubrikës "Edukimi" në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, duke synuar të informojë publikun mbi çështje bankare dhe financiare në një mënyrë sa më interaktive.

24. Përmirësimi i nivelit të këshillimit të konsumatorëve nëpërmjet funksionimit të qendrave të këshillimit, që drejtohen nga shoqatat e konsumatorëve.

Dhënia e këshillimit për konsumatorët duhet të jete e pavarur, e besueshme dhe e sakte si dhe për të siguruar lehtësimin e përdorimit ky proces duhet të jetë i përhapur gjerësisht në shkallë vendi.

Për këtë qëllim, ky objektivi është parashikuar të shtrihet gjatë gjithë periudhës së zbatimit të strategjisë, dhe do të realizohet gradualisht vit pas viti. Përmbushja e tij, nëpërmjet sigurimit të fondeve për menaxhimin e këtyre qendrave të këshillimit, kërkon bashkëpunimin ngushtësisht me Departamentin pranë Këshillit të Ministrave për shoqërinë civile;

Do të përbëjë produkt madhor:

- i) Funksionimi i 2 qendrave të këshillimit, që plotësojnë kriteret përkatëse ligjore; Funksionimi i qendrave këshillimit, nuk do të thotë vetëm ngritje e qendrave të reja, por kërkohet përmirësimi i atyre ekzistuese, në mënyrë që të plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të MZHETTS, të tilla si: të jenë kompetente për të dhënë këshilla mbi çështje të lidhura me konsumatorët; të kenë ambiente në vende lehtësisht të arritshme nga konsumatorët, të kenë pajisje të përshtatshme të teknologjisë së informacionit; të operojnë me kohë të plotë, ose të pjesshme. Gjithashtu, personeli i qendrës të këtë njohuri për legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit dhe ligjet e tjera të lidhura me çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve dhe njohuri mbi procedurat administrative, etj.
 - ii) Krijimi i pikës së kontaktit dhe informimit për tregtinë elektronike për konsumatorët; Produkti madhor i në pikën (ii), del në zbatim të amendimeve të ligjit 10128 dt. 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike”, ku jepet detyrimi për përcaktimin e pikave të kontaktit, në të cilat, ofruesit e shërbimeve të shoqërisë së informacionit dhe marrësit e këtyre shërbimeve, sigurojnë informacion të përgjithshëm mbi të drejtat dhe detyrimet kontraktore, mbi ankesat dhe mekanizmat e dëmshpërblimit në dispozicion në rast mosmarrëveshje, përfshirë aspekte praktike të përdorura në këto mekanizma.
- 25.** Përmirësimi i edukimit të konsumatorëve, duke e konsideruar edukimin e konsumatorëve, si pjesë të rëndësishme të mbrojtjes së konsumatorëve, i adresohet edukimit të fëmijëve, adoleshenteve dhe të rriturve, në rolin e tyre si konsumatorë, duke synuar zhvillimin e qëndrimit, vlerave të orientimit dhe sjelljes në mënyrë që të fitohet ndërgjegjësimi për të vepruar në treg në mënyrë kompetente dhe të informuar.

Veçanërisht fokusimi do të konsistojë në edukimin e konsumatorëve në fushën e arsimit nëpërmjet:

Rishikimit të kurrikulave me qëllim pajisjen e nxënësve me informacion mbi legjislacionin për konsumatorin dhe për të drejtat e konsumatorit duke e pasuruar me tema për: vlerën e parasë, dëshirat dhe stimujt për të konsumuar, praktikën e kreditit dhe marketingut, roli i publicitetit, kontratat, rreziku që vjen nga mbiborxhet, vlerësimi i rreziqeve në lidhje me produktin, siguria e lodrave, aspektet shëndetësore dhe ekologjike e ujit të pijshëm, faturat, treguesi i çmimeve, etiketimi i produktit, kursimi i energjisë, ndikimi i konsumit në ambient etj.

3.2 Objektivat afat gjata (2016-2020)

1. Plotësimi i legjislacionit në të gjithë zinxhirin ushqimor në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve, si dhe harmonizimi i tij me kuadrin rregullator evropian. Kjo do të çojë në rritjen e standardeve të sigurisë ushqimore gjatë proceseve të prodhimit, përpunimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së ushqimeve duke rritur garantimin e mbrojtjes së shëndetit dhe interesave konsumatorit.

Do të përbëjnë produkte, hartimi i 30 akteve nënligjore të harmonizuara me kuadrin rregullator evropian në vit.

2. Rritja e sigurisë ushqimore dhe produkteve ujore për konsumatorin nëpërmjet përmirësimit të sistemit të procesit të vlerësimit të riskut, menaxhimit të riskut dhe komunikimit të tij duke synuar zbatimin e masave koherente që sigurojnë kontrollin e ushqimit sipas parimit nga ferma në tavolinë.

Kjo do të arrihet bazuar mbi hapat e mëposhtëm:

- i) Vlerësimi dhe kategorizimi i stabilimenteve ushqimore në bazë të riskut.
 - ii) Rritja e standardit të kontrollit zyrtar të ushqimeve në bazë të planit të përmirësuar vjetor dhe shumë-vjetor të kontrollit dhe mostrimit që do rezultojë në uljen me 5% çdo vit të mos-konformiteteve kundrejt vitit të kaluar.
 - iii) Rritja e nivelit të zbatimit të sistemit të gjurmueshmërisë duke rritur 5% çdo vit numrin e operatorëve të biznesit ushqimor që e aplikojnë atë.
 - iv) Shtrirje e monitorimit, klasifikimi dhe miratimi nga Komisioni Evropian (DG SANCO) i tetë zonave potenciale të prodhimit të molusqeve bivalve të gjallë sipas kritereve të BE-së si dhe rishikimi i vazhdueshëm i mbikëqyrjes sanitare;
3. Garantimi në një nivel më të lartë të shëndetit të konsumatorëve nga parandalimi dhe eliminimi i risqeve ushqimore.

Për këtë qëllim do të realizohen 100% programet kombëtare të monitorimit të mbetjeve, kritereve mikrobiologjike dhe kontaminanteve në kafshë të gjalla, produkte ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore, si dhe ujërave të molusqeve bivalve nëpërmjet rritjes së numrit të produkteve të përfshira në planet e monitorimit si dhe të numrit të mostrave të analizuar.

4. Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të AKU dhe infrastrukturës operative të saj, në veçanti të laboratorëve rajonalë dhe pikave të inspektimit kufitar.

Kjo do të arrihet nëpërmjet:

- i) Rritjes së kapaciteteve me anën e trajnimeve vjetore të 10% të stafit.
 - ii) Unifikimi i metodave dhe metodologjive të analizimit të produkteve ushqimore
 - iii) Pjesëmarrja në teste ndër-krahasimore.
 - iv) Ngritja e sistemit të menaxhimit të cilësisë.
5. Rritja e efektivitetit të shërbimit veterinar në nivel qendror e rajonal nëpërmjet realizimit të produkteve:
 - i) Përcaktimit të parimeve bazë për mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve, sipas standardeve ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve (OIE) dhe të Bashkimit Evropian;
 - ii) Rregullimit, riorganizimit, financimit të shërbimit veterinar dhe të procedurave të shërbimit veterinar në mbrojtje të shëndetit e mirëqenies së kafshëve.

6. Mbrojtja e shëndetit të kafshëve dhe ulja e riskut të kalimit të zoonozave te njerëzit nëpërmjet realizimit të:
- i) imunizimit 100% të bagëtive të imta në gjithë vendin nga sëmundja e brucelozës si dhe gjurmimin e sëmundjes së brucelozës në gjedhë në 10% çdo vit të krerëve,
 - ii) mbajtjes nën kontroll të plotë të sëmundjes së plasjes duke vaksinuar në të gjithë vatrat e këtij infeksioni dhe e TBC duke gjurmuar dhe eliminuar kafshë e infektuara në vatra,
 - iii) mbajtjes nën kontroll e tërbimit duke vaksinuar kafshët e egra të cilat përbëjnë rezervuarin kryesor të përhapjes së kësaj sëmundje në kafshët shtëpiake dhe njerëz.
7. Njohja e rezultateve në nivel kombëtar dhe evropian/ndërkombëtar për të paktën 20 lloje testimesh nga laboratorët e ISUV.

Do të përbëjë produkt:

Akreditimi i të paktën 20 lloje testimesh nga organe akredituese nënshkruese të MLA me EA ose Organizatën Ndërkombëtare për Akreditimin e Laboratorëve.

Besueshmëria në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar rezultateve analitike të Laboratorëve të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, si Qendër Kombëtare e Referencës, kanë një impakt të rëndësishëm si në garantimin e sigurisë së konsumatorëve shqiptarë ashtu edhe në aspektin ekonomik në kuadër të produkteve që janë të destinuara për eksport dhe të testuara nga laboratorë shqiptarë. Aktualisht Instituti ka të akredituar 7 teste dhe deri në 2020 do të zgjerojë numrin e testeve të akredituar edhe në fusha të tjera të sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve. Kjo kërkon investime në forcimin e kapaciteteve njerëzore profesionale, përfshirë trajnime të vazhdueshme, si dhe investime në paisjet e duhura dhe të kalibruara periodikisht, ngritja dhe konsolidimi i rrjeteve elektronike të komunikimit, etj.

8. Krijimi i zonave të lira nga parazitët karantinor nëpërmjet:
- i) Reduktimit në masën 10% çdo vit të parazitëve karantinor për patatën e hershme.
 - ii) Reduktimit në masën 10% çdo vit të zjarrit bakterial në pemët frutore farore.
9. Përditësim i legjislacionit për sigurinë e produkteve jo-ushqimore duke ndjekur zhvillimet e legjislacionit evropian ;

Ky transpozim do të kryhet i përshkallëzuar në vite në varësi direktivave apo rregulloreve evropiane të fushës. Kjo ecuri do të jetë edhe në varësi të statusit dhe programit të përgjithshëm të vendit për integrim të plotë në BE.

Do përbëjnë produkte:

Miratimi i rreth 30 akteve ligjore e nënligjore në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

10. Ulja me 10% e shkallës së mos konformiteteve të produkteve në treg çdo vit krahasuar me vitin paraardhës. Për këtë qëllim do të intensifikohen kontrollet në bazë të vlerësimit të riskut, përfshirë përdorimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave, do të trajnohen në mënyrë të vazhdueshme inspektorët, etj.

Në këtë kontekst do të përbëjnë produkte:

- i) Trajnimi i inspektorëve për metodologjinë e vlerësimit të riskut, procedurat standarde të operimit, legjislacionit të veçantë teknik sipas grup produkteve përkatëse, etj.
- ii) Kryerja e aktiviteteve mbikëqyrëse bazuar në vlerësimin e riskut dhe rritja me 20% e numrit të kontrolleve rastësore për produktet ku informacioni i përgjithshëm nuk është i plotë.

11. Garantimi i sigurisë së ashensorëve për përdorim civil që janë në përdorim.

Ashensorët për përdorim civil përbëjnë një nga instalimet më komplekse dhe me një probabilitet të lartë rrezikshmërie, kur ato nuk plotësojnë kërkesat e sigurisë lidhur me instalimin e tyre kur ato vihen në përdorim për herë të parë si dhe kur nuk i nënshtrohen inspektimeve periodike nga organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit. Praktika e deritanishme ka treguar që në shumicën e rasteve ashensorët e instaluar në godinat e përbashkëta të banimit nuk janë me markën CE të konformitetit, nuk janë të regjistruar dhe nuk i nënshtrohen kontrolleve periodike. Në këtë mënyrë, përdoruesi është nën rrezikun e aksidenteve të rënda dhe në rastet e defekteve të vazhdueshme, banorët janë të detyruar të paguajnë për rregullimin e tyre të përkohshëm. Kjo situatë ka ardhur si pasojë e mungesës së detyrimit të përputhshmërisë së konformitetit dhe kontrollit prej Inspektoratit shtetëror përgjegjës, e cila i ka lënë hapësirën sipërmarrësve të abuzojnë me cilësinë dhe plotësimin e kërkesave minimale të sigurisë së ashensorëve që i ofrohen blerësve të tyre dhe duke kaluar te këta të fundit riskun. Për të garantuar sigurinë e ashensorëve që janë në përdorim, parashikohen si produkte: :

- i) Intensifikimi i aktiviteteve mbikëqyrëse nga Inspektorati shtetëror përgjegjës në varësinë e MZHETTS në fushën e sigurisë së ashensorëve për përdorim civil (përjashtuar ashensorët e natyrës industriale apo ata kabllorë) për arritjen e regjistrimit të tyre dhe kryerjes së inspektimeve periodike
- ii) Organizimi i një fushate ndërgjegjësimi për konsumatorët dhe sipërmarrësit për detyrimet lidhur me sigurinë e ashensorëve për përdorim civil në përdorim.

12. Ulja në 6% në vit e bombolave të gazit të pakontrolluara që janë në përdorim, (inspektimi periodik). Rritja e kontrollit të bombolave të gazit që janë në përdorim, (inspektimi periodik), duke filluar me inspektimin fillestar prej 50% në vitin e parë dhe 50% në vitin e dytë, si dhe inspektimin periodik të tyre sipas periodicitetit të përcaktuar në rregullin teknik përkatës. Për arritjen e këtij objekti, ISHTI duhet të evidentojë dhe të regjistrojë të gjitha bombolat e gazit që janë për përdorim familjar dhe të marrë masat për nxjerrjen jashtë përdorimit të atyre që janë jashtë standardeve të sigurisë dhe nuk i janë nënshtrohet kontrolleve teknike të detyrueshme.

Për këtë qëllim, do të përbëjnë produkte:

- i) Evidentimi, regjistrimi dhe gjurmimi nga ISHTI, i të gjitha bombolave të gazit që janë për përdorim familjar.
- ii) Ushtrimi i kontrolleve në gjithë pikat e tregtimit dhe të mbushjes së bombolave të gazit
- iii) Ndërgjegjësimi i subjekteve të tregtimit dhe të mbushjes së bombolave të gazit.

13. Ulja në 3% e moskonformiteteve të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre ndaj kërkesave ligjore lidhur me treguesit cilësorë

Ky është një objektivi që do të jetë prioritet në vijimësi i ISHTI, në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve si në aspektin e sigurisë dhe cilësisë ashtu edhe në atë ekonomik si dhe në mbrojtjen e ambientit për një cilësi më të lartë të pastërtisë së ajrit. Kjo pa dyshim

kërkon inspektorë profesionistë dhe mbështetje nga testime të sakta të besueshme nga laboratorë të akredituar. Për këtë qëllim, do të përbëjnë produkte:

- i) Rritja me 12% e kontrolleve të ushtruara në subjektet e tregimit me shumicë dhe pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre
- ii) Mirëmbajtja e akreditimit të laboratorit të naftës pranë ISHTI
- iii) Fuqizimi i kapaciteteve teknike të inspektorëve

14. Eliminimi i rasteve të aksidenteve nga goditjet e rrymës elektrike të tensionit të ulët në banesat e familjarëve

Produkt madhor:

- Realizimi i projektit për përfshirjen e reles diferencialo termike në instalimet elektrike në banesat familjare dhe objektet industriale, brenda vitit 2018.
- Organizimi i një fushate të gjerë ndërgjegjësimit për konsumatorët për rëndësinë e kësaj mase sigurie.

15. Përmirësimi i sigurisë së produkteve kozmetike.

Produktet e kozmetikës në shumë raste kanë shkaktuar dëmtime të konsumatorët që mund të fillojnë nga alergjitë e deri në komplikacione të ndërlikuara. Kjo fushë e pambuluar me legjislacion të veçantë, mbulohet nga legjislacioni i sigurisë së përgjithshme të produkteve, i cili zbatohet në raste të tilla. Megjithatë kërkesat e detyrueshme të sigurisë të parashikuara në legjislacionin përkatës evropian duhen transpozuar korrektësisht në legjislacionin shqiptar dhe duhen zbatuar nga operatorët ekonomikë dhe kontrolluar nga strukturat shtetërore.

Për këtë qëllim do të ndihmojë realizimi i produkteve:

- i) Adoptimi i legjislacionit për kozmetikën i harmonizuar me atë evropian.
- ii) Krijimi i strukturës për kontrollin e tregut për produktet kozmetike

Ngritja e strukturës(ve) përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për produktet kozmetike, të cilat do të ushtrojnë kontroll fizik ndaj operatorëve ekonomik dhe në rastet kur konsiderohet e arsyeshme, kryerjen e testeve laboratorike për mostrat e marra për analizë

16. Ulja e mos-konformiteteve të barnave të tregtuara çdo vit me 10% në krahasim me vitin paraardhës. Ky objektivi do të arrihet nga monitorimi i gjithë sistemit nga pika doganore te konsumatori/pacienti dhe me teste të besueshme. Do të përbëjnë produkte:

- i) Monitorimi i tregut për barnat lidhur me respektimin e kërkesave përkatëse ligjore
- ii) Akreditimi dhe mirëmbajtja e akreditimit për laboratorin shtetëror të kontrollit të barnave
- iii) Mirëmbajtja e rrjetit të informatizuar farmaceutik dhe krijimi i një baze të dhënash kombëtare
- iv) Futja e sistemit “track and trace”. Kjo përfshin krijimin e sistemit të informacionit të ndjekjes së barit që kur hyn si produkt në Doganë e deri të konsumatori/përdoruesi i fundit. Për krijimin e këtij sistemi do vlerësohen alternativa të ndryshme si me financim të huaj, Private-Public-Partnership apo ndonjë formë e ndërthurur.

17. Përmirësimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore.

Për këtë qëllim, do të përbëjë produkt:

i) Finalizimi i sistemit lidhur me pajisjet mjekësore që aktualisht janë jashtë kontrollit;

18. Adoptimi 100% i standardeve CEN/CENELEC, ETSI dhe 40% e totalit të standardeve IEC dhe ISO dhe plotësimi i kushteve teknike për anëtarësim me të drejta të plota të DPS-së, në **CEN&CENELEC**, si dhe ndjekja e ritmit të adoptimeve të standardeve të publikuara nga organizmat evropiane të standardeve.

Do të përbëjnë produkte adoptimi si standarde shqiptare i:

- i) 6900 standardeve evropiane e ndërkombëtare të publikuara nga CEN, CENELEC, ETSI dhe ISO e IEC;
- ii) Ndryshimi i legjislacionit dhe procedurave të punës së DPS në varësi të ndryshimeve në legjislacionin dhe rregulloret evropiane në këtë fushë;
- iii) Aplikimi për anëtarësim me të drejta të plota në CEN&CENELEC;
- iv) Anëtarësimi në Njësinë Ndërkombëtare të Telekomunikacionit (ITU) dhe fillimi i adoptimit të standardeve ndërkombëtare në fushën e telekomunikacionit (në varësi të anëtarësimit të DPS në ITU).

19. Rritja çdo vit afërsisht me 2% e shitjeve të standardeve krahasuar me vitin paraardhës

Rritja e numrit të standardeve të shitura është tregues i qartë që operatorët ekonomikë vendas operojnë në treg me standarde, të cilat sigurojnë jo vetëm produkt të sigurtë dhe me cilësi për konsumatorin, por edhe zgjidhjen teknike në zbatim të legjislacionit për funksionimin e tregut të përbashkët dhe aksesin për të qenë aktor në këtë treg. Përkthimi i tekstit të standardeve të adoptuara, veçanërisht të standardeve të harmonizuara, me qëllim zbatimin sa më korrekt të tyre nga operatorët ekonomikë dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve dhe operatorëve ekonomikë për përfitimet e përdorimit të standardeve është gjithashtu detyrë në vazhdimësi.

Do të përbëjnë produkte:

- i) Shitja e rreth 10.000 standardeve shqiptare;
- ii) Përkthimi i 120 standardeve për fusha prioritare të ekonomisë;
- iii) Ndërgjegjësimi i operatorëve ekonomike dhe konsumatorit për rëndësinë e standardeve në produktet dhe shërbimet e ofruara në treg.

20. Njohja e raporteve të testimit të laboratorëve testues, si dhe njohja e certifikatave të akreditimit të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në BE. Arritja e këtij objektivi afatgjatë madhor do ketë një impakt të drejtpërdrejtë në eliminimin e barrierave teknike të tregtisë me vendet e Bashkimit Evropian dhe atyre të CEFTA-s, rritjen e shkallës së sigurisë së produkteve të vendosura në treg, rritjen e besueshmërisë së konsumatorëve lidhur me produktet e ofruara në treg, zhvillimin e konkurrueshmërisë dhe ekonomisë së vendit.

Produkte:

- i) Rikonfirmimi i EA-MLA në fushën e testimit (2016-2020)
- ii) Aplikimi në EA për firmosjen e EA-MLA dhe për fushën e certifikimit të sistemeve të menaxhimit
- iii) Rritja e numrit të aplikimeve për akreditim duke përfshirë edhe laboratorët mjekësorë.
- iv) Fushata ndërgjegjësuere për operatorët ekonomikë dhe organizatat e mbrojtjes së konsumatorëve për rolin e akreditimit në cilësinë e jetës, sigurinë e produkteve të konsumit në treg dhe rritjen e konkurrueshmërisë dhe shkëmbimeve tregtare (2014-2020)

- v) Realizimi i vlerësimit nga EA për trupat certifikues të sistemeve të manaxhimit (2017)
 - vi) Përmirësimi i skemave të akreditimit dhe legjislacionit në fushën e akreditimit në përputhje me rregulloret dhe dokumentat europianë. (2017)
 - vii) Njohja e certifikatave të lëshuara nga DPA në fushën e certifikimit të sistemeve të menaxhimit (2018)
 - viii) Ofrimi i akreditimit nga DPA për trupat inspektues të pajisjeve elektrike (2016)
 - ix) Përgatitja e dokumentacionit për arritjen e njohjes reciproke në fushën e akreditimit të trupave inspektues (2018)
 - x) Aplikimi për nënshkrimin e EA_MLA-së për fushën e inspektimit (2019)
 - xi) Pranimi i certifikatave të lëshuara nga DPA për fushën e inspektimit (2020)
 - xii) Anëtarësimi në EA me drejta të plota (2020)
21. Përmirësimi i legjislacionit në fushën e metrologjisë në përputhje me direktivat evropiane dhe standardet e harmonizuara.

Produkt do të jetë:

1. Rishikimi i akteve nënligjore në përputhje me direktivat evropiane për metrologjinë si edhe standardeve të harmonizuara.
22. Rritja e shkallës së mbrojtjes së konsumatorëve nga matjet e pasakta nëpërmjet rritjes me 2 % për çdo vit të numrit të verifikimeve dhe inspektimeve të instrumenteve matës në treg dhe në përdorim;

Produkte madhore do të jenë:

- i) Kryerja e verifikimeve periodike e instrumenteve matës në përdorim në masën 10 % me shumë se viti paraardhës
 - ii) Përfshirja në skemën e kontrollit metrologjik ligjor e dy instrumenteve matës në fushën e mjekësisë. Në kuadër të mbrojtjes së shëndetit të qytetarit dhe tendencës për akreditimin “e detyrueshëm” të laboratorëve mjekësorë, do përfshihen në skemën e verifikimit ligjor të detyrueshëm instrumente matës të temperaturës, tensionit të gjakut, dozimetrisë etj, të cilat do të ndihmojnë në saktësinë e përcaktimit të diagnozës si edhe analizave.
 - iii) Rritja e numrit të inspektimeve të instrumenteve matës në masën 10% dhe ulja e jo konformiteteve të para-paketimeve në masën 2% në krahasim me vitin paraardhës.
23. Njohja ndërkombëtare e shërbimeve të DPM-së në fushën e volumeve, termometrisë, lagështisë, rrjedhjeve dhe matjeve elektrike.

Produkte madhore do të jenë:

- i) Akreditimi i laboratorëve sipas fushave përkatëse nga trupa akreditues nënshkrues të MLA me EA në fushën e kalibrimeve.

- ii) Njohja e sistemit të menaxhimit të cilësisë nga EURAMET dhe në dy laboratorët e volumeve dhe termometrisë, gjithsej 2 laboratorë.
- iii) Deklarimi në database të BIPM-së të3 fushave (volumeve, termometrisë dhe gjatësisë).
- iv) Zgjerimi i bazës etalonuese në 7 fusha të reja matje: laboratorin e masës, elektrikut, rrjedhjeve, optikës, përdredhjeve, gjatësisë dhe presionit, si dhe DML-së dhe DIM me instrumente dhe auto-laboratorë verifikimi. Zhvillimi i sektorëve në fushën e energjetikës, industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve dhe hidrokarbureve, si dhe forcimi i mbrojtjes së konsumatorit kërkojnë domosdoshmërisht zhvillimin e fushave të lartpërmendura të matjes.
- v) 10750 kalibrime në fushën e masës, forcës, volumit, gjatësisë, presionit, temperaturës, matjeve elektrike, lagështirës, kohë frekuencë, densitetit.

24. Realizimi i gjurmueshmërisë së matjeve në nivelin më të lartë ndërkombëtar.

Produkte madhore do të jenë:

1. Ri-kalibrim i etalonëve referencë për 10 fusha matje(masë, forcë, presion, volume, elektrik, temperaturë, gjatësi, lagështirë, rrjedhje, kohë frekuencë)të laboratorëve të DPM.

Aktivitetet:

- i) Planifikimi , organizimi dhe kryerja e aktiviteteve të verifikimit metrologjik të instrumentavë matës në laborator dhe vend
- ii) Përgatitja , miratimi dhe implementimi i rregullave teknike te instrumentave matës si dhe i procedurave teknike të kontrollit përkatëse. Sigurimi paisjeve të kontrollit,trainimi i stafit dhe organizimi i kryerjes së shërbimeve
- iii) Planifikimi, organizimi dhe kryerja e aktiviteteve të inspektimit metrologjik të instrumentave matës dhe kontrollit të parapaketimeve.

25. Rritja e monitorimit të sistemeve të kontrollit të produkteve të para-paketuara tek prodhuesi/paketuesi dhe në treg, me qëllim uljen e produkteve jo-konformë çdo vit mesatarisht me 2 % (DPM)

Produkte madhore do të jenë:

- i) Ulja e produkteve të para-paketuara jo konforme në masën 8% në raport me vitin paraardhës

26. Përditësim i legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve duke ndjekur zhvillimet në nivel evropian.

Gjatë periudhës afatgjatë të zbatimit të strategjisë, do të përbëjnë produkte:

- i) Amendimet e ligjit të mbrojtjes së konsumatorëve:

Përafrimi i legjislacionit tonë me atë të BE-së, si një detyrim që buron direkt nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, dikton nevojën e reflektimit të ndryshimeve legjislative evropiane në të

drejtën e brendshme, për këtë arsye, edhe ligji “Për mbrojtjen e konsumatorëve” do të jetë subjekt i amendimeve. Gjithashtu, ndryshimet ligjore do të përgjigjen përvojës në zbatimin e ligjit ekzistues, duke thjeshtësuar dhe përditësuar rregullat, eliminimin e vakumit ligjor dhe mospërputhjeve eventuale me ligje të tjera. Konkretisht, do të merren në konsideratë risitë që ka sjell Direktiva evropiane mbi të drejtat e konsumatorëve (2011/83), direktiva e re e paketave të udhëtimit, vendosja e bazës ligjore për ngritjen e rrjetit të strukturave shtetërore me përgjegjësi institucionale për mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe detajimi i bazës ligjore për ti dhënë të drejtën çdo entiteti që ka një interes legjitim, i cili është krijuar sipas ligjit dhe mbron interesat kolektive të konsumatorëve të inicioj një proces gjyqësor/administrativ para organeve përkatëse për mbrojtjen e konsumatorëve. Amendimet e ligjit parashikohet te realizohet gjate vitit 2016.

- ii) Hartimi i VKM së re për paketat e udhëtimit në zbatim të amendimeve të ligjit të mbrojtjes së konsumatorëve etj

Ky akt synon të përmirësojë kuadrin rregullator për paketat e udhëtimit, duke qenë në përputhje me reformimin që po pëson direktiva përkatëse evropiane. Sektori i udhëtimit ka evoluar vitet e fundit. Kjo, edhe falë zhvillimeve të shpejta të teknologjisë së informacionit, psh tashmë udhëtarët mund të bëjnë rezervime *online*. Gjithashtu, janë zhvilluar edhe metodat e të marketingut, siç janë biletat *low cost*. Këto ndryshime, por jo vetëm, kanë sjell nevojën e përmirësimit të mbrojtjes së konsumatorëve, gjë që do të reflektohet në këtë akt. Ky akt nënligjor parashikohet të realizohet gjatë vitit 2017

- iii) Amendimet e 2-VKM-ve (kontratat në largësi dhe shitja jashtë qendrave të tregtimit), në zbatim të amendimeve të ligjit të mbrojtjes së konsumatorëve;

Nën këndvështrimin e ndryshimeve të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, do të pasqyrohen edhe ndryshimet përkatëse në VKM nr. 63, datë 21/01/2009 “Për kontratat jashtë qendrave të tregtimit” si dhe VKM nr. 64, datë 21/01/2009 “Për kontratat në largësi”, duke siguruar nje për afrim të plotë të Direktivës “Mbi të drejtat e konsumatorëve”. Këto ndryshime parashikohet të kryhen gjatë vitit 2018.

- iv) Hartimi i VKM “Për bashkëpunimin midis autoriteteve kombëtare përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve” Rregullores Evropiane së *Bashkëpunimit të Mbrojtjes së Konsumatorëve* (CE) N. 2006/2004 te 27 tetorit 2004 2004/2006;

Rregullorja (EC) Nr. 2006/2004 parashtron kushtet sipas të cilave strukturat kompetente, përgjegjëse për zbatimin e ligjeve, që mbrojnë interesat ekonomike të konsumatorëve, bashkëpunojnë me njeri tjetrin, në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e duhur të tregut në përputhje me këto ligje si dhe rritjen e nivelit të mbrojtjes së interesave ekonomike të konsumatorëve.

Transpozimi i këtij akti në legjislacionin e mbrojtjes së konsumatorëve, që parashikohet gjatë vitit 2019, do të synojë plotësimin e mëtejshëm të bazës ligjore. Ky akt do të mundësojë plotësimin e rrjetit të strukturave shtetërore me përgjegjësi institucionale për mbrojtjen e konsumatorëve, do të përcaktojë listën e këtyre strukturave me fushën përkatëse që ato mbulojnë, do të vendosë mënyrën dhe kushtet për bashkëpunimin reciprok, për të shkëmbyer informacion, zbuluar dhe hetuar shkeljet e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve e duke marrë masa për ndalimin e tyre..

- v) Plotësimi i legjislacionit që ndikon në uljen e lëshimit të CO2 në mjedis.

Ky legjislacion do të plotësohet nga ana e MTI nëpërmjet transpozimit të tre Direktivave 1999/94/EC “Mbi disponimin e informacionit për konsumatorin mbi kursimin karburantit dhe gazrave CO₂, për autoveturat e reja”; Direktiva 1753/2000/EC “Monitorimi i gazrave CO₂ nga mjetet e reja të pasagjereve” dhe Rregullorja Nr. 443/2009, “Mbi vendosjen e standardeve të performancës së gazrave, për mjetet e reja si pjesë e qasjes komunitare për të reduktuar gazrat CO₂ nga mjetet e lehta“. Nga njëra anë ky legjislacion është në ndihmë të konsumatorit me qëllim një blerje të mirë-informuar nga ana e tij si dhe ka impakt në uljen e gazrave të CO₂ në mjedis

- vi) Hartimi dhe miratimi i Vendimeve të KM lidhur me etiketimin e energjisë për grupe produktesh me ndikim në konsumin e energjisë, duke ndjekur zhvillimet në nivel evropian.

Direktiva e re kuadër për etiketimin e produkteve që kanë impakt në energji, e shtrin fushën e zbatimit të saj përtej pajisjeve për përdorim shtëpiak, duke përfshirë aty edhe çdo produkt që ndikon drejtpërdrejt ose jo në konsumin e energjisë. Kjo direktivë parashikon përzgjedhjen e produkteve sipas një metodologjie të caktuar. Në këtë kontekst, legjislacioni shqiptar do të përditësohet në ndjekje të zhvillimeve në nivel evropian në këtë fushë. Kjo do të thotë kërkesa të detyrueshme të njëjta për operatorët tanë ekonomikë me ato të BE-së, lidhur me informacionin e nevojshëm në etiketën dhe skedën informative të produktit, që ka impakt në eliminimin e barrierave teknike të lëvizjes së lirë të mallrave, mundësimin e konsumatorëve për blerje/zgjedhje të mirë informuara dhe nxitjen e tregtarëve për të ofruar në treg produkte efçente ndaj energjisë.

- 27. Fuqizim i efektivitetit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve (KMK), nëpërmjet analizimit 100% të ankesave dhe shqyrtimit me iniciativën e tij kontratave standarde në fushën e arsimit privat; kontratave në largësi, jashtë qendrave të tregtimit, etj;

Do të përbëjnë produkte:

- i) Trajtimi dhe shqyrtimi 100% i ankesave të konsumatorëve
- ii) Shfuqizimi i kushteve të padrejta në këto kontratat tip;

Ky objektiv është në vijim të punës së Komisionit, si një objektiv që shoqëron të gjithë periudhën e zbatimit të strategjisë, për nga rëndësia që ka në zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, si dhe për shqyrtimin e rasteve me impakt në mbrojtjen e interesave kolektive të konsumatorëve.

Në strategji parashikohet marrja për shqyrtim me iniciativën e vetë Komisionit të minimalisht 3 rasteve në vit, përkatësisht sipas viteve:

2016: kontratave standard të arsimit të lartë privat;

2017: kontratave në largësi e jashtë qendrave të tregtimit;

2018: kontratave tip në fushën e shërbimeve financiare.

- 28. Organizimi i sondazheve tek operatorët në fushën e udhëtimeve ajrore, tregtisë on-line, etj për vlerësimin e praktikave tregtare në fillim dhe pas masave të KMK.

Do të përbëjë produkt:

- i) Ulja me 20% e praktikave të padrejta tregtare me mospërputhje ligjore, në fushat e sipërpërmendura.

Ky objektiv shoqëron të gjithë periudhën e zbatimit të strategjisë, me synim vlerësimin e situatës mbi praktikën tregtare me të cilat përballen konsumatorët. Fushat e përzgjedhura në periudhën afatgjatë të strategjisë do të jenë praktikën tregtare gjatë udhëtimeve ajrore, tregtisë on-line, etj. Këto fusha megjithëse përbëjnë praktika të reja për vendin tone, kanë filluar të gjejnë gjerësisht përhapje, gjë që kërkon fokusimin e vëmendjes nga ana strukturave shtetërore për garantuar mbrojtjen e konsumatorëve. Objekt i këtij vlerësimi do të përbëjnë zbatimin e detyrimeve ligjore nga ana e operatorëve, dhe veçanërisht detyrimet në lidhje me transparencën e informacionit, publicitetit të ofruar konsumatorëve, etj.

29. Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të konsumatorëve me 5% çdo vit

- i) Organizimi i të paktën 3 sondazheve me konsumatorët lidhur me perceptimin e tyre për produktet dhe shërbimet e ofruara në treg si; njohjen e të drejtave të tyre, legjislacionin, perceptimin për nivelin e mbështetjes dhe shërbimit nga strukturat shtetërore, etj.
- ii) Organizimi i 10 tryezave informuese;
- iii) Përgatitja e materialeve informuese

Do të vazhdojë të jetë objektivi i strategjisë edhe për periudhën afatgjatë 2016-2020, organizimi i tryezave informuese për konsumatorët dhe operatorët, duke kontribuar për rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive të tyre lidhur me kuadrin ligjor në fushat që mbulon kjo strategji. Këto aktivitete do të shoqërohen me përgatitjen e materialeve informuese, broshura, fletëpalosje, si dhe përmirësimin e informacionit në faqet zyrtare të internetit të ministrave apo institucioneve të tjera të lidhura me mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut

Një element i ri parashikohet të jenë sondazhet me konsumatorët, në zbatim të përvojës evropiane “*Eurobarometer as part of a trend survey*”. Këto sondazhe do të vlerësojnë sjelljen, eksperiencat, perceptimin e konsumatorëve përkundrejt tregut, duke shërbyer si barometër i tregut, si dhe për të vlerësuar sa konsumatorët njohin të drejtat e tyre dhe nëse i zbatojnë ato, sa i njohin institucionet që punojnë për mbrojtjen e konsumatorëve dhe si e perceptojnë shërbimin e strukturave të administratës shtetërore.

Këto sondazhe përveç vlerësimit të shkallës së ndërgjegjësimit të konsumatorëve, do të kenë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e politikave të konsumatorëve, në përfshirjen e çështjeve që shqetësojnë konsumatorët, si dhe në hartimin e një legjislacioni efektiv.

Sondazhet do të zhvillohen nëpërmjet intervistave – telefonata nga linja fikse - drejtpërdrejtë me qytetarët (15 vjeç e lart), etj, në bashkëpunim me INSTAT apo mbështetjen e donatorëve.

30. Përmirësimi i nivelit të këshillimit të konsumatorëve nëpërmjet funksionimit të 4 qendrave të këshillimit, që plotësojnë plotësisht kriteret dhe njihen nga MZHETTS.

Ky objektivi do të shtrihet edhe në periudhën afatgjatë të zbatimit të strategjisë. Në mënyrë që qendrat e këshillimit të përmbushin detyrimet e këshillimit dhe informimit për konsumatorët, duhet të vazhdojë pajisja e infrastrukturës së tyre, si dhe plotësimi me staf, i cili duhet të trajnohet në mënyrë të vazhdueshme.

Arritja e këtij objektivi siç është theksuar edhe në objektivat afatshkurtra kërkon bashkëpunimin ngushtësisht me Departamentin pranë Këshillit të Ministrave për shoqërinë civile, për sigurimin e fondeve për menaxhimin e këtyre qendrave të këshillimit;

31. Rritja e nivelit të edukimit konsumator, nëpërmjet përfshirjes së çështjeve të mbrojtjes së konsumatorëve, në programet mësimore edhe në sistemin parashkollor dhe atë të ciklit të ulët.

Do të përbëjnë produkte madhore:

- i) Prodhimi i materialeve shkollore dhe udhëzimeve të reja metodologjike, si dhe përpunimi i materialeve mësimore ekzistuese
- ii) trajnimi i mësuesve me qëllim kualifikimi me qëllim kualifikimin e tyre për çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve
- iii) ndërveprimi ndërmjet shkollave dhe mjediseve lokale për të mbështetur shkëmbimin e praktikave më të mira në integrimin e edukimit të konsumatorëve në sektorin e edukimit shkollor për edukimin e fëmijëve, adoleshentëve dhe të rriturve në pozicionin e tyre si konsumatorë.

32. Funksionimi i strukturave që sigurojnë zgjidhjet jashtëgjyqësorit të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve, nëpërmjet rritjes me 20% çdo vit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të konsumatorëve;

33. Ndërtimi i infrastrukturës për rrjetin e bashkëpunimit të strukturave shtetërore me përgjegjësi institucionale për mbrojtjen e konsumatorëve, për të qenë pjesë e CPCN (Rrjetit Evropian të Bashkëpunimit për Mbrojtjen e Konsumatorëve), me hyrjen e Shqipërisë në BE;

Rrjeti i strukturave me përgjegjësi institucionale për mbrojtjen e konsumatorëve do të jetë i përbërë nga strukturat shtetërore përgjegjëse për çështje, të lidhura me mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve, të tilla si: praktikat e padrejta tregtare; publicitetet çorientuese dhe krahasuese; kushtet e padrejta në kontrata; paketat turistike, kreditë e konsumatorëve, kontratat në largësi, tregtia elektronike, shitjet jashtë qendrave të tregtimit, kontratat e shërbimeve financiare në largësi, kontratat e përdorimit me afat të produktit të pushimit dhe shitjen në distancë; ofrimi i shërbimeve të medias audio vizuale, treguesin e çmimit, të drejtat e pasagjerëve në udhëtimet ajrore, detare dhe në rrugë ujore, etj. Qëllimi i ngritjes së këtij rrjeti është përmirësimi dhe forcimi i bashkëpunimit midis strukturave administrative për të siguruar zbatimin e legjislationit.

Koordinimi i punës kryhet nga struktura e ngarkuar me kompetencat përkatëse, të parashikuara në aktin nënligjor, që transponon rregulloren evropiane 2004/2006. Kjo struktura do të jetë përgjegjëse edhe për mbajtjen e lidhjeve me CPCN (Rrjetit Evropian të Bashkëpunimit për Mbrojtjen e Konsumatorëve), në të cilin, me hyrjen në BE, vendi ynë do të jetë pjesë.

Zhvillimi i infrastrukturës do të parashikojë krijimin e një baze të dhënash dhe një sistem komunikimi; përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave, si edhe koordinimin e monitorimeve, aktiviteteve të përbashkëta, trajnime për specialistët e strukturave zbatuese; organizimin e aktiviteteve me palët e interesuara; vendosjen e një bashkëpunimi administrativ dhe zbatues me vendet e tjera.

4 KAPITULLI IV: BURIMET FINANCIARE

Vlerësimi i kostove të nevojshme për zbatimin e strategjisë së mbrojtjes së konsumatorëve dhe mbikëqyrjes së tregut, për periudhën deri 2020, është bërë në bazë të objektivave të parashikuara në planin afat shkurtër dhe afat gjatë. Në këtë përlllogaritje janë marrë parasysh programet buxhetore 2015 -2017 dhe sipas këtij trendi, një parashikim i përafërt në planin afat gjatë. Burimet financiare për objektivat afat shkurtra bazohen pothuajse plotësisht në buxhetin e shtetit. Kostimi i objektivave afat gjata është përlllogaritur gjithashtu duke parashikuar trendin e buxhetit të shtetit,

duke përcaktuar fushat kryesore të ndërhyrjes, por duke lënë hapësirë për mundësinë e mbështetjes nga donatorët apo financimeve të huaja (kryesisht në forcime të kapaciteteve institucionale). Këto të fundit paraqiten në zërin “hendek financiar”.

Ky dokument strategjik shoqërohet me një Plan Veprimesh ku koston gjatë objektivat sipas produkteve në planin afat mesëm dhe afat gjatë, duke parashikuar pjesën e mbuluar nga buxheti i shtetit dhe atë që kërkon financim të huaj.

Më poshtë paraqiten në formë tabelore kostot për përmbushjen e objektivave, sipas nën çështjeve të referuara në strategji:

Tabela 1: Kostimi i zbatimit të strategjisë sipas objektivave afat shkurtër deri në fund të 2015

| | Çështje të mbulura nga strategjia | Kosto totale | Buxhet | Hendek Financiar | Koment për çështjet e parashikuara si hendek financiar |
|-------------|--|---------------------|------------------|-------------------------|--|
| | Totali | 3,092,104 | 2,978,930 | 113,174 | 3% e pambuluar nga buxheti. |
| 1.1. | Fusha e sigurisë së produkteve | 2,446,054 | 2,432,880 | 13,174 | |
| 1.1.1 | Siguria e produkteve ushqimore, produkteve ujore, shëndeti i bimëve dhe kafshëve | 1,985,840 | 1,985,840 | | |
| 1.1.2 | Siguria e produkteve jo-ushqimore | 150,948 | 137,774 | 13,174 | -zhvillimi i sistemit të të dhënave - trajnime (për sistemin dhe inspektorëve) -kite laboratorit |
| 1.1.3 | Barnat për përdorim njerëzor | 309,266 | 309,266 | 0 | |
| 1.2. | Infrastruktura e Cilësisë | 633,400 | 533,400 | 100,000 | |
| 1.2.1 | Standardizimi | 63,400 | 63,400 | 0 | |
| 1.2.2 | Akreditimi | 41,000 | 41,000 | 0 | |
| 1.2.3 | Metrologjia | 529,000 | 429,000 | 100,000 | ngritja e kapaciteteve teknike të laboratorëve qendror dhe autolaboratorëve për DML, DMI-në. |

| | | | | | |
|------|--|-------|-------|---|--|
| 1.3. | Çështje të mbrojtjes së konsumatorëve që nuk kanë lidhje me aspektet e sigurisë. | 12650 | 12650 | 0 | |
|------|--|-------|-------|---|--|

Tabela 2: Kostimi i zbatimit të strategjisë sipas objektivave afat gjata 2016-2020

| | Çështje të mbulura nga strategjia | Kosto totale | Buxhet | Hendek Financiar | Koment për çështjet e parashikuara si hendek financiar |
|-------------|--|-------------------|------------------|------------------|--|
| | Totali | 10,072,632 | 8,146,218 | 1,926,414 | 20% e pambuluar nga buxheti. |
| 1.1. | Fusha e sigurisë së produkteve | 8,164,132 | 6,548,118 | 1,576,014 | |
| 1.1.1 | Siguria e produkteve ushqimore, produkteve ujore, shëndeti i bimëve dhe kafshëve | 5,951,349 | 5,515,459 | 435,890 | Trajnime për AKU, mbështetje për zgjerimin e fushës së akreditimit të ISUV, për ngritjen dhe konsolidimin e rrjeteve elektronike të komunikimit, shtrirjen e procesit të akreditimit në laboratorët e shëndetit të kafshëve, etj |
| 1.1.2 | Siguria e produkteve jo-ushqimore | 1,348,159 | 1,067,159 | 281,000 | -konsulencë ligjore, fushatë ndërgjegjësuese, autolab për instalimet elektrike, fushën e naftës, gazit etj |
| 1.1.3 | Barnat për përdorim njerëzor | 864,624 | 5,500 | 859,124 | -trajnime, sistemi track and trace, mirëmbajtje |
| 1.2. | Infrastruktura e Cilësisë | 1,851,800 | 1,529,600 | 322,200 | |
| 1.2.1 | Standardizimi | 221,800 | 189,600 | 32,200 | -fushata ndërgjegjësuese, përkthime |
| 1.2.2 | Akreditimi | 130,000 | 90,000 | 40,000 | -fushata ndërgjegjësuese, trajnime etj |
| 1.2.3 | Metrologjia | 1,500,000 | 1,250,000 | 250,000 | -zgjerimi I bazës etalonuese -trajnime, fushata |

| | | | | | |
|------|---|---------------|---------------|---------------|---|
| | | | | | ndërgjegjesimi etj |
| 1.3. | Çështje të mbrojtjes së konsumatorëve që nuk kanë lidhje me aspektet e sigurisë. | 56,700 | 28,500 | 28,200 | -konsulencë ligjore -trajnime; -aktivitete ndërgjegjesuese; etj. -sondazhe - mbështetje për qendrat e këshillimit (infrastrukturë; etj) |

Tabela 3 Kostimi i zbatimit të strategjisë 2014 - 2020

| Periudha | Kosto totale | Buxhet | Hendek financiar |
|---------------------------------|---------------------|-------------------|-------------------------|
| afat –mesme 2014 - 2015 | 3,092,104 | 2,978,930 | 113,174 |
| afat gjate 2016 - 2020 | 10,072,632 | 8,146,218 | 1,926,414 |
| Gjithsej 2014 - 2020 | 13,164,736 | 11,125,148 | 2,039,588 |

5 KAPITULLI V: LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

5.1 Monitorimi i strategjisë, strukturat përgjegjëse

MZHETTS është përgjegjëse për realizimin e procesit të monitorimit periodik dhe vjetor të strategjisë.

Procesi garanton zbatimin e standardeve të monitorimit të përcaktuara në udhëzimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, dhe zhvillohet nën drejtimin e Njesisë së Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik, pranë Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj në Kryeministri.

Mbështetur në sektorët kryesorë që përbëjnë bazën e kësaj strategjie ndër-sektoriale, MZHETTS koordinon punën me strukturat e saj të varësisë, përfshirë ato të Infrastrukturës së Cilësisë,

Inspektoratin e Mbikëqyrjes së Tregut dhe Mbrojtjes së Konsumatorit si dhe me ministrinë dhe institucionet e tjera që kanë lidhje me zbatimin e saj: MEI; MBZHRAU; MSH; MTI, MAS, MZHUT, Banka e Shqipërisë, etj.

Për këtë qëllim MZHETTS mbledh, përpunon dhe menaxhon informacionin për analizimin e treguesve të kësaj strategjie ndër sektoriale duke e raportuar më pas në njësinë përgjegjëse të MZHTTES. Gjithashtu, sigurimit të të dhënave do t'i shërbejë një bashkëpunim i ngushtë me institucionet si INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, etj.

Bazën e procesit të monitorimit brenda sistemit të MZHETTS-s do ta përbëjë ecuria e realizimit të indikatorëve bazë të kësaj strategjie, për çdo vit raportues. Plani i veprimit të strategjisë, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe çdo vit, do të jetë pjesë përbërëse e planit vjetor të punës të çdo sektori, sipas parashikimeve dhe përcaktimeve përkatëse të strategjisë, duke përbërë kështu një instrument të rëndësishëm për realizimin e këtij procesi vit pas viti. Raportimet çdo gjashtëmuor për realizimin e planit të veprimit brenda institucioneve përkatëse do t'i shërbejnë një raportimi vjetor për të siguruar përgatitjen e raportit të monitorimit vjetor të strategjisë.

Në funksion të realizimit të monitorimit të strategjisë, bashkëpunimi me INSTAT, është i nevojshëm, edhe në lidhje me kryerjen e anketimeve për konsumatorët për çështje të tilla si: njohja e legjislacionit dhe institucionet që veprojnë në këtë fushë, njohja e të drejtave të tyre, niveli i mbrojtjes së tyre ndaj masave të marra nga strukturat shtetërore.

5.2 Treguesit e parashikuar në SNMKMT deri në 2020

Objektivat e parashikuara në Strategjinë e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut janë objektiva të matshme, specifik dhe konkret. Treguesit e përzgjedhur për monitorimin e strategjisë, të cilat janë pjesë e dokumentit të strategjisë, në përgjithësi mbulojnë vlerësimin e të gjitha objektivave kryesore të strategjisë.

Treguesit e parashikuar në SNMKMT 2014-2020 paraqiten më poshtë në formë tabelare:

Tabela e treguesve/indikatorëve për monitorimin e strategjisë

| Përshkrimi i Treguesve | Njësia | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|--|--------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| <i>Siguria e produkteve ushqimore, produkteve ujore, shëndeti i bimëve dhe kafshëve</i> | | | | | | | | | |
| Imunizimi 100 % i bagëtive të imta nga sëmundja e brucelozës; | % | 100 | 25 | 25 | 100 | 100 | 25 | 25 | 100 |
| Gjurmimi i sëmundjes së brucelozës në gjedhë (10% te krerëve në vit); | % | 0 | 10 | 10 | 10 | 10 | 10 | 10 | 10 |
| Gjurmimi i sëmundjes së tbc (10% e krerëve në vit); | % | 10 | 10 | 10 | 10 | 10 | 10 | 10 | 10 |
| Vaksinimi i vatrave për sëmundjen e plasjes (25% e krerëve në vit); | % | 25 | 25 | 25 | 25 | 25 | 25 | 25 | 25 |
